



Bazuar nënin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), si dhe nënin 15, nënin 16 dhe nënin 85, paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më datë 29 nëntor 2018, miratoi këtë:

Rregullore për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave

KAPITULLI I

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të siguroj që bankat mbajnë kapital të mjaftueshëm për të mbuluar rreziqet nga afarizmi i tyre, të mirëmbajnë nivelin minimal të kapitalit dhe një raport të mjaftueshmerisë së kapitalit që reflekton ekspozimet ndaj rrezikut të bankës, brenda dhe jashtë bilancit të gjendjes.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës, me përjashtim të degëve të bankave të huaja.

Neni 2

Përkufizimet

1. Termat e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuara sipas Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jobankare (në vijim: Ligji për bankat), apo siç janë përkufizuar më poshtë për qëllimin e kësaj rregullore:

1.1 Bankë - do të thotë një shoqëri aksionare e angazhuar në veprimtari bankare, duke përfshirë një subjekt të varur, të licencuar nga BQK-ja;

1.2 Degë e një banke të huaj - është një person i organizuar dhe i licencuar nga BQK-ja, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Kosovës, por banka-amë e të cilës ka selinë e vet kryesore dhe mban licencë për të ushtruar veprimtari bankare në një juridiksion tjetër jashtë Republikës së Kosovës;

1.3 Totali i kapitalit (Kapitali i Përgjithshëm) - nënkupton shumën e kapitalit të klasës së parë dhe kapitalit të klasës së dytë;

1.4 Mjetet e rrezikuara - nënkuptojnë të gjitha mjetet monetare të mbajtura në bilancin e gjendjes së bankës, siç është një kredi e cila bart çfarëdo rreziku të humbjes në vlerë për atë bankë;

1.5 Zërat jashtëbilancor - nënkuptojnë obligimet kontingjente të bankës duke përfshirë zëvendësuesit direkt të kredive, të lejuara nga banka si garancione borxhi, letër kredi standby dhe kontingjentet tjera të cilat duhet të shpalosen si fusnota në bilancin e gjendjes, por për të cilat nuk ka vlerë rreziku definitive për qëllim të përfshirjes në pjesët kryesore të bilancit të gjendjes;

1.6 Emri i mirë - nënkupton tejkalimin e vlerës aktuale të mjeteve të bankës mbi vlerën e mjeteve në librat e bankës, e definuar më tepër sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit;

1.7 Mjetet e paprekshme - nënkuptojnë mjetet e identifikueshme jo-monetare të bankës, të cilat nuk kanë substancë fizike, të cilat mbahen dhe kontrollohen si rezultat i ngjarjeve të mëparshme dhe prej të cilave priten të rrjedhin përfitime në të ardhmen, të definuara më tepër sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit;

1.8 Zëvendësues direkt i kredive - nënkupton çfarëdo marrëveshje në të cilën banka merr rrezikun e humbjeve të lidhura kreditore nga mjetet apo kërkesat tjera të cilat nuk i ka transferuar kur rreziku i humbjes kreditore tejkalon aksionet pro rata të mjeteve ose kërkesave tjera të bankës;

1.9 Letër kreditë e lidhura me tregti - nënkupton instrumente vetë-likuiduese afat shkurtra të cilat përdoren për të financuar qarkullimin e mallrave dhe janë të kolateralizuara me po ato mallra;

1.10 Rreziku operacional - nënkuptohet si rrezik i humbjeve të shkaktuara nga proceset e brendshme të dështuara apo jo adekuate, të njerëzve, sistemeve dhe ngjarjeve të jashtme. Rreziku operacional përfshin rrezikun ligjor, mirëpo përjashton rrezikun strategjik si dhe atë të reputacionit;

1.11 Raporti i kredisë me vlerën (KNV) - definohet si bilanci i shfrytëzuar i kredisë pjesëtuar me vlerën e tanishme të tregut, të objektit;

1.12 Mjetet tatimore të shtyra - ka të njëjtin kuptim si në kornizën e aplikueshme të kontabilitetit;

1.13 Mjetet tatimore të shtyra që mbështeten në profitabilitetin e ardhshëm nënkupton mjetet e shtyra tatimore vlera e ardhshme e të cilave mund të realizohet vetëm në rast se banka gjeneron fitim të tatueshëm në të ardhmen;

1.14 Detyrimi tatimor i shtyrë ka kuptimin e njëjtë sikurse në kornizën e aplikueshme të kontabilitetit;

1.15 Shpërndarjet – nënkupton pagesën e dividendave apo interesit në çdo formë;

1.16 Pjesëmarrjet indirekte janë ekspozime apo pjesë të ekspozimeve që, nëse ekspozimi direkt e humbë vlerën e tij, do të rezultojë me një humbje të bankës që kryesisht është e barabartë me humbjen në vlerë të pjesëmarrjes direkte;

1.17 Pasuria e paprekshme ka të njëjtin kuptim si në kornizën e aplikueshmëe të kontabilitetit dhe përfshin “emrin e mirë”;

1.18 Kapitali rregullator- nënkupton shumën e Kapitalit të klasës së parë dhe Kapitalit të klasës së dytë;

1.19 Instrumentet e Kapitalit rregullator nënkupton instrumentet e kapitalit të emetuara nga banka që kualifikohen si Kapital bazë i klasës së parë, Kapital shtesë i klasës së parë apo instrumente të Kapitalit të klasës së dytë;

1.20 Interesi pakicë (interesi i pakontrolluar) nënkupton shumën e Kapitalit bazë të klasës së parë të një filiale të një banke që i atribuohet personave fizikë apo juridikë përveç atyre të përfshirë në fushëveprimin prudencial të konsolidimit të bankës; Interesi pakicë në një filialë që është bankë, duhet patjetër të përjashtohet nga kapitali aksionar i bankës mëmë, nëse banka mëmë apo filiali ka hyrë në çfarëdo marrëveshje për të financuar në mënyrë direkte apo indirekte investimet në filialë qoftë përmes një entiteti për qëllime të veçanta apo përmes ndonjë entiteti apo marrëveshje tjetër. Trajtimi i përshkruar më sipër, pra, është i disponueshëm plotësisht kur të gjitha investimet pakicë (të pakontrolluara) në filialin e bankës paraqesin vetëm kontributet e drejtpërdrejta të palëve të treta në kapitalin aksionar të filialës;

1.21 Kapitali shtesë i kapitalit bazë (conservation buffer) nënkupton kapitalin rregullator që një bankë kërkohet të mbajë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 5 të kësaj rregulloreje ;

1.22 Fitimi ka të njëjtin kuptim sikurse në kornizën e aplikueshme të kontabilitetit;

1.23 Pjesëmarrja reciproke nënkupton pjesëmarrjen nga një bankë në instrumentet e kapitalit rregullator apo instrumente tjera të kapitalit të emetuara nga entitetet e sektorit financiar ku këto entitete gjithashtu kanë pjesëmarrje në instrumentet e kapitalit rregullator të emetuara nga banka;

1.24 Fitimet e pashpërndara nënkupton fitimet dhe humbjet e akumuluar si rezultat i aplikimit të fitimit apo humbjes përfundimtare sipas kornizës së aplikueshme të kontabilitetit;

1.25 Llogaria e premisë në aksione ka të njëjtin kuptim sikurse në kornizën e aplikueshme të kontabilitetit;

1.26 Diferenca e përkohshme ka të njëjtin kuptim sikurse në kornizën e aplikueshme të kontabilitetit;

1.27 Pjesëmarrja sintetike nënkupton një investim nga një bankë në një instrument financiar vlera e të cilit drejtpërdrejtë është e lidhur me vlerën e instrumenteve të kapitalit të emetuara nga një entitet i sektorit financiar;

1.28 Zërat për shpërndarje nënkupton shumën e fitimeve në fund të vitit të fundit financiar plus çdo fitim të akumuluar dhe rezervat e disponueshme për atë qëllim përpara shpërndarjes ndaj zotëruesve të instrumenteve të kapitalit rregullator duke zbritur çdo humbje të akumuluar, fitimet që nuk mund të shpërndahen në përputhje me dispozitat ligjore ose aktet rregullative të bankës apo satutin e bankës, të cilat humbje dhe rezerva janë të përcaktuara në bazë të llogarive individuale të bankës dhe jo në bazë të llogarive të konsoliduara;

1.29 Ekspozim nënkupton një aset apo një zë jashtë bilancor;

1.30 Humbje nënkupton humbje ekonomike, duke përfshirë efektet e zbritjes materiale dhe kostot materiale direkte dhe indirekte të lidhura me grumbullimin në instrument;

1.31 Humbje e pritshme nënkupton raportin e shumës që pritet të humbet në një ekspozim nga një dështim i mundshëm i kundërpalës apo dobësim gjatë periudhës njëvjeçare kundrejt shumës së mbetur në momentin e dështimit;

1.32 Kompanitë aksionare definohehen si kompani që kanë emetuar aksione të zakonshme, pavarësisht nëse këto aksione janë mbajtur privatisht apo publikisht;

1.33 Një entitet operues është një entitet i krijuar për të tregtuar me klientë për qëllim të realizimit të fitimit sipas të drejtës së vet;

1.34 Një entitet për qëllime të veçanta është një entitet ligjor i krijuar në drejtimin e një kompanie sponzorizuese (të cilës mund t'i referohet edhe si sponzor, krijues, shitës ose administrator). Sponzori zakonisht është një bankë e madhe, kompani financiare, bankë investuese ose kompani e sigurimeve. Një entitet për qëllime të veçanta mund të marrë formën e një korporate, trusti, parteriteti, shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Një entitet për qëllime të veçanta është entiteti operacionet e të cilit janë kryesisht të kufizuara në blerjen dhe financimin e mjeteve dhe detyrimeve të veçanta. Në këtë drejtim, duhet të bëhet dallimi në mes të sekjuritizimit të mjeteve dhe sekjuritizimit të detyrimeve. Sekjuritizimi i mjeteve zakonisht ndërmerret nga bankat dhe kompanitë financiare, dhe kryesisht përfshijnë emetimin e obligacioneve që janë të mbuluara me rrjedhën e parasë së mjeteve të cilat gjenerojnë të ardhura (duke filluar nga kartelat kreditore të arkëtueshme deri te kreditë hipotekare rezidenciale). Sekjuritizimi i detyrimeve zakonisht ndërmerret nga kompanitë e

sigurimit, dhe kryesisht përfshinë emetimin e obligacioneve që marrin përsipër rrezikun e një detyrimi të mundshëm të sigurimit (duke filluar nga një ngjarje katastrofike natyrore deri të një nivel i kërkesave të papritura për një lloj produkti të caktuar);

1.35 Sponzor nënkupton një institucion i ndryshëm nga institucioni krijues që themelon dhe menaxhon programin e letrave komerciale të mbështetura në mjete apo forma të tjera të sekjuritizimit që blen ekspozime nga entitetet si palë të treta;

1.36 Sekjuritizimi nënkupton një transaksion apo skemë përmes të cilit rreziku kreditor i lidhur me një ekspozim apo një grup ekspozimesh ndahet në pjesë, dhe ka karakteristikat e mëposhtme:

1.36.1 Pagesat në transaksion apo skemë janë të varura nga performanca e ekspozimit apo grupit të ekspozimeve;

1.36.2 Varësia e pjesëve të ndara përcakton shpërndarjen e humbjeve gjatë jetëgjatësisë së transaksionit apo skemës;

1.37 Pozicioni i sekjuritizimit nënkupton një ekspozim ndaj sekjuritizimit;

1.38 Ri-sekjuritizimi nënkupton sekjuritizimin ku rreziku i lidhur me një grupim bazë të ekspozimeve ndahet në pjesë dhe së paku njëri nga ekspozimet bazë është pozicioni i sekjuritizimit;

1.39 Pozicioni i ri-sekjuritizimit nënkupton një ekspozim ndaj ri-sekjuritizimit;

1.40 Kapital i pranueshëm nënkupton shumën e elementeve në vijim:

1.40.1 Kapitali i klasës së parë siç përcaktohet në nenin 6 të kësaj rregulloreje;

1.40.2 Kapitali i klasës së dytë siç përcaktohet në nenin 12 të kësaj rregulloreje që është i barabartë apo më i vogël se një e treta e Kapitalit të klasës së parë;

1.41 Përfitimet pensionale diskrecionale nënkupton përfitimet shtesë të pensionit të dhëna në bazë diskrecionale nga një bankë të punësuarit të saj si pjesë e pakos së kompensimit të ndryshueshëm të tij, që nuk përfshinë përfitimet e përlllogaritura të dhëna për një punonjës sipas kushteve të skemës pensionale të bankës;

1.42 Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të akumuluar ka të njëjtin kuptim sikurse në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 1(SNK 1);

1.43 Mjetet e fondit pensional të shumave të caktuara (angl. Defined benefit pension fund assets) nënkupton mjetet e një fondi apo plani pensional të shumave të caktuara, siç aplikohet , të llogaritura pas zvogëlimit të shumës së detyrimeve në të njëjtin fond apo plan;

1.44 Qasja e zbritjes korresponduese nënkupton që zbritja duhet të aplikohet në të njëjtin element të kapitalit për të cilin kapitali do të kualifikohet sikurse të ishte emetuar nga vetë banka. Elementet e kapitalit mund të jenë Kapitali i klasës së parë apo Kapitali i klasës së dytë;

1.45 Nënshkrimi i letrave me vlerë është një proces ku banka pajtohet të blejë një emetim të ri të letrave me vlerë nga emetuesi dhe të shpërndajë këto letra me vlerë tek investitorët;

1.46 Shoqëritë tregtare – nënkupton llojet e shoqërive tregtare sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi. Klasifikimi i shoqërive tregtare (bizneseve) do të bëhet në pajtim me Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim të Republikës së Kosovës në fuqi.

1.47 Financimi spekulativ në patundshmëri – do të thotë kredi për qëllime të blerjes së ose zhvillimit ose ndërtimit të tokës në lidhje me pasurinë e paluajtshme, apo dhe në lidhje me pasurinë e tillë, me qëllim të rishitjes për qëllime fitimi;

1.48 Zbutja e rrezikut kreditor (ang. Credit risk mitigation) – nënkupton një teknikë që përdoret nga një bankë për të zvogëluar rrezikun kreditor që lidhet me një ekspozim apo me ekspozimet të cilat vazhdon t'i mbajë në portfolio;

1.49 Mbrojtja kreditore e financiar – nënkupton një teknikë të zbutjes së rrezikut kreditor ku zvogëlimi i rrezikut kreditor në ekspozimin e bankës rrjedh nga e drejta e saj, në rast të dështimit të kundërpalës apo në rastet e ndodhjes së ngjarjeve tjera kreditore të përcaktuara që lidhen me kundërpalën, për të likuiduar ose për të marrë transferimin apo përvetësimin, ose për të mbajtur mjetet apo shumat e caktuara, ose për të zvogëluar shumën e ekspozimit, ose për të zëvendësuar atë me shumën e diferencës ndërmjet shumës së ekspozimit dhe shumës së kërkesës së bankës;

1.50 Mbrojtja kreditore e pafinancuar nënkupton një teknikë të zbutjes së rrezikut kreditor ku zvogëlimi i rrezikut kreditor në ekspozimin e bankës rrjedh nga obligimet e palës së tretë për të paguar një shumë në rast të dështimit të huamarrësit ose në rastet e ndodhjes së ngjarjeve tjera kreditore të përcaktuara;

1.51 Institucion nënkupton një institucion kredidhënës apo një shoqëri investuese;

1.52 Shoqëri investuese nënkupton çdo person juridik, veprimtaria e rregullt e së cilës është ofrimi i një apo më shumë shërbimeve për palët e treta dhe/ose kryerja e një apo më shumë aktiviteteve investuese në bazë profesionale;

1.53 Derivativ është një instrument financiar çmimi i të cilit rrjedh nga një aset tjetër;

1.54 Derivativi apo kontrata derivative nënkupton një instrument financiar siç përcaktohet në pikat 4) deri në 7) sipas Aneksit V të kësaj rregulloreje;

1.55 Derivatvët në tregjet jashtë bursave “OTC” apo kontrata derivative në tregjet jashtë bursave “OTC” nënkupton një kontratë derivative, ekzekutimi i së cilës nuk realizohet në një treg të rregulluar;

1.56 Treg i rregulluar- nënkupton një sistem i shumëfishtë që operon dhe/apo menaxhohet nga një operator i tregut, që takon apo ndihmon takimin e shumëfishtë të palëve të treta që blejnë apo shesin interesa të instrumenteve financiare – në sistem dhe në pajtueshmëri me rregullat jo diskriminuese – në një mënyrë që rezulton me një kontratë, sa i përket

instrumenteve financiare të pranuar për tregtim sipas rregullave dhe/ose sistemeve të tij, dhe që është i autorizuar dhe funksionon rregullisht;

1.57 Sistem lehtësimit për tregtim të shumëfishtë “MTF” – nënkupton një sistem të shumëfishtë, që operon nga një shoqëri investuese apo operator i tregut, që takon shumëfish palët e treta që blejnë dhe shesin interesa në instrumentet financiare – në sistem dhe në pajtueshmëri me rregullat jo diskriminuese – në një mënyrë që rezulton me një kontratë;

1.58 Operator tregu- nënkupton një person apo personat të cilët menaxhojnë dhe/ose udhëheqin aktivitetin e një tregu të rregulluar. Operatori i tregut mund të jetë vet treg i rregulluar;

1.59 Instrumente të tregut të parasë- nënkupton llojet e instrumenteve që zakonisht tregtohen në tregun e parasë, të tilla si bonot e thesarit, certifikatat e depozitit dhe letrat komerciale dhe përjashtojnë instrumentet e pagesës;

1.60 Të shënuara sipas tregut “Marking to market” nënkupton vlerësimin e pozicioneve sipas çmimeve të mbyllura në dispozicion me burim të pavarur, duke përfshirë çmimet e këmbimit, çmimet në ekran apo kuotat nga disa brokerë të pavarur me reputacion;

1.61 Të shënuara sipas modelit “Marking to model” nënkupton çdo vlerësim që duhet të krahasohet, ekstrapolohet apo të llogaritet në ndonjë formë tjetër nga një apo më shumë të dhëna të tregut;

1.62 Bursë e njohur – është bursa që plotëson të gjitha kriteret e mëposhtme:

1.62.1 është një treg i rregulluar;

1.62.2 ka një mekanizëm *kliringu*, përmes të cilit kontratat e listuara të specifikuar në Aneksin IV janë subjekt të një kërkesë për margjinë ditore, i cili, sipas opinionit të BQK-së, siguron mbrojtjen e duhur;

1.63 Mall “commodity” nënkupton çdo mall të zëvendësueshëm që është në gjendje të dorëzohet, duke përfshirë metalet si dhe xehet dhe aliazhet e tyre, produktet bujqësore dhe energjinë të tilla si elektriciteti;

1.64 Instrument financiar nënkupton:

1.64.1 çdo kontratë që krijon një aset financiar për një palë dhe një detyrim financiar apo instrument të kapitalit për palën tjetër;

1.64.2 një instrument i specifikuar në aneksin V

1.64.3 një instrument financiar derivativ

1.64.4 një instrument financiar primar

1.64.5 një instrument në para të gatshme;

1.65 Garancia “warrant” nënkupton një letër me vlerë që i jep të drejtë mbajtësit të blejë një aset bazë të caktuar, me një çmim të përcaktuar, brenda afatit të maturimit ose në këtë datë, dhe që mund të shlyhet me anë të dorëzimit të vetë instrumentit bazë ose nëpërmjet shlyerjes në para të gatshme;

1.66 Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes nënkupton çdo marrëveshje ku banka ose kundërpala transferon letrat me vlerë ose mallrat ose të drejta të garantuara të lidhura me titujt e letrave me vlerë dhe mallrat (ku garancia është e lëshuar nga një bursë e njohur, e cila mban të drejtat për këtë titull ose mall dhe kur kjo marrëveshje nuk i lejon një banke të transferojë ose të lë peng një letër me vlerë të caktuar ose një mall tek më shumë se një kundërpalë njëkohësisht, e cila ka marrë përsipër t’i riblejë ato (ose letra me vlerë të ngjashme ose mallra që zëvendësojnë njëri-tjetrin), me një çmim të përcaktuar, në një datë të ardhme të përcaktuar ose që mund të përcaktohet nga transferuesi që të jetë një marrëveshje riblerje për institucionin shitës të letrave me vlerë apo mallrave dhe një marrëveshje riblerje kthyesë për institucionin blerës.

1.67 Marrëveshje e huadhënies së letrave me vlerë apo të mallrave “commodities” dhe marrëveshje e huamarrjes së letrave me vlerë apo mallrave është çdo transaksion, sipas së cilës një bankë apo kundërpala, transferon letrat me vlerë dhe mallrat “commodities” përkundrejt një kolaterali të përshtatshëm, kundrejt një zotimi që huamarrësi të kthejë të njëjtat letra me vlerë ose mallrat, në një datë të ardhshme, ose kur i kërkohet nga transferuesi;

1.68 Pozicionet e mbajtura për qëllime tregtimi nënkupton pozicionet në vijim:

1.68.1 Pozicionet e pronësisë dhe pozicionet që rrjedhin nga shërbimi i klientëve dhe zhvillimi i tregut;

1.68.2 Pozicionet me synim për t’u shitur në periudhën afatshkurtë;

1.68.3. Pozicionet me synim për të përfitur nga diferenca në çmimin afatshkurtë aktual apo të pritur në mes të çmimeve të blerjes dhe të shitjes apo nga ndryshimet tjera të çmimit apo normës së interesit;

1.69 Detyrimi referencë është detyrimi që përdoret për qëllime të përcaktimit të vlerës së shlyerjes në para të gatshme të një derivativi kreditor;

1.70 Derivativi kreditor nënkupton një instrument financiar që derivon, d.m.th., një kontratë që përcakton detyrimin e ofruesit të mbrojtjes për t’i paguar blerësit të mbrojtjes detyrimin e parashikuar kontraktualisht në rast të ndodhjes së një ngjarjeje kreditore të paracaktuar. Ky detyrim do të konsistojë në njërën nga vlerat e mëposhtme:

1.70.1 masën e rënies së vlerës së detyrimit referencë në raport me vlerën fillestare;

1.70.2 vlerën e plotë nocionale të detyrimit referencë në këmbim të dorëzimit të detyrimit referencë ose të një instrumenti financiar ekuivalent të specifikuar në kontratë;

1.70.3 një shumë fikse të paracaktuar;

1.71 Kontratë kreditore kundërkëmbimi e dështuar/pashlyer “Credit Default Swap” është një lloj derivativi kreditor sipas të cilit, blerësi i mbrojtjes ia transferon ofruesit të mbrojtjes rrezikun kreditor të detyrimit referencë. Ofruesi i mbrojtjes merr përsipër të kompensojë blerësin e mbrojtjes në rast se në rast të ndodhjes së ngjarjeve kreditore të specifikuar në kontratë. Për këtë shërbim, blerësi i mbrojtjes i paguan ofruesit të mbrojtjes një prim periodik;

1.72 Kontratë kundërkëmbimi për shlyerje gjithsej “Total Return Swap” janë kontrata nëpërmjet të cilave blerësi i mbrojtjes angazhohet t'i transferojë ofruesit të mbrojtjes të gjitha rrjedhat e parasë që burojnë nga detyrimi referencë. Ofruesi i mbrojtjes nga ana e tij, i transferon blerësit rrjedhat e parasë që lidhen me një normë referencë. Në datat e pagimit të rrjedhave të parasë (ose në datën e përfundimit të kontratës), blerësi i mbrojtjes i transferon ofruesit shumën e rivlerësimit të mundshëm të detyrimit referencë (d.m.th., një shumë të barabartë me diferencën pozitive midis vlerës së tregut dhe vlerës fillestare të detyrimit referencë). Në rast të rënies së vlerës së detyrimit referencë, ofruesi i mbrojtjes i transferon blerësit shumën përkatëse që kompenson këtë rënie;

1.73 Vlerënotë e lidhur kreditore “Credit Linked Note” është instrument derivativ i cili i lejon blerësit të mbrojtjes t'i transferojë ofruesit rrezikun që buron nga një aset mbi të cilin bazohet vlerënota e lidhur kreditore. Ofruesi i mbrojtjes merr nga blerësi një pagesë periodike (kupon) dhe vlerën e asetit në rastin e maturimit, përveç rastit kur ndodhë një ngjarje kreditore përpara maturimit të asetit, mbi të cilin bazohet vlerënota e lidhur kreditore;

1.74 Derivativi kreditor së pari - për të dështuar “first-to-default”- është një kontratë që lidhet me një numër të caktuar ekspozimesh, sipas termave të së cilës dështimi i parë ndër ekspozimet do të shkaktojë pagesën e detyrimit nga ofruesi i mbrojtjes;

1.75 Derivativ kreditor n-th - për të dështuar “nth-to default” është një kontratë që lidhet me një numër të caktuar ekspozimesh sipas termave të së cilës, dështimi i n-th ndër ekspozimet do të shkaktojë pagesën e detyrimit nga ofruesi i mbrojtjes;

1.76 Koeficienti delta është koeficienti që përfaqëson ndryshimin e pritshëm në çmimin e një opsioni, si rezultat i ndryshimit në çmimin e instrumentit bazë të tij;

1.77 Libër tregtar nënkupton të gjitha pozicionet në instrumentet financiare dhe mallra të mbajtura nga banka për qëllime tregtimi apo në mënyrë që të mbrojnë pozicionet e mbajtura për qëllime tregtimi;

1.78 Transaksionet e kreditimit marginal nënkupton transaksionet në të cilat një bankë lejon kredi në lidhje me blerjen, shitjen, mbajtjen apo tregtimin e letrave me vlerë. Transaksionet e kreditimit marginal nuk përfshijnë kreditë tjera që janë të siguruara me kolateral në formë të letrave me vlerë;

1.79 Letrat me vlerë të transferueshme nënkupton ato lloje të letrave me vlerë që janë të negociueshme në tregun e kapitalit;

1.80 Konvertim nënkupton një letër me vlerë që mund të këmbëhet me një tjetër letër me vlerë, sipas zgjedhjes së mbajtësit të kësaj letre me vlerë;

1.81 Financimi i stokut nënkupton pozicionet ku stoku fizik është shitur në të ardhmen dhe kostoja e financimit është fiksuar deri në datën e shitjes në të ardhmen;

1.82 Aset bazë nënkupton një instrument financiar (p.sh., aksionet, kontratat e së ardhmes “futures”, mallrat “commodities”, valutat, indekset etj.) nga i cili derivon/rrjedh çmimi derivativ;

1.83 Kontratat e së ardhmes “futures”- janë marrëveshje për shtyerjen e dorëzimit të instrumenteve financiare apo mallrave në të cilat blerësi pajtohet të blejë dhe shitësi pajtohet të dorëzojë, në një datë të përcaktuar në të ardhmen, një instrument apo mall të caktuar me një çmim apo rendiment të caktuar. Kontratat e së ardhmes janë të standardizuara dhe tregtohen në bursa të organizuara ku bursat apo shtëpitë për shlyerje veprojnë si kundërpalë për çdo kontratë;

1.84 Kontratat me pajtim paraprak “forward”- janë marrëveshje për shtyerjen e dorëzimit të instrumenteve financiare apo mallrave në të cilat blerësi pajtohet të blejë dhe shitësi pajtohet të dorëzojë, në një datë të përcaktuar në të ardhmen, një instrument apo mall të caktuar me një çmim apo rendiment të caktuar. Kontratat me pajtim paraprak nuk tregtohen në bursa të organizuara dhe kushtet kontraktuale nuk janë të standardizuara;

1.85 Kontratat opsjon janë kontrata që bartin të drejtën ose obligimin, varësisht nëse institucioni është blerës apo shkruar, për të blerë apo për të shitur një instrument financiar apo mall me një çmim të përcaktuar në datën e përcaktuar në të ardhmen apo para kësaj date. Disa opsione tregtohen në bursa të organizuara. Gjithashtu, opsionet mund të shkruhen për të plotësuar nevojat e veçanta të kundërpalëve në transaksion. Këto kontrata të opsioneve të përshtatura sipas nevojave të kundërpalëve janë të njohura si opsione jashtë bursave “Over-the-counter (OTC). Pra, kontratat e opsioneve “OTC” përfshijnë të gjitha kontratat e opsioneve të cilat nuk tregtohen në bursa të organizuara;

1.86 Kontratat e kundërkëmbimit “swaps” janë transaksione “OTC” në të cilat dy palë pajtohen për të këmbyer rrjedha të pagesave bazuar në një shumë nocionale të specifikuar për një periudhë të caktuar;

KAPITULLI II KAPITALI RREGULLATOR I BANKËS

Struktura e kapitalit

Neni 3

Minimumi i kapitalit

1. Bazuar në paragrafin 1 të Nenit 15 të Ligjit nr.04/L-093 për Banka, Institucione mikrofinanciare dhe Institucione financiare jobankare, bankat duhet të kenë në çdo kohë, kapital të paguar prej minimum shtatë (7) milionë euro, që është subjekt i kufizimeve nga paragrafi i 2 i Nenit 15 të Ligjit nr.04/L-093 për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare.

Neni 4

Struktura e kapitalit

1. Totali i kapitalit rregullator të bankës përbëhet nga shuma e elementeve në vijim:

1.1 Kapitali i klasës së parë (ang. Tier 1) që përfshinë:

1.1.1 Kapitali bazë i klasës së parë (ang. CET 1);

1.1.2 Kapitali shtesë i klasës së parë (ang. Additional Tier 1)

1.2 Kapitali i klasës së dytë (ang. Tier 2)

2. Për secilën nga elementet e kapitalit rregullativ të shënuara më lartë në paragrafin 1 të këtij neni, ekzistojnë kriteret e përcaktuara me këtë rregullore, të cilat instrumentet e bankave duhet t'i plotësojnë para përfshirjes së tyre në kategoritë përkatëse.

Neni 5

Kërkesat e kapitalit rregullator

1. Totali i kapitalit rregullator i bankës i përcaktuar sipas elementeve të paragrafit 1 te nënit 4 të kësaj rregulloreje është neto nga përshtatjet e aplikuarat rregullative si dhe janë subjekt i kufizimeve të mëposhtme:

1.1 Kapitali bazë i klasës së parë (ang. CET1) duhet të jetë në çdo kohë së paku 4.9% të mjeteve të peshuara me rrezik.

1.2 Kapitali i klasës së parë (ang. Tier 1) duke përfshirë kapitalin shtesë të kapitalit bazë (ang. capital conservation buffer) duhet të jetë në çdo kohë së paku 9.0% të mjeteve të peshuara me rrezik.

- 1.3 Gjithsej kapitali (Kapitali i klasës së parë dhe Kapitali i klasës së dytë) duhet të jetë në çdo kohë së paku 12.0% të mjeteve të peshuara me rrezik.
2. Përveç kapitalit bazë të klasës së parë, bankat duhet të mbajnë kapital shtesë të kapitalit bazë (ang. capital conservation buffer) të klasës së parë prej 2.5% e mjeteve të peshuara me rrezik si në nivel individual ashtu edhe në nivel të konsoliduar.
3. Kapitali i klasës së dytë duhet të jetë i barabartë ose më i vogël se një e treta e kapitalit të klasës së parë.
4. Kapitali shtesë i klasës së parë duhet të jetë i barabartë ose më i vogël se një e treta e kapitalit bazë të klasës së parë.
5. Gjithsej shuma e ekspozimeve me rrezik duhet të llogaritet si shumë e përgjithshme nga elementet sipas nënparagrafeve 5.1 deri 5.3 të këtij paragrafi:
 - 5.1 shuma e mjeteve të peshuara me rrezik për rrezikun kreditor e llogaritur sipas Kapitullit III të kësaj rregulloreje.
 - 5.2 kërkesat e kapitalit të përcaktuara në pajtueshmëri me Kapitullin V të kësaj rregulloreje
 - 5.3 kërkesat e kapitalit të përcaktuara në pajtueshmëri me Kapitullin VI të kësaj rregulloreje.
6. Dispozitat në vijim duhet të aplikohen për llogaritjen e gjithsej shumës së ekspozimit të referuar në paragrafin 5 të këtij neni:
 - 6.1. kërkesat e kapitalit të referuara në nënparagrafet 5.2 dhe 5.3 të paragrafit 5 të këtij neni duhet të përfshijnë ato që rrjedhin nga të gjitha aktivitetet biznesore të bankës;
 - 6.2. bankat duhet të shumëzojnë kërkesat e kapitalit të përcaktuara në nënparagrafet 5.2 dhe 5.3 të paragrafit 5 të këtij neni me 8.33.

Neni 6

Kapitali i klasës së parë

Kapitali i klasës së parë përbëhet nga shuma e kapitalit bazë të klasës së parë dhe kapitalit shtesë të klasës së parë të bankës.

Neni 7

Kapitali bazë i klasës së parë

1. Kapitali bazë i klasës së parë përbëhet nga shuma e elementeve në vijim:
 - 1.1 Aksionet e zakonshme të emetuara nga banka të cilat i përmbushin kriteret për tu klasifikuar si aksione të zakonshme për qëllime rregullatore;
 - 1.2 Teprica e aksioneve (premia në aksione) që rezulton nga emetimi i instrumenteve të përfshira në kapitalin bazë të klasës së parë;

- 1.3 Fitimet e pashpërndara;
 - 1.4 Të ardhurat tjera gjithpërfshirëse të akumuluar dhe rezervat tjera të shpalosura;
 - 1.5 Aksionet e zakonshme të emetuara nga filialet e konsoliduara të bankës dhe të mbajtura nga palët e treta (interesat e pakontrolluara) që i plotësojnë kriteret për tu përfshirë në kapitalin bazë të klasës së parë;
 - 1.6 Përshtatjet rregullative të aplikuara gjatë llogaritjes së kapitalit bazë të klasës së parë.
2. Për qëllim të nënparagrafit 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni, bankat, mund të përfshijnë fitimet e periudhës raportuese apo të fundvitit në kapitalin bazë të klasës së parë para se të marrin vendimin përfundimtar që konfirmon fitimin apo humbjen për vitin ushtrimor, vetëm me aprovimin paraprak nga BQK.
3. Referuar paragrafit 2 të këtij neni, BQK do të aprovojë përfshirjen e fitimeve vetëm nëse kushtet e mëposhtme janë plotësuar:
- 3.1 fitimet janë vërtetuar nga auditorët e jashtëm që janë përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare të bankës apo fitimet e tilla janë verifikuar gjatë ekzaminimeve nga BQK;
 - 3.2 banka ka vërtetuar që çdo pagesë apo shpërndarje e dividendës e parashikuar është zbritur nga fitimi i bankës;
 - 3.3 verifikimi i fitimit të periudhës raportuese dhe e fundvitit duhet të ofrojë siguri të mjaftueshme që këto fitime janë vlerësuar në pajtueshmëri me kornizën e aplikueshme të kontabilitetit.
4. Bankat duhet të dërgojnë për aprovim në BQK të gjitha dokumentet të cilat vërtetojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.

Neni 8

Kriteret për klasifikim si aksione të zakonshme për qëllime të kapitalit rregullator

1. Instrumenti i cili mund të përfshihet në Kapitalin bazë të klasës së parë duhet t'i plotësojë të gjitha kriteret si në vijim:
 - 1.1 Përfaqëson kërkesën më të fundit në rastet e likuidimit të bankës. Ka të drejtë për kërkesë të aseteve të mbetura që është proporcionale me pjesën e kapitalit të emetuar pasi të jenë paguar të gjitha kërkesat më të larta në likuidim (d.m.th., ka kërkesë të pakufizuar dhe variable, jo kërkesë fikse apo të kufizuar);
 - 1.2 Principali është i përhershëm dhe asnjëherë i paguar përveç në likuidim;
 - 1.3 Banka nuk ndërmerr ndonjë veprim gjatë emetimit për të krijuar një pritje që instrumenti do të riblehet, shlyhet apo anulohet dhe as kushtet e parashikuara me statut apo kushtet kontraktuale nuk japin ndonjë tipar i cili mund të krijojë një pritje të tillë;

- 1.4 Shpërndarjet paguhen nga zërat për shpërndarje (përfshirë fitimet e pashpërndara). Niveli i shpërndarjeve nuk është në asnjë mënyrë i lidhur apo që lidhet me shumën e paguar në momentin e emetimit dhe nuk është subjekt i ndonjë kufizimi maksimal kontraktual (përveç në atë masë që banka nuk ka mundësi të paguajë shpërndarjet të cilat tejkalojnë nivelin e zërave për shpërndarje). Nuk ekzistojnë rrethana në të cilat shpërndarjet janë të obligueshme. Mospagesa nuk konsiderohet ngjarje e dështimit. Shpërndarjet paguhen vetëm pasi që të gjitha obligimet ligjore dhe kontraktuale janë përmbushur si dhe janë kryer pagesat në instrumentet e kapitalit të nivelit më të lartë. Kjo nënkupton që nuk duhet të ekzistojnë shpërndarje preferenciale duke përfshirë edhe elementet tjera të klasifikuara si kapitali i emetuar me kualitetin më të lartë;
- 1.5 Është kapital i emetuar i cili merr pjesën e parë dhe në mënyrë proporcionale pjesën më të madhe të çdo humbje kur ato ndodhin. Brenda kualitetit më të lartë të kapitalit, secili instrument absorbon humbjet në bazën e vazhdimësisë në mënyrë proporcionale dhe në nivel të njëjtë me gjithë instrumentët tjerë. Shuma e paguar njihet si ekuitet (d.m.th., nuk njihet si detyrim) për të përcaktuar josolvencën e bilancit të gjendjes. Shuma e paguar klasifikohet si kapital sipas standardeve të aplikuara të kontabilitetit;
- 1.6 Është emetuar dhe paguar drejtpërdrejtë dhe banka nuk mund në mënyrë direkte apo indirekte të ketë financuar blerjen e instrumentit;
- 1.7 Shuma e paguar nuk është e siguruar dhe as e mbuluar nga ndonjë garanci e emetuesit apo entiteti të ndërlidhur apo subjekt i ndonjë rregullimi tjetër që ligjërisht apo ekonomikisht rrit prioritetin e kërkesës;
- 1.8 Është emetuar vetëm me aprovimin e pronarëve të bankës emetuese;
- 1.9 Është shpalosur qartë dhe ndaras në bilancin e gjendjes së bankës.

Neni 9

Kapitali shtesë i klasës së parë

1. Kapitali shtesë i klasës së parë përbëhet nga elementet e mëposhtme:
 - 1.1 Instrumentet e emetuara nga banka të cilat i plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në Kapitalin shtesë të klasës së parë (dhe që nuk janë të përfshira në Kapitalin bazë të klasës së parë);
 - 1.2 Teprica e aksioneve (premia në aksione) që rezulton nga emetimi i instrumenteve të përfshira në Kapitalin shtesë të klasës së parë;
 - 1.3 Instrumentet e emetuara nga filialet e konsoliduara të bankës dhe të mbajtura nga palët e treta të cilat i plotësojnë kriteret për tu përfshirë në Kapitalin shtesë të klasës së parë dhe që nuk janë të përfshira në Kapitalin bazë të klasës së parë; dhe
 - 1.4 Përshtatjet rregullative të aplikuara për llogaritjen e Kapitalit shtesë të klasës së parë.

Neni 10

Kriteret për përfshirje në Kapitalin shtesë të klasës së parë

1. Kriteret të cilat duhet t'i plotësoj apo t'i tejkaloj një instrument i emetuar nga banka për t'u përfshirë në Kapitalin shtesë të klasës së parë janë si në vijim:

- 1.1 Instrumenti duhet të jetë i emetuar dhe i paguar;
- 1.2 Instrumenti i nënshtrohet depozitorëve, kreditorëve të përgjithshëm dhe borxhit të varur të bankës;
- 1.3 Instrumenti nuk është i siguar apo i mbuluar nga ndonjë garanci e emetuesit apo entiteti të ndërlidhur ose ndonjë rregullimi tjetër që ligjërisht apo ekonomikisht përmirëson përparësinë e shlyerjes së pretendimeve ndaj kreditorëve të përgjithshëm të bankës;
- 1.4 Instrumenti është i përhershëm, d.m.th., nuk ekziston ndonjë datë e maturimit, kërkesë për rritje të kuponit/interesit "step-up" apo synime tjera për ta shlyer atë;
- 1.5 Mund të jetë i kërkueshëm me iniciativën e emetuesit vetëm pas një minimumi prej pesë viteve:
 - 1.5.1 Për të ushtruar një opion të thirrjes një bankë duhet të marrë aprovimin paraprak nga BQK;
 - 1.5.2 Një bankë nuk duhet të ndërmarrë ndonjë veprim që krijon një pritje se thirrja "call" do të ushtrohet; dhe
 - 1.5.3 Bankat nuk duhet të ushtrojnë thirrjen "call" përveç nëse:
 - 1.5.3.1 Bankat e zëvendësojnë instrumentin e thirrur me kapital të kualitetit të njëjtë apo më të mirë dhe zëvendësimi i këtij kapitali bëhet në kushte të cilat janë të qëndrueshme për kapacitetin e të ardhurave të bankës; ose
 - 1.5.3.2 Banka vërteton se pozicioni i saj i kapitalit është shumë më i lartë se kërkesat minimale të kapitalit pas ushtrimit të opionit të thirrjes.
- 1.6 Çdo shlyerje e principalit duhet të bëhet me aprovimin paraprak nga BQK.
- 1.7 E drejta e dividendës/kuponit:
 - 1.7.1 Banka duhet të ketë të drejtë të plotë në çdo kohë për të anuluar shpërndarjet/pagesat;
 - 1.7.2 Anulimi i pagesave diskrecionale nuk paraqet ngjarje dështimi për bankën;
 - 1.7.3 Bankat duhet të kenë çasje të plotë në pagesat e anuluar për të kryer obligimet në kohën e duhur;
 - 1.7.4 Anulimi i shpërndarjeve/pagesave nuk duhet të imponojë kufizime tek banka përveç rasteve që lidhen me shpërndarjet ndaj aksionarëve të cilët posedojnë aksione të zakonshme.

- 1.8 Dividentët/kuponët duhet të paguhen nga zërat për shpërndarje.
- 1.9 Instrumenti nuk mund të ketë veçori të dividentës me ndjeshmëri kreditore që është një dividentë/kupon që ndryshon periodikisht i bazuar plotësisht apo pjesërisht në vlerësimin/rejtingun kreditor të bankës.
- 1.10 Instrumenti nuk mund të kontribuojë në detyrimet që tejkalojnë asetet nëse një test i tillë i bilancit të gjendjes është pjesë e legjislacionit lidhur me likuidimin e bankave.
- 1.11 Instrumentet e klasifikuara si detyrime për qëllime të kontabilitetit duhet të absorbojnë humbjet e principalit përmes:
- 1.11.1 konvertimit në aksione të zakonshme objektivisht para ndodhjes së një pike apo momenti aktivizues (trigger point) ose
- 1.11.2 ndonjë mekanizmi të shlyerjes/ripagimit i cili alokon humbjet e instrumentit para ndodhjes së ndonjë pike apo momenti aktivizues (trigger point).
- 1.11.2.1 Shlyerja/Ripagimi do të ketë efektet si në vijim:
- 1.11.2.1.1 Zvogëlon kërkesën e instrumentit në rast të likuidimit të bankës;
- 1.11.2.1.2 Zvogëlon shumën e ripaguar kur ushtrohet thirrja e instrumentit; dhe
- 1.11.2.1.3 Pjesërisht apo plotësisht zvogëlon pagesat e kuponit/dividentës në instrument.
- 1.11.3 Një ngjarje aktivizuese “a trigger event” ndodhë kur treguesi i Kapitalit bazë të klasës së parë i bankës i përcaktuar në nenin 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të kësaj rregullore bie nën një të njërit nga nivelet si në vijim:
- 1.11.3.1 nën 5,125%
- 1.11.3.2 një nivel më i lartë se 5,125%, kur përcaktohet nga banka dhe specifikohet në dispozitat që e rregullojnë instrumentin;
- 1.11.4 Bankat mund të specifikojnë në dispozitat që e rregullojnë instrumentin një apo më shumë ngjarje aktivizuese përveç asaj të referuar në pikën 1.11.3 të këtij neni;
- 1.11.5 Në rastet kur dispozitat, që rregullojnë instrumentet, kërkojnë që këto të konvertohen në instrumente të Kapitalit bazë të klasës së parë në rastet e ndodhjes së një ngjarje aktivizuese, ato dispozita duhet të specifikojnë si në vijim:
- 1.11.5.1 normën e konvertimit të tillë dhe një kufizim të shumës së lejuar të konvertimit;
- 1.11.5.2 një interval kohor brenda të cilit instrumentet do të konvertohen në instrumente të Kapitalit bazë të klasës së parë.

- 1.11.6 Në rastet kur dispozitat që i rregullojnë instrumentet kërkojnë që shuma e kryegjësë të ripaguhet/shlyhet në rastet e ndodhjes së një ngjarje aktivizuese, ripagimi/shlyerja do të zvogëlojë të gjitha këto në vijim:
- 1.11.6.1 kërkesën e pronarit të instrumentit në rast të josolencës apo likuidimit të bankës;
 - 1.11.6.2 shuma e cila kërkohet të paguhet në rast të thirrjes apo shlyerjes së instrumentit;
 - 1.11.6.3 shpërndarjet e bëra në instrument.
- 1.11.7 Ripagimi/shlyerja apo konvertimi i instrumentit të kapitalit shtesë të klasës së parë sipas kornizës së aplikuar të kontabilitetit duhet të krijojë zëra që mund të kualifikohen për përfshirje në kapitalin bazë të klasës së parë.
- 1.11.8 Shuma e instrumenteve të kapitalit shtesë të klasës së parë e njohur në zërat e kapitalit shtesë të klasës së parë është e kufizuar në shumën minimale të zërave të kapitalit bazë të klasës së parë që do të gjenerohej nëse shuma e kryegjësë e instrumenteve të kapitalit shtesë të klasës së parë do të shlyhej plotësisht apo konvertohej në instrumente të kapitalit bazë të klasës së parë.
- 1.11.9 Shuma agregate e instrumenteve të kapitalit shtesë të klasës së parë që kërkohet të ripaguhet/shlyhet apo konvertohet në rast të ndodhjes së një ngjarje aktivizuese nuk duhet të jetë më e vogël sesa niveli më i ulët i:
- 1.11.9.1 shumës e cila kërkohet për të kthyer plotësisht treguesin e kapitalit bazë të klasës së parë të bankës në 5,125%;
 - 1.11.9.2 shumës së plotë të kryegjësë së instrumentit.
- 1.11.10 Në rastet e ndodhjes së një ngjarje aktivizuese bankat duhet të veprojnë si në vijim:
- 1.11.10.1 të informojnë menjëherë BQK-në;
 - 1.11.10.2 të informojnë zotëruesit e instrumenteve të kapitalit shtesë të klasës së parë;
 - 1.11.10.3 të ripaguajnë/shlyejnë shumën e kryegjësë së instrumenteve, apo të konvertojnë instrumentet në instrumente të kapitalit bazë të klasës së parë pa ndonjë vonesë por jo më vonë se një muaj, në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në këtë nen.
- 1.11.11 Banka e cila emeton instrumente të kapitalit shtesë të klasës së parë që konvertohen në kapitalin bazë të klasës së parë në rastet e ndodhjes së një ngjarje aktivizuese duhet të sigurojë që kapitali aksionar i autorizuar është i mjaftueshëm në çdo kohë për konvertimin e të gjithë instrumenteve të tilla të kapitalit shtesë të klasës së parë në aksione nëse ndodhë një ngjarje aktivizuese. Të gjitha

autorizimet e nevojshme duhet të merren në datën e emetimit të instrumenteve të tilla të konvertueshme të kapitalit shtesë të klasës së parë. Banka duhet të mbajë në çdo kohë autorizimin e nevojshëm paraprak për të emetuar instrumentet e kapitalit bazë të klasës së parë në të cilët instrumentet e tilla të kapitalit shtesë të klasës së parë do të konvertoheshin në rast të ndodhjes së një ngjarje aktivizuese.

- 1.11.12 Banka e cila emeton instrumente të kapitalit shtesë të klasës së parë që konvertohen në kapitalin bazë të klasës së parë në rast të ndodhjes së një ngjarje aktivizuese duhet të sigurojë që nuk ekzistojnë pengesa ligjore në konvertim sa i përket inkorporimit ose statuteve apo marrëveshjeve kontraktuale.
- 1.12 Banka ose palët e ndërlidhura me të mbi të cilat ushtron kontrollë apo ndikim domethënës nuk mund të blejnë instrumentin apo të financojnë blerjen e tij në mënyrë direkte apo indirekte.
- 1.13 Instrumenti nuk mund të ketë ndojnë veçori që pengon rikapitalizimin e bankës, të tillë si dispozitat që kërkojnë emetuesin për të kompensuar investitorët nëse një instrument i ri është emetuar me një çmim më të ulët gjatë një periudhe kohore të specifikuar.
- 1.14 Nëse instrumenti nuk është emetuar jashtë ndonjë entiteti operues apo shoqëri aksionare në nivel të konsoliduar (p.sh. entitetet për qëllime të veçanta), mjetet duhet të jenë të disponueshme menjëherë në ndonjë formë e cila përmbushë apo tejkalon të gjitha kriteret tjera për përfshirje në kapitalin shtesë të klasës së parë.

Neni 11

Teprica e aksioneve (premia në aksione) që rezulton nga emetimi i instrumenteve që janë të përfshira në kapitalin shtesë të klasës së parë

Teprica e aksioneve (premia në aksione) që nuk i plotëson kushtet për përfshirje në Kapitalin bazë të klasës së parë, mund të përfshihet në Kapitalin shtesë të klasës së parë vetëm në rastet kur aksionet që rrisin tepricën në aksione lejohet të përfshihen në Kapitalin shtesë të klasës së parë.

Neni 12

Kapitali i klasës së dytë

1. Kapitali i klasës së dytë përbëhet nga elementet e mëposhtme:

- 1.1 Instrumentet e emetuara nga banka që plotësojnë kushtet për përfshirjen e tyre në kapitalin e klasës së dytë (dhe që nuk janë përfshirë në kapitalin e klasës së parë);
- 1.2 Teprica në aksione (premia në aksione) që rezulton nga emetimi i instrumenteve të përfshira në kapitalin e klasës së dytë;

- 1.3 Instrumentet e emetuara nga filialet e konsoliduara të bankës dhe të mbajtura nga palët e treta që plotësojnë kushtet për përfshirjen e tyre në kapitalin e klasës së dytë dhe që nuk janë përfshirë në kapitalin e klasës së parë;
- 1.4 Provizionet për humbjet nga kreditë të përcaktuara sipas nenit 15 dhe 16 të kësaj rregulloreje; dhe
- 1.5 Përshtatjet rregullative të cilat aplikohen gjatë llogaritjes së kapitalit të klasës së dytë.

Neni 13

Kriteret për përfshirje në Kapitalin e klasës së dytë

1. Kriteret të cilat duhet t'i plotësojë apo t'i tejkaloj një instrument i emtuar nga banka për t'u përfshirë në Kapitalin e klasës së dytë janë si në vijim:

- 1.1 Të jetë i emtuar dhe i paguar;
- 1.2 Instrumenti i nënshtrohet depozitorëve dhe kreditorëve të përgjithshëm të bankës;
- 1.3 Instrumenti nuk është i siguruar apo i mbuluar nga ndonjë garanci e emetuesit apo entiteti të ndërlidhur ose ndonjë rregullimi tjetër që ligjërisht apo ekonomikisht përmirëson përparësinë e shlyerjes së pretendimeve ndaj kreditorëve të përgjithshëm të bankës;
- 1.4 Të plotësoj kërkesat e maturitetit si më poshtë:
 - 1.4.1 maturiteti origjinal në minimum më i gjatë se 5 vite;
 - 1.4.2 njohja në kapitalin rregullator në pesë vitet e mbetura para maturimit do të amortizohet në bazë lineare;
 - 1.4.3 nuk ekziston ndonjë kërkesë për rritje të kuponit/interesit "step-up" apo synime tjera për ta shlyer atë.
- 1.5 Mund të jetë i kërkueshëm (opsion i thirrjes) me iniciativën e emetuesit vetëm pas një minimumi prej pesë viteve sipas kriterëve si në vijim:
 - 1.5.1 Për të ushtruar një opsion të thirrjes, një bankë duhet të marrë aprovimin paraprak nga BQK;
 - 1.5.2 Një bankë nuk duhet të ndërmarrë ndonjë veprim që krijon një pritje se thirrja "call" do të ushtrohet; dhe
 - 1.5.3 Bankat nuk duhet të ushtrojnë thirrjen "call" përveç nëse:
 - 1.5.3.1. Bankat e zëvendësojnë instrumentin e thirrur me kapital të kualitetit të njëjtë apo më të mirë dhe zëvendësimi i këtij kapitali bëhet në kushte të cilat janë të qëndrueshme për kapacitetin e të ardhurave të bankës; ose

- 1.5.3.2. Banka vërteton se pozicioni i saj i kapitalit është shumë më i lartë se kërkesat minimale të kapitalit pas ushtrimit të opsionit të thirrjes.
- 1.6 Investitori nuk duhet të ketë të drejta të përshpejtojë shlyerjen e pagesave të planifikuara për të ardhmen (kuponin apo principalin), përveç në rast falimentimi dhe likuidimi;
- 1.7 Instrumenti nuk mund të ketë veçori të dividendës me ndjeshmëri kreditore që është një dividendë/kupon që ndryshon periodikisht i bazuar plotësisht apo pjesërisht në vlerësimin / rejtingun kreditor të bankës;
- 1.8 Banka ose palët e ndërlidhura me të mbi të cilat ushtron kontrollë apo ndikim domethënës, nuk mund të blejnë instrumentin apo të financojnë blerjen e tij në mënyrë direkte ose indirekte;
- 1.9 Nëse instrumenti nuk është emetuar jashtë ndonjë entiteti operues apo shoqërie amë në nivel të konsoliduar (p.sh., entitetet për qëllime të veçanta) mjetet duhet të jenë të disponueshme menjëherë pa ndonjë kufizim ndaj entitetit operues apo shoqërisë mëmë në nivel të konsoliduar në një formë e cila përmbushë apo tejkalon të gjitha kriteret tjera për përfshirje në Kapitalin e klasës së dytë.

Neni 14

Teprica e aksioneve (premia në aksione) që rezulton nga emetimi i instrumenteve të përfshira në Kapitalin e klasës së dytë

Teprica e aksioneve (premia në aksione) që nuk i plotëson kushtet për përfshirje në Kapitalin e klasës së parë, mund të përfshihet në Kapitalin klasës të dytë vetëm në rastet kur aksionet që rrisin tepricën në aksione lejohen për përfshirje në Kapitalin e klasës së dytë.

Neni 15

Provizionet e përgjithshme/rezervat e përgjithshme për humbjet nga kreditë (për bankat që përdorin qasjen e standardizuar për rrezikun kreditor)

1. Provizionet apo rezervat për humbjet nga kreditë të mbajtura ndaj humbjeve kreditore të ardhshme, humbjeve të paidentifikuara aktualisht, të cilat janë të disponueshme të mbulojnë humbjet që materializohen, kualifikohen për përfshirje në Kapitalin e klasës së dytë.
2. Provizionet e përshkruara për përkeqësimin e identifikuar të asetëve të caktuara apo detyrimeve të njohura, individualisht apo të grupuara, duhet të përjashtohen.
3. Provizionet e përgjithshme/rezervat e përgjithshme për humbjet nga kreditë që kualifikohen për përfshirje në Kapitalin e klasës së dytë janë të limituara në një maksimum prej 1.25 pikë përqindje të mjeteve të peshuara me rrezik për rrezikun kreditor të llogaritura sipas qasjes së standardizuar.

Neni 16

Teprica e gjithsej provizioneve të pranueshme sipas qasjes së bazuar në vlerësimet e brendshme

Në rastet kur gjithsej shuma e humbjeve të pritura është më e vogël se gjithsej provizionet e pranueshme, bankat mund të njohin diferencën në Kapitalin e klasës së dytë deri në maksimumin prej 0.6% të mjeteve të peshuara me rrezik për rrezikun kreditor të llogaritur sipas qasjes së vlerësimeve të brendshme.

Neni 17

Interesi pakicë (interesi i pakontrolluar) dhe kapitali tjetër i emtuar jashtë filialeve të konsoliduara që mbahet nga palët e treta Aksionet e zakonshme të emtuara nga filialet e konsoliduara

1. Interesi pakicë që rrjedh nga emetimi i aksioneve të zakonshme nga një filialë e konsoliduar plotësisht e bankës mund të pranohet në Kapitalin bazë të klasës së parë vetëm nëse:
 - 1.1 instrumenti që rritë interesin pakicë, nëse emetohet nga banka, plotëson të gjitha kriteret për klasifikim si aksione të zakonshme për qëllime të kapitalit rregullator; dhe
 - 1.2 filiali që ka emtuar instrumentin është bankë.
2. Shuma e interesit pakicë që plotëson kriteret në paragrafin 1 të këtij neni që do të pranohet në Kapitalin bazë të klasës së parë të konsoliduar do të llogaritet si në vijim:
 - 2.1 Gjithsej interesi pakicë që plotëson dy kriteret e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni minus shuma e tepricës së Kapitalit bazë të klasës së parë të filialës që i atribuohet aksionarëve të interesit pakicë;
 - 2.2 Teprica e Kapitalit bazë të klasës së parë të filialës llogaritet si Kapitali bazë i klasës së parë të filialës minus vlera më e ulët nga:
 - 2.2.1 kërkesa minimale e Kapitalit bazë të klasës së parë e filialës plus kapitali shtesë i kapitalit bazë të klasës së parë (d.m.th., 7.4% e mjeteve të peshuara me rrezik) dhe
 - 2.2.2 pjesa e kërkesës minimale të Kapitalit bazë të klasës së parë të konsoliduar plus kapitali shtesë i kapitalit bazë të klasës së parë (d.m.th., 7.4% i mjeteve të peshuara me rrezik të konsoliduara) që lidhet me filialën.
 - 2.3 Shuma e tepricës së Kapitalit bazë të klasës së parë që i atribuohet aksionarëve të interesit pakicë llogaritet duke shumëzuar tepricën e Kapitalit bazë të klasës së parë me përqindjen e Kapitalit bazë të klasës së parë që mbahet nga aksionarët e interesit pakicë.

Neni 18

Kapitali i kualifikuar i klasës së parë i emtuar nga filialet e konsoliduara

1. Instrumentet e Kapitalit të klasës së parë të emtuara nga filiala e bankës e konsoliduar plotësisht tek investitorët si palë e tretë (përfshirë shumat e specifikuara në nenin 17 të kësaj rregullore), mund të pranohen si kapital i klasës së parë vetëm atëherë kur instrumentet e emtuara nga banka i kanë përmbushur të gjitha kriteret për t'u klasifikuar si Kapital i klasës së parë.
2. Shuma e kapitalit që do të prahohet si Kapital i klasës së parë në pajtueshmëri me paragrafin 1 të këtij neni llogaritet si në vijim:
 - 2.1 Gjithsej kapitalit të klasës së parë të filialës i emtuar ndaj palëve të treta i zbritet shuma e tepricës së Kapitalit të klasës së parë të filialës që i atribuohet investitorëve si palë të treta;
 - 2.2 Teprica e Kapitalit të klasës së parë e filialës llogaritet si Kapitali i klasës së parë i filialës minus vlera më e ulët nga:
 - 2.2.1 kërkesa minimale për Kapitalin e klasës së parë të filialës plus Kapitali shtesë i Kapitalit bazë të klasës së parë (d.m.th., 9.0% e mjeteve të peshuara me rrezik) dhe
 - 2.2.2 pjesa e kërkesës minimale të Kapitalit të klasës së parë të konsoliduar plus Kapitali shtesë i Kapitalit bazë të klasës së parë (d.m.th., 9.0% e mjeteve të peshuara me rrezik) që i takon filialës.
 - 2.2.3 Shuma e tepricës së Kapitalit të klasës së parë që i atribuohet investitorëve si palë e tretë llogaritet duke shumëzuar tepricën e Kapitalit të klasës së parë me përqindjen e Kapitalit të klasës së parë që mbahet nga investitorët si palë të treta.
3. Shuma e Kapitalit të klasës së parë të referuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, që do të pranohet si Kapital shtesë i klasës së parë do të përjashtojë shumën e cila pranohet si Kapital bazë i klasës së parë sipas nenit 17 të kësaj rregullore.

Neni 19

Kapitali i kualifikuar si Kapital i klasës së parë dhe klasës së dytë i emtuar nga filialet e konsoliduara

1. Instrumentet e Gjithsej Kapitalit (Instrumentet e Kapitalit të klasës së parë dhe të klasës së dytë) të emtuara nga filiala e konsoliduar plotësisht e bankës tek investitorët si palë të treta (duke përfshirë shumat nën nenin 17 dhe 18 të kësaj rregullore) mund të pranohen në Totalin e Kapitalit vetëm në rast se instrumentet, e lëshuara nga banka, plotësojnë të gjitha kriteret për klasifikim si Kapital i klasës së parë apo i klasës së dytë.
2. Shuma e kapitalit që do të pranohet në Totalin e Kapitalit e konsoliduar në pajtueshmëri me paragrafin 1 të këtij neni llogaritet si në vijim:

- 2.1 Gjithsej instrumentet e kapitalit të filialës të emetuara për palët e treta minus shuma e tepricës së gjithsej kapitalit të filialës që i atribuohet investitorëve si palë të treta;
- 2.2 Teprica e Total Kapitalit të filialës llogaritet si Gjithsej Kapitali i filialës minus vlera më e ulët nga:
- 2.2.1 Kërkesa minimale për Total Kapitalin e filialës plus Kapitali shtesë i kapitalit bazë të klasës së parë (d.m.th.,12.0% e mjeteve të peshuara me rrezik); dhe
- 2.2.2 pjesa e kërkesës minimale të Total Kapitalit të konsoliduar plus kapitali shtesë i kapitalit bazë të klasës së parë (d.m.th.,12.0% e mjeteve të peshuara me rrezik të konsoliduara) që lidhet me filialën.
- 2.3 Shuma e tepricës së Total Kapitalit që i atribuohet investitorëve si palë të treta llogaritet duke shumëzuar tepricën e Total Kapitalit me përqindjen e Gjithsej Kapitalit që mbahet nga investitorët si palë të treta.
3. Shuma e Total Kapitalit që do të pranohet në Kapitalin e klasës së dytë do të përjashtojë shumat e pranuar në Kapitalin bazë të klasës së parë sipas nenit 17 të kësaj rregullore dhe shumat e pranuar në Kapitalin shtesë të klasës së parë sipas nenit 18 të kësaj rregullore.
4. Në rastet kur kapitali është emtuar ndaj palëve të treta me përjashtim nga ndonjë entitet me qëllime specifike (ang. SPV), nuk mund të përfshihet në Kapitalin bazë të klasës së parë.
5. Përjashtimisht, Kapitali i përshkruar në paragrafin 4 të këtij neni, mund të përfshihet në Kapitalin shtesë të klasës së parë apo të klasës së dytë në nivel të konsoliduar dhe të trajtohet sikurse të ishte emtuar nga vet banka ndaj palëve të treta, vetëm nëse i plotëson të gjitha kriteret relevante për përfshirje dhe aset i vetëm i entitetit për qëllime specifike (ang.SPV) është investimi në kapitalin e bankës në një mënyrë që i plotëson apo i tejkalon të gjitha kriteret relevante të përfshirjes (sipas nënparagrafit 1.14 për Kapitalin shtesë të klasës së parë të nenit 10 të kësaj rregullore dhe nënparagrafit 1.9 të paragrafit 1 për Kapitalin e klasës së dytë të nenit 13 të kësaj rregullore).
6. Në rastet kur kapitali është emtuar ndaj palëve të treta përmes një entiteti me qëllime specifike (ang. SPV) nëpërmes një filiale plotësisht të konsoliduar të bankës, i cili është në përputhje me kërkesat e këtij paragrafi, mund të trajtohet sikur të jetë emtuar direkt ndaj palëve të treta dhe mund të përfshihet në nivel të konsoliduar në Kapitalin shtesë të klasës së parë apo në kapitalin e klasës së dytë në përputhje me trajtimin e përshkruar në këtë nen dhe nenin 18 të kësaj rregullore.

Neni 20

Përshtatjet shtesë të vlerës

Bankat duhet të aplikojnë kërkesat për vlerësim prudencial të të gjitha mjeteve të tyre në librin tregtar të cilat maten sipas vlerës së drejtë gjatë llogaritjes së kërkesave për kapital dhe duhet të

zbresin nga Kapitali bazë i klasës së parë shumën e ndonjë rregullimi shtesë të nevojshëm të vlerës.

Neni 21

Përshtatjet Rregullative

Përshtatjet e përcaktuara në nenet 22 deri 29 të kësaj rregullore aplikohen në llogartijen e Kapitalit bazë të klasës së parë.

Neni 22

Humbjet nga viti financiar aktual

Bankat duhet të zbresin nga Kapitali bazë i klasës së parë humbjet nga viti financiar aktual.

Neni 23

Emri i mirë (goodwill) dhe mjetet tjera të paprekshme (me përjashtim të të drejtave të servisimit të hipotekave)

1. Emri i mirë dhe të gjitha mjetet tjera të paprekshme duhet të zbriten nga llogaritja e Kapitalit bazë të klasës së parë, përfshirë çdo “emër të mirë” i cili është përfshirë gjatë vlerësimit të investimeve të rëndësishme në kapitalin e bankave, entiteteve financiare apo të sigurimit të cilat nuk janë pjesë e konsolidimeve rregullatore.
2. Me përjashtim të të drejtave për servisim të hipotekave, duhet të zbritet shuma e plotë, neto nga çdo detyrim tatimor i shtyrë i cili do të zbritet nëse mjetet e paprekshme do të përkeqësohen apo do të çregjistrohen sipas standardeve të aplikuara të kontabilitetit.
3. Shuma që duhet të zbritet sa i përket të drejtave të servisimit të hipotekave është përcaktuar në nenin 34 të kësaj rregullore.

Neni 24

Mjetet tatimore të shtyra

1. Mjetet tatimore të shtyra që mbështeten në profitabilitetin e ardhshëm të bankës për tu realizuar, duhet të zbriten gjatë llogaritjes së Kapitalit bazë të klasës së parë.
2. Mjetet tatimore të shtyra mund të netohen (kompensohen) me detyrimet tatimore të shtyra vetëm nëse mjetet dhe detyrimet e tilla lidhen me tatimet e grumbulluara nga i njëjti autoritet tatimor dhe lejohet kompensimi i tyre nga autoriteti tatimor.
3. Në rastet kur mjetet tatimore të shtyra të referuara në paragrafin 1 të këtij neni lidhen me diferencat e perkohëshme, shuma që duhet të zbritet është përcaktuar në nenin 34 “limitet e

zbritjeve” të kësaj rregulloreje. Të gjitha mjetet e tilla të tjera duhet të zbriten plotësisht, neto nga detyrimet tatimore të shtyra siç është përcaktuar më sipër.

4. Detyrimet tatimore të shtyra që lejohen të netohen (kompensohen) kundrejt mjeteve tatimore të shtyra, duhet të përjashtojnë shumat që janë kompensuar kundrejt zbritjes së emrit të mirë, pasurive të paprekshme dhe fondeve pensionale të shumave të caktuara, dhe duhet të alokohen në baza proporcionale ndërmjet mjeteve tatimore të shtyra subjekt i trajtimit sipas nenit 34 “limitet e zbritjeve” dhe detyrimeve tatimore të shtyra që duhet të zbriten plotësisht.

Neni 25

Rezerva mbrojtëse e rrjedhës së parasë

1. Shuma e rezervës mbrojtëse e rrjedhës së parasë që lidhet me mbrojtjen e zërave që nuk janë vlersuar drejtë në bilancin e gjendjes (duke përfshirë rrjedhat e parashikuara të parasë) duhet të çregjistrohet në llogaritjen e Kapitalit bazë të klasës së parë.
2. Shumat pozitive në paragrafin 1 të këtij neni duhet të zbriten dhe shumat negative duhet të mbledhen.
3. Trajtimi sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni në mënyrë specifike identifikon elementin e rezervës mbrojtëse të rrjedhës së parasë i cili duhet të çregjistrohet për qëllime prudenciale.

Neni 26

Mungesa e provizioneve/rezervave ndaj humbjeve të pritura

1. Zbritja nga kapitali sa i përket mungesës provizioneve/rezervave ndaj humbjeve të pritura sipas qasjes së vlerësimeve të brendshme për rrezikun kreditor, duhet të bëhet gjatë llogaritjes së Kapitalit bazë të klasës së parë.
2. Për provizionet/rezervat e referuara në paragrafin 1 të këtij neni duhet të zbritet shuma e plotë dhe nuk duhet të zvogëlohet nga ndonjë efekt tatimor që pritet të ndodhë nëse provizionet / rezervat do të rriteshin në nivelin e humbjeve të pritura.

Neni 27

Fitimi në shitje nga transaksionet e sekjuritizimit

Bankat gjatë llogaritjes së Kapitalit bazë të klasës së parë duhet të çregjistrojnë çdo rritje në kapital që rezulton nga transaksionet e sekjuritizimit, të tilla si ato që lidhen me të ardhurat e ardhshme marginale të prishme si rezultat i fitimit nga shitja.

Neni 28

Fitimet dhe humbjet kumulative për shkak të ndryshimeve në rrezikun kreditor të bankës për detyrimet financiare të vlerësuara sipas vlerës së drejtë

Bankat duhet të çregjistrojnë në llogaritjen e Kapitalit bazë të klasës së parë, të gjitha fitimet dhe humbjet e përcaktuara që kanë rezultuar nga ndryshimet në vlerën e drejtë të detyrimeve si rezultat i ndryshimeve të rrezikut kreditor të bankës.

Neni 29

Mjetet dhe detyrimet e fondit pensionale të shumave të caktuara

1. Detyrimet e fondit pensional të shumave të caktuara, siç përfshihen në bilancin e gjendjes, duhet të jenë plotësisht të pranuar në llogaritjen e Kapitalit bazë të klasës së parë (Kapitali bazë i klasës së parë nuk mund të rritet përmes mos njohjes së këtyre detyrimeve).
2. Për çdo fond pensional të shumave të caktuara përfitime të përcaktuara që është mjet në bilancin e gjendjes, mjeti duhet të zbritet në llogaritjen e Kapitalit bazë të klasës së parë neto nga çdo detyrim tatimor i shtyrë i lidhur me të, që do të zbritet nëse mjeti do të kishte humbje në vlerë apo çregjistrohej sipas standardeve të aplikueshme të kontabilitetit.

Neni 30

Investimet në aksionet e veta (aksionet e thesarit)

1. Bankat duhet të zbresin të gjitha investimet e tyre në aksionet e tyre të zakonshme, qoftë të mbajtura direkt apo indirekt në llogaritjen e Kapitalit bazë të klasës së parë (përveç nëse janë të çregjistruara sipas standardeve të aplikuar të kontabilitetit). Gjithashtu, çdo aksion i bankës të cilin banka është e detyruar sipas kontratës ta blejë duhet të zbritet në llogaritjen e Kapitalit bazë të klasës së parë.
2. Trajtimi i përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni duhet të aplikohet pavarësisht nëse ekspozimi ndodhet në librin bankës apo në librin tregtar. Përveç kësaj:
 - 2.1 Pozicionet e gjata bruto mund të zbriten neto nga pozicionet e shkurta në të njëjtin ekspozim bazë vetëm nëse pozicionet e shkurta nuk përfshijnë rrezikun e kundërpalës;
 - 2.2 Bankat duhet që përmes mbajtjes së letrave me vlerë indeks të zbresin ekspozimet e aksioneve të veta të zakonshme. Megjithatë, pozicionet e gjata bruto në aksionet e veta që rezultojnë nga mbajtja e letrave me vlerë indeks mund të netohen kundrejt pozicioneve të shkurta në aksionet e veta që rezultojnë nga pozicionet e shkurta në të njëjtin indeks bazë. Në raste të tilla pozicionet e shkurta mund të përfshijnë rrezikun e kundërpalës (që do të jetë subjekt i kërkesave të kapitalit për rrezikun kreditor të kundërpalës).

3. Duke ndjekur të njëjtën qasje të përshkruar në paragrafin 2, bankat duhet të zbresin investimet në Kapitalin shtesë të klasës së parë në llogaritjen e Kapitalit shtesë të klasës së parë të tyre dhe duhet të zbresin investimet në Kapitalin e klasës së dytë të tyre në llogaritjen e Kapitalit të klasës së dytë.

Neni 31

Pjesëmarrjet reciproke në kapitalin e bankave, entiteteve financiare dhe entiteteve të sigurimeve

1. Pjesëmarrjet reciproke të kapitalit që janë të projektuara për të fryrë artificialisht pozicionin e kapitalit të bankave duhet të zbriten plotësisht.
2. Bankat duhet të aplikojnë një “qasje të zbritjes korresponduese” ndaj investimeve të tilla në kapitalin e bankave të tjera, institucioneve të tjera financiare dhe entiteteve të sigurimeve.
3. Zbritja duhet të aplikohet ndaj të njëjtit element të kapitalit për të cilin kapitali do të kualifikohej sikur të ishte emetuar nga vet banka.

Neni 32

Investimet në kapitalin e bankave, entiteteve financiare dhe entiteteve të sigurimeve që janë jashtë fushëveprimit të konsolidimit rregullator dhe ku banka nuk ka në pronësi më tepër se (5%) të kapitalit aksionar të zakonshëm të emetuar nga entiteti

1. Rregullimi i përshkruar në këtë nen aplikohet për investimet në kapitalin e bankave, entiteteve financiare dhe entiteteve të sigurimeve që janë jashtë fushëveprimit të konsolidimit rregullator dhe ku banka nuk zotëron më tepër se (5%) të kapitalit aksionar të zakonshëm të emetuar nga entiteti. Gjithashtu:
 - 1.1 Investimet përfshijnë pjesëmarrjet direkte, indirekte dhe sintetike të instrumenteve të kapitalit;
 - 1.2 Pjesëmarrjet në librin e bankës dhe në librin tregtar duhet të përfshihen. Kapitali përfshin aksionet e zakonshme dhe të gjitha llojet e tjera të parasë dhe instrumentet sintetike të kapitalit;
 - 1.3 Duhet të përfshihet pozicioni i gjatë neto (d.m.th., pozicioni i gjatë bruto, neto nga pozicionet e shkurta në të njëjtin ekspozim bazë ku maturiteti i pozicionit të shkurtë ose përputhet me maturitetin e pozicionit të gjatë ose ka maturitetin e mbetur së paku një vit);

- 1.4 Pozicionet e nënshkrimit të letrave me vlerë të mbajtura për pesë ditë pune apo më pak mund të përjashtohen. Pozicionet e nënshkrimit të letrave me vlerë të mbajtura më gjatë se pesë ditë pune duhet të përfshihen;
- 1.5 Nëse instrumenti i kapitalit të entitetit në të cilin banka ka investuar nuk i plotëson kriteret për Kapitalin bazë të klasës së parë, Kapitalin shtesë të klasës së parë, apo Kapitalin e klasës së dytë të bankës, kapitali duhet të konsiderohet si aksione të zakonshme për qëllime të kësaj përshtatje rregullative.
2. Nëse totali i të gjitha pjesëmarrjeve të listuara më sipër në paragrafin 1 (duke përjashtuar ekspozimet ndaj personave të ndërlidhur me bankën), në nivel agregat tejkalon 10% të kapitalit aksionar të bankës (pasi janë aplikuar plotësisht të gjitha përshtatjet rregullative të radhitura para këtij) atëherë shuma mbi 10% kërkohet të zbritet, duke aplikuar qasjen e zbritjes korresponduese.
 3. Zbritja duhet të aplikohet ndaj elementit të njëjtë të kapitalit për të cilin kapitali do të kualifikohej nëse do të ishte emetuar nga vet banka.
 4. Shuma e referuar në paragrafin 3 që duhet të zbritet nga kapitali aksionar duhet të llogaritet si totali i të gjitha pjesëmarrjeve që në nivel agregat tejkalon 10% të kapitalit aksionar të bankës të shumëzuar me pjesëmarrjet e kapitalit aksionar si përqindje e gjithsej pjesëmarrjes së kapitalit. Kjo do të rezultojë në një zbritje në kapitalin aksionar që korrespondon me proporcionin e gjithsej pjesëmarrjes në kapital të mbajtur në kapitalin aksionar.
 5. Shuma që duhet të zbritet nga Kapitali shtesë i klasës së parë duhet të llogaritet si total i të gjitha pjesëmarrjeve që në nivel agregat tejkalojnë 10% të kapitalit aksionar të bankës të shumëzuar me pjesëmarrjet në kapital të Kapitalit shtesë të klasës së parë si përqindje e gjithsej pjesëmarrjeve kapitale.
 6. Shuma që duhet të zbritet nga Kapitali i klasës së dytë duhet të llogaritet si total i të gjitha pjesëmarrjeve që në nivel agregat tejkalojnë 10% të kapitalit aksionar të bankës (sikurse më sipër) të shumëzuar me pjesëmarrjet në Kapitalin e klasës së dytë si përqindje e gjithsej pjesëmarrjeve kapitale.
 7. Nëse, sipas qasjes së zbritjes korresponduese, bankës i kërkohet të bëjë një zbritje nga një klasë e caktuar e kapitalit dhe banka nuk ka shumë të mjaftueshme nga ajo klasë e kapitalit për të përmbushur zbritjen e tillë, mungesa do të zbritet nga klasa tjetër më e lartë e kapitalit.
 8. Shumat nën limitin e përcaktuar, të cilat nuk janë zbritur, do të peshohen me rrezik. Kështu që, instrumentet në librin tregtar do të trajtohen sipas rregullave për rrezikun e tregut dhe instrumentet në librin e bankës do të trajtohen me qasjen e bazuar në vlerësimet e brendshme të bankës për rrezikun kreditor apo qasjen e standardizuar (sipas aplikimit). Për aplikimin e peshimeve me rrezik shuma e pjesëmarrjeve duhet të alokohet në baza proporcionale në mes të atyre shumave nën limit dhe atyre shumave mbi limit.

Neni 33

Investimet e konsiderueshme në kapitalin e bankave, entiteteve financiare dhe e entiteteve të sigurimeve që janë jashtë fushëveprimit të konsolidimit rregullator

1. Pershtatja rregullative e përcaktuar në këtë nen aplikohet për investimet në kapitalin e bankave, entiteteve financiare dhe entiteteve të sigurimeve që janë jashtë fushëveprimit të konsolidimit rregullator ku banka ka në pronësi më tepër se (5%) të kapitalit aksionar të emetuar nga entiteti emetues apo ku entiteti është filialë e bankës. Gjithashtu:
 - 1.1 Investimet përfshijnë pjesëmarrjet direkte, indirekte dhe sintetike të instrumenteve të kapitalit;
 - 1.2 Pjesëmarrjet në librin e bankës dhe në librin tregtar duhet të përfshihen. Kapitali përfshin aksionet e zakonshme dhe të gjitha llojet e tjera të parasë dhe instrumentet sintetike të kapitalit;
 - 1.3 Duhet të përfshihet pozicioni i gjatë neto (d.m.th., pozicioni i gjatë bruto, neto nga pozicionet e shkurta në të njëjtin ekspozim bazë ku maturiteti i pozicionit të shkurtë ose përputhet me maturitetin e pozicionit të gjatë ose ka maturitetin e mbetur së paku një vit);
 - 1.4 Pozicionet e nënshkrimit të letrave me vlerë të mbajtura për pesë ditë pune apo më pak mund të përjashtohen;
 - 1.5 Pozicionet e nënshkrimit të letrave me vlerë të mbajtura më gjatë se pesë ditë pune duhet të përfshihen;
 - 1.6 Nëse instrumenti i kapitalit të entitetit në të cilin banka ka investuar nuk i plotëson kriteret për Kapitalin bazë të klasës së parë, Kapitalin shtesë të klasës së parë, apo Kapitalin e klasës së dytë të bankës, kapitali duhet të konsiderohet si aksione të zakonshme për qëllime të kësaj përshtatje rregullative.
2. Të gjitha investimet e përfshira më sipër në paragrafin 1 (duke përjashtuar ekspozimet ndaj personave të ndërlidhur me bankën) që nuk janë aksione të zakonshme duhet të zbriten plotësisht duke aplikuar qasjen e zbritjes korresponduese. Kjo do të thotë që zbritja duhet të aplikohet ndaj klasës së njëjtë të kapitalit për të cilën kapitali do të kualifikohet sikur të ishte emetuar nga vet banka. Nëse nga banka kërkohet që të bëjë zbritjen nga një klasë e caktuar e kapitalit dhe nuk ka shumë të mjaftueshme nga ajo klasë e kapitalit për të përmbushur zbritjen, mungesa do të zbritet nga klasa tjetër më e lartë e kapitalit (p.sh. nëse banka nuk ka mjaftueshëm Kapital shtesë të klasës së parë për të përmbushur zbritjen, mungesa do të zbritet nga Kapitali bazë i klasës së parë).

- Investimet e përfshira më sipër në paragrafin 1 të këtij neni që janë aksione të zakonshme janë subjekt i trajtimit të limiteve të përkruara në nenin 34.

Neni 34

Limitet e zbritjeve

- Në vend që të zbriten plotësisht, secili nga zërat në vijim mund të njihet deri në një limit gjatë llogaritjes së Kapitalit bazë të klasës së parë, me njohjen e limituar në 10% të kapitalit aksionar të bankës (pas aplikimit të të gjitha përshtatjeve rregullative të përcaktuara në nenin 31), kolektivisht të referuar si zëra të specifikuar:
 - Investimet e konsiderueshme në aksionet e zakonshme të institucioneve financiare jo të konsoliduara (bankat, entitetet e sigurimeve dhe entitetet tjera financiare) të referuara në nenin 33;
 - Të drejtat e servisimit të hipotekave;
 - Mjetet tatimore të shtyra që rrjedhin nga diferencat e përkohshme.
- Shuma e tre zërave në paragrafin 1, nënparagrafet 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni, që nuk është zbritur në llogaritjen e Kapitalit bazë të klasës së parë duhet të peshohet me rrezik prej 250%.
- Bankat duhet të zbresin shumën për të cilën totali i tre zërave të mësipërm të përcaktuar në paragrafin 1 nënparagrafet 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni tejkalon 15% të Kapitalit të klasës së parë (të llogaritur para zbritjes së këtyre zërave por pas aplikimit të të gjitha përshtatjeve tjera rregullatore të aplikuara në llogaritjen e Kapitalit bazë të klasës së parë).
- Shuma e tre zërave që pranohet pas aplikimit të përshtatjeve rregullatore nuk duhet të tejkalojë 15% të Kapitalit bazë të klasës së parë.
- Për të përcaktuar shumën maksimale të zërave të specifikuar që mund të njihen, bankat duhet të shumëzojnë shumën e Kapitalit bazë të klasës së parë (pas të gjitha zbritjeve, duke përfshirë edhe zbritjen e plotë të zërave të specifikuar) me 17.65%.
- Zërat e përfshirë në limitin agregat prej 15% janë subjekt i shpalosjes së plotë.

Neni 35

Investimet në kapitalin e entiteteve të sigurimeve

- Banka që ka në pronësi një filialë të sigurimeve i bartë rreziqet e plota sipërmarrëse të filialës dhe duhet të njohë në bazë grupore rreziqet e përfshira në të gjithë grupin.
- Për të llogaritur Kapitalin bazë të klasës së parë bankat duhet të zbresin të gjithë kapitalin dhe investimet tjera kapitale rregullatore në filialet e sigurimeve dhe gjithashtu investimet e konsiderueshme të interesave të pakontrolluara në entitetet e sigurimeve.

3. Banka duhet shlyejë nga bilanci i saj i gjendjes mjetet dhe detyrimet, si dhe investimet kapitale të palëve të treta në një filialë të entitetit të sigurimeve.

Neni 36

Investimet në kapitalin e entiteteve jo-financiare

1. Për të llogaritur Kapitalin bazë të klasës së parë, bankat duhet të zbresin të gjithë interesin e kapitalit në një entitet juridik që është i angazhuar në aktivitete tjera përveç aktiviteteve financiare, nëse interesat e tilla:
 - 1.1 përfaqësojnë më shumë se pesë përqind (5%) të interesit në personin juridik;
 - 1.2 tejkalojnë pesëmbëdhjetë përqind (15%) të kapitalit rregullativ të bankës; apo
 - 1.3 kur bashkohen me të gjitha interesat e tilla të kapitalit të mbajtura nga banka në shoqëritë jofinanciare, tejkalon njëzet e pesë përqind (25%) të kapitalit rregullator të bankës.

Neni 37

Kërkesat minimale për të siguruar absorbimin e humbjeve në momentin e paaftësisë së operimit të bankës

1. Instrumentet e Kapitalit shtesë të klasës së parë dhe të Kapitalit të klasës së dytë duhet të absorbojnë humbjet plotësisht në momentin e paaftësisë së operimit të bankës emetuese.
2. Momenti i paaftësisë operuese nënkupton momentin kur BQK përcakton se banka i plotëson kushtet për procesin e likuidimit “resolution” ose momentin kur BQK vendos që banka nuk do të mund të operonte nëse instrumentet e tilla të kapitalit nuk do të shlyhen apo konvertohen.
3. Termat dhe kushtet e instrumenteve të kapitalit të klasës së parë dhe të klasës së dytë që nuk janë të zakonshme, të emetuara nga banka, duhet të kenë një dispozitë që kërkon nga instrumentet e tilla që ato të shlyhen apo të konvertohen në kapital aksionar sipas zgjedhjes së BQK-së, në rast të ndodhjes së një ngjarje aktivizuese.
4. Çdo kompensim i paguar ndaj zotëruesve të instrumenteve si rezultat i shlyerjes duhet të paguhet menjëherë në formë të aksioneve të zakonshme.
5. Bankat emetuese duhet të mbajnë në çdo kohë të gjitha autorizimet paraprake të nevojshme për të emetuar menjëherë numrin e caktuar të aksioneve të specikuara në termat dhe kushtet e instrumentit në rast të ndodhjes së ndonjë ngjarje aktivizuese.
6. Emetimi i çdo aksioni të ri si rezultat i ngjarjes aktivizuese duhet të ndodhë para dhënies së kapitalit nga sektori publik në mënyrë që kapitali i dhënë nga sektori publik mos të zvogëlohet.

Neni 38
Planifikimi i kapitalit

BQK-ja kërkon nga bankat që të zhvillojnë një proces të brendshëm të planifikimit të adekuatshmërisë së kapitalit, në raport me profilet e tyre të rrezikut, i cili në vazhdimësi paraqet nivelin e adekuatshmërisë së kapitalit të vlerësuar nga ana e bankës. Procesi i brendshëm i planifikimit të adekuatshmërisë së kapitalit nga bankat, do të jetë subjekt i vlerësimit nga ana e BQK-së.

Neni 39
Kërkesat e shpalosjes

1. Për të ndihmuar përmirësimin e transparencës së kapitalit rregullator dhe për të përmirësuar disiplinën e tregut, bankave u kërkohet që të shpalosin informacionet në vijim:
 - 1.1 pajtueshmëria e plotë e të gjitha elementeve të kapitalit rregullator nga bilanci i gjendjes në pasqyrat e audituara financiare;
 - 1.2 shpalosja e ndarë e të gjitha pershtatjeve rregullative dhe të zërave që nuk janë zbritur nga Kapitali bazë i klasës së parë sipas nenit 32;
 - 1.3 një përshkrim i të gjitha kufizimeve dhe kërkesave minimale, duke identifikuar elementet pozitive dhe negative të kapitalit ndaj të cilave aplikohen kufizimet dhe kërkesat minimale;
 - 1.4 një përshkrim i karakteristikave kryesore të instrumenteve të kapitalit të emetuara;
 - 1.5 bankat të cilat shpalosin tregues që përfshijnë elemente të kapitalit rregullator, duhet t’iu bashkëngjeshin shpalosjeve të tilla shpjegime të plota se si janë llogaritur këta tregues.
2. Bankave iu kërkohet gjithashtu t’i publikojnë në faqet e tyre të internetit të gjitha termet dhe kushtet të të gjitha instrumenteve të përfshira në kapitalin rregullator.

KAPITULLI III

SHUMA E MJETEVE TË PESHUARA ME RREZIK PËR RREZIKUN KREDITOR

Neni 40
Dispozitat e përgjithshme

1. Ky kapitull përcakton rregullat për llogaritjen e kërkesave për kapital për rrezikun kreditor sipas Qasjes së Standardizuar për bankat. Ky kapitull përcakton:

- 1.1 përcaktimin e vlerës së ekspozimit;
- 1.2 definicionin e klasave të ekspozimit; dhe
- 1.3 llogaritjen e shumës së ekspozimeve të peshuara me rrezik;
2. Bankat, për qëllim të llogaritjes së kapitalit rregullator për rrezikun kreditor, duhet të përdorin Qasjen e Standardizuar.
3. Kërkesa për kapital për rrezikun kreditor duhet të jetë e barabartë së paku me shumën minimale prej 12% të gjithsej ekspozimeve të peshuara me rrezik të llogaritura sipas nenit 43 të kësaj rregulloreje.
4. Shuma e ekspozimeve të peshuara me rrezik për rrezikun kreditor përfaqëson shumën e gjithsej mjeteve bilancore dhe zërave jashtëbilancor të shumëzuar me peshimet kreditore përkatëse.
5. Për qëllim të llogaritjes së shumës së ekspozimeve të peshuara me rrezik, bankat duhet të përdorin vlerësimet kreditore nga një Institucion për vlerësime të jashtme kreditore (IVJK) e pranuar apo nga një Agjenci e Kreditimit të Eksporteve (AKE) e njohur nga BQK në përputhje me dispozitat e përcaktuara në “Rregulloren për përdorimin e vlerësimeve të jashtme kreditore për qëllim të llogaritjes së Kapitalit Rregullativ”.

Neni 41

Vlera e ekspozimit

1. Vlera e ekspozimit të një zëri bilancor është vlera kontabël e tij pas zbritjes së shumës së rezervave specifike, shumës së kolateralit apo ndonjë zbritje tjetër e cila mund të aplikohet lidhur me këtë ekspozim.
2. Vlera e ekspozimit të një zëri jashtëbilancor të listuar në Aneksin I të kësaj rregulloreje duhet të jetë përqindja në vijim e vlerës nominale të tij pas zbritjes së shumës së rezervave specifike, shumës së kolateralit apo ndonjë zbritje tjetër e cila mund të aplikohet:
 - 2.1 100 % për kategorinë me rrezik të lartë;
 - 2.2 50 % për kategorinë me rrezik të mesëm;
 - 2.3 20 % për kategorinë me rrezik të mesëm/të ulët;
 - 2.4 0 % për kategorinë me rrezik të ulët.
3. Zërat jashtëbilancor të referuar në paragrafin e dytë të këtij neni, duhet të trajtohen sipas kategorive të rrezikut të përcaktuara në Aneksin I të kësaj rregulloreje.
4. Në rastet kur një ekspozim është subjekt i mbrojtjes së financuar kreditore, vlera e tij mund të trajtohet në përputhje me Kapitullin IV të kësaj rregulloreje.

5. Vlera e ekspozimit duhet të përcaktohet në përputhshmëri me Rregulloren për Raportimin e Bankave.

Neni 42

Klasat e ekspozimeve

1. Për qëllim të llogaritjes së shumës së ekspozimeve të peshuara me rrezik, bankat duhet të klasifikojnë çdo ekspozim, përveç rasteve kur këto ekspozime zbriten nga kapitali rregullator, në njërin nga klasat e ekspozimit të paraqitura më poshtë:
 - 1.1 ekspozimet ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;
 - 1.2 ekspozimet ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;
 - 1.3 ekspozimet ndaj entiteteve të sektorit publik;
 - 1.4 ekspozimet ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;
 - 1.5 ekspozimet ndaj organizatave ndërkombëtare;
 - 1.6 ekspozimet ndaj institucioneve;
 - 1.7 ekspozimet ndaj korporatave;
 - 1.8 ekspozimet ndaj individëve dhe bizneseve të vogla dhe të mesme;
 - 1.9 ekspozimet e siguruara me kolateral të paluajtshëm;
 - 1.10 ekspozimet jo-performuese;
 - 1.11 ekspozimet e kategorizuara me rrezik të lartë;
 - 1.12 ekspozimet ndaj institucioneve dhe korporatave me vlerësime kreditore afatshkurta;
 - 1.13 ekspozimet ndaj fondeve investive;
 - 1.14 ekspozimet ndaj ekuitetit të entiteteve;
 - 1.15 ekspozimet tjera.

Neni 43

Llogaritja e shumës së ekspozimit të peshuar me rrezik

1. Bankat, për llogaritjen e vlerës së ekspozimit të peshuar me rrezik, do të zbatojnë peshat e rrezikut për të gjitha ekspozimet, përveç rasteve kur këto ekspozime zbriten nga kapitali rregullator, në pajtueshmëri me nenet 44 deri 58 të kësaj rregulloreje. Aplikimi i peshimit me rrezik i një ekspozimi duhet të bazohet në klasën e ekspozimit në të cilën është i përcaktuar ky ekspozim dhe në cilësinë kreditore. Cilësia kreditore mund të përcaktohet duke iu referuar vlerësimeve kreditore nga ana e Institucioneve për vlerësime të jashtme kreditore (IVJK-ve) ose vlerësimeve kreditore nga Agjencitë e Kreditimit të Eksporteve (AKE) në përputhje me

“Rregulloren e BQK-së për përdorimin e vlerësimeve të jashtme kreditore për qëllim të llogaritjes së kapitalit rregullativ”.

2. Për qëllim të zbatimit të peshës me rrezik, referuar paragrafit 1 të këtij neni, bankat duhet të shumëzojnë vlerën e ekspozimit me peshën e rrezikut të përcaktuar në këtë kapitull.
3. Në rastet kur një ekspozim është subjekt i teknikave të zbutjes së rrezikut kreditor, peshimi me rrezik i aplikuar për atë ekspozim mund të ndryshohet, në pajtim me kapitullin IV të kësaj rregullore.
4. Ekspozimet, për të cilat nuk janë parashikuar peshat e rrezikut në këtë kapitull, duhet të peshohen me rrezik prej 100%.

Neni 44

Ekspozimet ndaj qeverive qendrore dhe bankave qendrore

1. Bankat duhet të peshojnë me rrezik 100%, ekspozimet ndaj qeverive qendrore dhe bankave qendrore të cilat nuk përfshihen në paragrafet 2 deri 6 të këtij neni.
2. Ekspozimet ndaj qeverive qendrore dhe bankave qendrore për të cilat ekziston një vlerësim kreditor nga IVJK e emëruar, duhet të peshohen me rrezik sipas tabelës 1 të këtij paragrafi , që korrespondon me vlerësimin kreditor nga IVJK.

Tabela 1.

Shkalla e cilësisë kreditore	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	0%	20%	50%	100%	100%	150%

3. Ekspozimet ndaj Bankës Qendrore Europiane (BQE) duhet të peshohen me rrezik 0%.
4. Ekspozimet ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës duhet të peshohen me rrezik 0%.
5. Ekspozimet ndaj Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës duhet të peshohen me rrezik 0%.
6. Ekspozimet ndaj qeverive qendrore dhe bankave qendrore për të cilat nuk ekziston apo nuk është kryer një vlerësim nga një IVJK e emëruar, duhet të peshohen sipas tabelës 2 të këtij paragrafi që korrespondon me vlerësimin kreditor nga një Agjenci e Kreditimit të Eksporteve (AKE) e njohur nga BQK.

Tabela 2.

Primet minimale të sigurimit të eksportit	0	1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---	---	---

Pesha e rrezikut	0%	0%	20%	50%	100%	100%	100%	150%
------------------	----	----	-----	-----	------	------	------	------

Neni 45

Ekspozimet ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale

1. Për qëllim të kësaj rregulloreje, qeveritë rajonale dhe autoritetet lokale do të konsiderohen si në vijim:
 - 1.1 në Republikën e Kosovës: komunat dhe fondet e krijuara dhe të financuara nga nivelet lokale;
 - 1.2 në shtetet tjera: njësitë e qeverive rajonale dhe autoriteteve lokale të trajtuara si qeveri rajonale apo njësi të pushtetit vendor sipas legjislacionit të atyre shteteve që rregullojnë veprimtarinë e bankave.
2. Ekspozimet ndaj qeverive rajonale dhe autoriteteve lokale duhet të peshohen me rrezik sikurse ekspozimet ndaj institucioneve (kushtet preferenciale për ekspozimet afatshkurta nuk duhet të aplikohen).
3. Ekspozimet ndaj qeverive rajonale dhe autoriteteve lokale, me miratimin paraprak të BQK-së, do të trajtohen si ekspozimet ndaj qeverive qendrore dhe bankave qendrore në juridiksionin ku janë themeluar në rastet kur nuk ka diferenca të rrezikut ndërmjet ekspozimeve të tilla, për arsye të kompetencave të veçanta në realizimin e të ardhurave ose të ekzistencës së një marrëveshjeje institucionale të veçantë që kanë efekt në zvogëlimin e rrezikut nga dështimi në kthimin e borxheve.
4. Pavarësisht nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, ekspozimet ndaj qeverive lokale në Republikën e Kosovës duhet të peshohen me rrezik 0%.

Neni 46

Ekspozimet ndaj entiteteve të sektorit publik

1. Për qëllim të kësaj rregulloreje, entitetet e sektorit publik do të konsiderohen organet administrative në varësi të qeverisë qendrore, qeverisë rajonale apo njësite të autoritetit lokal dhe subjektet juridike jo-fitimprurëse, të cilat garantojnë nga qeveria.
2. Ekspozimet ndaj entiteteve të sektorit publik për të cilat nuk ekziston ndonjë vlerësim nga një IVJK e emëruar, duhet të peshohen sipas tabelës 3 të këtij paragrafi bazuar në vlerësimin kreditor të ekspozimit të qeverisë qendrore ku është inkomporuar ky entitet publik:

Tabela 3.

Shkalla e cilësisë kreditore	1	2	3	4	5	6
------------------------------	---	---	---	---	---	---

Pesha e rrezikut	20%	50%	100%	100%	100%	150%
------------------	-----	-----	------	------	------	------

3. Ekspozimet ndaj entiteteve të sektorit publik të inkuorporuara në shtetet ku qeveria qendrore nuk ka vlerësim kreditor, duhet të peshohen me rrezik prej 100%.
4. Ekspozimet ndaj entiteteve të sektorit publik, të cilat kanë vlerësim kreditor nga një IVJK e emëruar, duhet të peshohen me rrezik sikurse ekspozimet ndaj institucioneve (kushtet preferenciale për ekspozimet afatshkurta nuk duhet të përdoren).
5. Ekspozimet ndaj entiteteve të sektorit publik në Republikën e Kosovës duhet të peshohen me rrezik prej 20%.
6. Në kushtet e jashtëzakonshme, me aprovimim paraprak të BQK-së, ekspozimet ndaj entiteteve të sektorit publik mund të trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore, qeverisë rajonale apo autoritetit lokal në juridiksionin e vendit në të cilin janë inkuorporuar, ku në bazë të vlerësimit nga autoritetet kompetente të këtij juridiksioni nuk ka dallime në rrezikun e këtyre ekspozimeve për shkak të ekzistimit të një garancie nga qeveria qendrore, qeveria rajonale apo autoriteti lokal.
7. Pavarësisht nga paragrafet më lartë të këtij neni, ekspozimet ndaj entiteteve të sektorit publik me maturitet origjinal prej 3 muaj apo më pak, duhet të peshohen me rrezik prej 20%.

Neni 47

Ekspozimet ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit

1. Ekspozimet ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit të cilat nuk janë përfshirë në paragrafin 3 të këtij neni duhet të trajtohen sikurse ekspozimet ndaj institucioneve (kushtet preferenciale për ekspozimet afatshkurtëra nuk duhet të përdoren).
2. Korporata investive inter-amerikane (The Inter-American Investment Corporation), Banka për Zhvillim dhe Tregëti e Detit të Zi (Black Sea Trade and Development Bank), Banka e Amerikës Qendrore për Integrim Ekonomik (Central American Bank for Economic Integration) dhe CAF- Banka për zhvillim e Amerikës Latine (CAF-Development Bank of Latin America) do të konsiderohen si bankat shumëpalëshe të zhvillimit.
3. Ekspozimet ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit të listuara më poshtë duhet të peshohen me rrezik 0%:
 - 3.1 Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (International Bank for Reconstruction and Development);
 - 3.2 Korporata Ndërkombëtare për Financa (International Finance Corporation);
 - 3.3 Banka Ndër-Amerikane për Zhvillim (Inter-American Development Bank);
 - 3.4 Banka Aziatike e Zhvillimit (Asian Development Bank);

- 3.5 Banka Afrikane për Zhvillim (African Development Bank);
 - 3.6 Banka e Këshillit të Europës për Zhvillim (Council of Europe Development Bank);
 - 3.7 Banka Nordike e Zhvillimit (Nordic Investment Bank);
 - 3.8 Banka e Karaibeve për Zhvillim (Caribbean Development Bank);
 - 3.9 Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (European Bank for Reconstruction and Development);
 - 3.10 Banka Europiane për Investim (European Investment Bank);
 - 3.11 Fondi European për Investim (European Investment Fund);
 - 3.12 Agjencia Shumëpalëshe për Garantimin e Investimeve (Multilateral Investment Guarantee Agency);
 - 3.13 Qendra Ndërkombëtare Financiare për Mbrojtje (International Finance Facility for Immunisation);
 - 3.14 Banka Islamike e Zhvillimit (Islamic Development Bank).
4. Peshimi me rrezik prej 20% duhet të përdoret për pjesën e kapitalit të papaguar të regjistruar në Fondin European për Investim (European Investment Fund).

Neni 48

Ekspozimet ndaj organizatave ndërkombëtare

1. Ekspozimet ndaj organizatave ndërkombëtare të listuara më poshtë do të peshohen me rrezik 0%:
 - 1.1 Unioni European (the European Union);
 - 1.2 Fondi Monetar Ndërkombëtar (the International Monetary Fund);
 - 1.3 Banka për Marrëveshje Ndërkombëtare (the Bank for International Settlements).

Neni 49

Ekspozimet ndaj institucioneve¹

1. Ekspozimet ndaj institucioneve që kanë vlerësim

- 1.1 Ekspozimet ndaj institucioneve me maturitet të mbetur prej më shumë se tre muaj dhe që kanë vlerësim nga një IVJK e emëruar duhet të peshohen me rrezik sipas tabelës 4 të këtij nën paragrafi që korrespondon me vlerësimin e cilësisë kreditore të IVJK-së.

¹ "institucione" janë institucionet kredidhënëse dhe shoqëritë investuese.

Tabela 4.

Shkalla e cilësisë kreditore	1	2	3	4	5	6
Peshimi me rrezik	20%	50%	50%	100%	100%	150%

1.2 Ekspozimet ndaj institucioneve me maturitet të mbetur jo më shumë se tre muaj të cilat kanë vlerësim kreditor nga një IVJK e emëruar duhet të peshohen me rrezik në bazë të tabelës 5, të këtij nën paragrafi që korrespondon me vlerësimin e IVJK-së për cilësinë kreditore.

Tabela 5.

Shkalla e cilësisë kreditore	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	20%	20%	20%	50%	50%	150%

1.3 Bashkëveprimi ndërmjet trajtimit të vlerësimit kreditor afatshkurtër sipas nenit 55 dhe trajtimit preferencial të përgjithshëm për ekspozimet afatshkurtëra të përcaktuar në nënparagrafin 1.2 të këtij paragrafi, është si në vijim:

1.3.1 Nëse nuk ekziston vlerësim afatshkurtër i ekspozimeve, trajtimi i përgjithshëm preferencial për ekspozimet afatshkurtëra siç është specifikuar në paragrafin 2 do të aplikohet për të gjitha ekspozimet ndaj institucioneve me maturitet të mbetur deri në tre muaj.

1.3.2 Nëse ekziston vlerësim afatshkurtër i cili përcakton aplikimin e peshimeve me rrezik më të favorshme apo të ngjashme sesa përdorimi i trajtimit preferencial të përgjithshëm për ekspozimet afatshkurtëra, siç është përcaktuar në nënparagrafin 1.2 të këtij paragrafi, në raste të tilla vlerësimi afatshkurtër do të përdoret vetëm për atë ekspozim specifik. Ekspozimet tjera afatshkurtëra duhet të peshohen sipas trajtimit preferencial të përgjithshëm siç është specifikuar në nënparagrafin 1.2 të këtij paragrafi;

1.3.3 Nëse ekziston një vlerësim afatshkurtër i cili përcakton peshimin me rrezik më pak të favorshëm sesa përdorimi i trajtimit të përgjithshëm preferencial për ekspozimet afatshkurtëra, siç është përcaktuar në nënparagrafin 1.2 të këtij paragrafi, në rastet e tilla trajtimi i përgjithshëm preferencial për ekspozimet afatshkurtëra nuk duhet të përdoret dhe të gjitha kërkesat afatshkurtëra që nuk kanë vlerësim do të peshohen me rrezik të njëjtë sikurse ato të aplikuara me vlerësim specifik afatshkurtër.

2. Ekspozimet ndaj institucioneve që nuk kanë vlerësim

2.1 Ekspozimet ndaj institucioneve që nuk kanë vlerësim nga një IVJK e emëruar duhet të peshohen me rrezik sipas vlerësimit kreditor të ekspozimeve ndaj qeverisë qendrore të shtetit ku është inkorporuar institucioni ku peshimi caktohet bazuar në vlerësimin e cilësisë kreditore sipas Tabelës 6 të këtij paragrafi.

Tabela 6.

Shkalla e cilësisë kreditore	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	20%	50%	100%	100%	100%	150%

2.2 Ekspozimet ndaj institucioneve që nuk kanë vlerësim dhe që janë të inkorporuara në shtetet që poashtu nuk kanë vlerësim kreditor duhet të peshohen me rrezik prej 100%.

2.3 Ekspozimet ndaj institucioneve që nuk kanë vlerësim dhe me maturitet efektiv të mbetur prej 3 muajve ose më pak duhet të peshohen me rrezik prej 20%.

2.4 Pavarësisht nga nenparagrafi 2.2 të këtij paragrafi , ekspozimet ndaj bankave të licencuara dhe të mbikëqyrura nga BQK me maturitet jo më të gjatë se një vit do të peshohen me rrezik prej 20%.

Neni 50

Ekspozimet ndaj korporatave

1. Ekspozimet të cilat kanë vlerësim kreditor nga një IVJK e emëruar duhet të peshohen sipas Tabelës 7 të këtij paragrafi që korrespondon me vlerësimin kreditor të IVJK-së.

Tabela 7.

Shkalla e cilësisë kreditore	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	20%	50%	100%	100%	150%	150%

2. Ekspozimet të cilat nuk kanë vlerësim kreditor duhet të peshohen me rrezik prej 100%, apo sipas peshimit me rrezik të ekspozimeve ndaj qeverisë qendrore të shtetit ku korporata është inkorporuar, cilido peshim të jetë më i lartë.

Neni 51

Ekspozimet ndaj individëve dhe bizneseve të vogla dhe të mesme

1. Ekspozimet të cilat i përmbushin kriteret e listuara më poshtë duhet të peshohen me rrezik prej 75%:
 - 1.1 ekspozimi duhet të jetë ndaj personit apo personave privat apo ndaj biznesit të vogël dhe të mesëm (BVM);
 - 1.2 ekspozimi duhet të jetë njëri nga numri i konsiderueshem i ekspozimeve me karakteristika të ngjashme në mënyrë që rreziqet e lidhura me kreditim të tillë janë zvogëluar në mënyrë substanciale;
 - 1.3 asnjë ekspozim agregat ndaj një pale në transaksion (huamarrësi) apo grup i tyre nuk mund të tejkalojë 0.2% të portfolios së kësaj klase të ekspozimit, apo nuk mund të tejkalojë shumën prej 100,000 € në vlerë absolute.
2. Letrat me vlerë nuk duhet të klasifikohen si ekspozimet ndaj individëve apo bizneseve të vogla dhe të mesme.
3. Kreditë hipotekare janë të përjashtuara nga ky peshim përderisa i përmbushin kriteret të listuara në Rregulloren për kreditë hipotekare rezidenciale.
4. Ekspozimet të cilat nuk i përmbushin kriteret sipas nënparagrafeve 1.1 deri 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni, në kuadër të kësaj klase të ekspozimit duhet të peshohen me rrezik prej 100%.

Neni 52

Ekspozimet e siguruara me kolateral të paluajtshëm

1. Ekspozimet e siguruara me pasuri të paluajtshme duhet të peshohen me rrezik prej 100%, me përjashtim të ekspozimeve në paragrafët 2 deri në 4 të këtij neni.
2. Kreditë hipotekare rezidenciale të kualifikuara – Kategoria A (KHRK-A) sipas rregullores së BQK-së për kreditë hipotekare rezidenciale, do të peshohen me rrezik prej 35%.
3. Kreditë hipotekare rezidenciale të kualifikuara – Kategoria B (KHRK-B) sipas rregullores së BQK-së për kreditë hipotekare rezidenciale, do të peshohen me rrezik prej 50%.
4. Bankat duhet të peshojnë me rrezik prej 75% kreditë apo pjesët e tyre të mbuluara me kolateral në formë të hipotekave të banimit të prioritetit të parë, ku shuma e papaguar nuk i kalon 30 ditë vonesë (kur një kredi është në vonesë mbi 30 ditë, atëherë i gjithë ekspozimi i atij krediti-marrësi duhet të peshohet sikurse kredia, me përjashtim të kredive të mbuluara me para të gatshme dhe nëse burimi i pagesës për ekspozimin tjetër janë të ndryshme me atë të kredisë), e cila është subjekt i kushteve të mëposhtme:
 - 4.1 Pronësia e pronës së banimit duhet të verifikohet dhe dokumentohet;

- 4.2 Maksimumi i raportit të kredisë me vlerën e patundshmërisë (KNV) nuk mund të kaloj gjashtëdhjetë e pesë për qind (65%); dhe
- 4.3 Vlera e tregut e pronave të paluajtshme duhet të mbështetet nga një vlerësues i pavarur, i cili mund të jetë në formë të vlerësimit nga vlerësuesi i kualifikuar dhe licencuar për vlerësimin e pasurisë së patundshme sipas rregullores në fuqi të BQK-së për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme.
5. Ekspozimet e siguruara me pronë komerciale duhet të peshohen me rrezik 100%.

Neni 53

Ekspozimet joperformuese

1. Ekspozimet joperformuese janë ekspozimet të cilat janë të përcaktuara në Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor.
2. Pjesa e pasiguar (e pakolateralizuar) e çdo ekspozimi që është në vonesë më shumë se 90 ditë, pas zbritjes së rezervave specifike duhet të peshohet me rrezik prej 100%.
3. Për qëllim të përcaktimit të pjesës së siguar të ekspozimit joperformues, do të merren parasysh vetëm garancitë dhe kolaterali i pranueshëm për qëllim të zbutjes së rrezikut kreditor.

Neni 54

Ekspozimet ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë

1. Bankat duhet të peshojnë me rrezik prej 150% ekspozimet që janë të klasifikuara me rrezik të lartë, siç përcaktohet me këtë rregullore.
2. Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë konsiderohen ekspozimet si në vijim:
 - 2.1 investimet në bizneset me kapital të përbashkët në rrezik;
 - 2.2 financimet spekulative në patundshmëri;
 - 2.3 të tjera ekspozime, të cilat BQK i konsideron me rrezik të lartë.
3. Gjatë vlerësimit nëse ekspozimet tjera përveç ekspozimeve të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni janë klasifikuar me rrezik të lartë, bankat duhet të marrin parasysh karakteristikat e mëposhtme të rrezikut:
 - 3.1 nëse ekziston rrezik i lartë i humbjes si rezultat i falimentimit (dështimit në pagesa) të huamarrësit;
 - 3.2 është e pamundur të vlerësohet në mënyrë adekuate nëse ekspozimi bie nën nënparagrafin 3.1 të këtij paragrafi.

Neni 55

Ekspozimet ndaj institucioneve dhe korporatave me vlerësim kreditor afatshkurtër

Ekspozimet ndaj institucioneve dhe ekspozimet ndaj korporatave për të cilat ekziston vlerësim kreditor afatshkurtër nga një IVJK e emëruar duhet të peshohen me rrezik sipas Tabelës 8 e cila korrespondon me vlerësimin kreditor të IVJK-së.

Tabela 8.

Shkalla e cilësisë kreditore	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	20%	50%	100%	150%	150%	150%

Neni 56

Ekspozimet ndaj фондеве investive

1. Për ekspozimet ndaj фондеве investive për të cilat ekziston vlerësim kreditor afatgjatë nga një IVJK e emëruar peshat e rrezikut duhet të caktohen sipas Tabelës 9 në kuadër të këtij paragrafi.

Tabela 9.

Shkalla e cilësisë kreditore	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	20%	50%	100%	100%	150%	150%

2. Ekspozimet ndaj фондеве investive për të cilat nuk ekziston vlerësim kreditor afatgjatë nga një IVJK e emëruar duhet të peshohen me rrezik prej 100%.

Neni 57

Ekspozimet ndaj ekuitetit të entiteteve

1. Ekspozime në instrumente të ekuitetit konsiderohen ekspozimet në vijim:
 - 1.1 ekspozimet të cilat nuk janë borxhe dhe të cilat bartin kërkesa të ndërvarura, reziduale në mjetet apo në të ardhurat e emetuesit;
 - 1.2 ekspozimet e borxhit dhe letrat tjera me vlerë, ortakëritë, instrumentet derivative apo instrumentet tjera, substanca ekonomike e të cilave është e ngjashme me ekspozimet e specifikuar në nënparagrafin 1.1 të këtij paragrafi.
2. Ekspozimet në ekuitet duhet të peshohen me rrezik prej 100%, përveç rasteve kur zbriten nga kapitali rregullator.

- Investimet në instrumente të ekuitetit apo në instrumentet e kapitalit rregullator të emetuara nga institucionet duhet të klasifikohen si ekspozime të ekuitetit, përveç nëse zbriten nga kapitali rregullator apo nëse trajtohen si ekspozime me rrezik të lartë në pajtueshmëri me nenin 54 të kësaj rregulloreje.

Neni 58

Ekspozime të tjera

- Mjetet fikse, të tilla si pronat/zyrat komerciale, fabrikat, pajisjet, mjetet tjera fikse dhe kërkesat tjera në patundshmëri si rezultat i tjetërsimit të pronësisë apo përvetësimeve tjera të tokës apo ndërtesave si rezultat i dështimeve në pagesat e kreditore, duhet të peshohen me rrezik prej 100%.
- Parapagimet dhe të hyrat e përfituara por që nuk janë arkëtuar në para të gatshme për të cilat banka nuk ka mundësi të përcaktoj palën e kundërt duhet të peshohen me rrezik 100%.
- Paraja e gatshme në proces të mbledhjes duhet të peshohet me rrezik 20%.
- Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj duhet të peshohen me rrezik 0%.
- Shufrat e arit të mbajtura në kasafortë për pjesën e mbuluar me shufra të arit në detyrime duhet të peshohen me rrezik 0%.
- Ekspozimet për të cilat nuk është e përcaktuar mënyra e peshimit të rrezikut kreditor në kuadër të kësaj rregullore, duhet të raportohen si pozicione të tjera dhe të peshohen me rrezik prej 100%.
- Kërkesat ndaj fondeve të cilat janë të themeluara nga një apo më shumë qeveri qendrore, bankave qendrore, bankave zhvillimore multilaterale, apo entitete të vlerësuara të sektorit publik të peshuara me rrezik sipas juridiksionit ku janë themeluar, duhet të aplikohet peshimi me rrezik prej 0%, sipas kërkesave të kësaj rregullore. I vetmi burim i këtyre fondeve duhet të jenë fondet e paguara nga institucionet e lartpërmendura në formë të pjesëmarrjes, duke përjashtuar ndonjë fond tjetër të financuar nëpërmjet borxheve.
- Kërkesat ndaj Fondit Kosovar për Garanci Kreditore duhet të peshohen me rrezik prej 0% për pjesën e garantuar të ekspozimit.

KAPITULLI IV

TEKNIKAT E ZBUTJES SË RREZIKUT KREDITOR

Neni 59

Kërkesat e përgjithshme

Principet për njohjen e efektit të teknikave të zbutjes së rrezikut kreditor

1. Për të përcaktuar peshimet me rrezik, bankat mund të përdorin një numër të teknikave për të zbutur rreziqet kreditore ndaj të cilave janë të ekspozuara. Ekspozimi mund të jetë plotësisht i mbuluar me kolateral, ose pjesërisht me para të gatshme apo letra me vlerë, ose me ndonjë ekspozim të garantuar nga një palë e tretë.
2. Në rastet kur këto teknika të ndryshme arrijnë t'i përmbushin kërkesat operationale të përcaktuara më poshtë në këtë nen, BQK mund të njohë zbutjen e rrezikut kreditor (ZRRK).
3. Korniza e përcaktuar në këtë kapitull aplikohet për ekspozimet në librin e bankës sipas qasjes së standardizuar.
4. Asnjë ekspozim prej të cilit banka realizon zbutje të rrezikut kreditor nuk duhet të prodhojë shumë të ekspozimit me peshim kreditor apo shumë të humbjes së pritur më të lartë sesa ekspozimi i njëjtë kur banka nuk aplikon ndonjë zbutje të rrezikut kreditor.
5. Efektet e ZRRK nuk do të llogariten dy herë. Gjithashtu, asnjë njohje mbikëqyrëse shtesë e ZRRK për qëllim të kapitalit rregullator nuk do të lejohet në ekspozimet për të cilat një vlerësim për emetimet specifike është përdorur që tani më reflekton atë ZRRK. Vlerësimet vetëm të principalit gjithashtu nuk do të lejohen në kuadër të kornizës së ZRRK.
6. Megjithëse bankat përdorin teknikat e ZRRK për të zvogëluar rrezikun kreditor, këto teknika ndikojnë në rritjen e rreziqeve (rreziqet reziduale) të cilat mund të ndikojnë që zvogëlimi i përgjithshëm i rrezikut të jetë më pak efektiv. Në rastet kur këto rreziqe nuk janë të kontrolluara në mënyrë adekuate, BQK mund të kërkojë kërkesa shtesë për kapital apo të ndërmarrë masa tjera mbikëqyrëse në pajtueshmëri me kornizën rregullative dhe ligjore.
7. Përderisa përdorimi i teknikave të ZRRK zvogëlon apo transferon rrezikun kreditor, gjithashtu njëkohësisht mund të rrisë rreziqet tjera të bankës, të tilla si rrezikun ligjor, operacional, të likuiditetit dhe rrezikun e tregut. Prandaj, bankat duhet të kenë procedura adekuate dhe procese për të kontrolluar këto rreziqe duke përfshirë strategjinë, shqyrtimin kreditor, vlerësimin, politikat dhe procedurat, sistemet dhe menaxhimin e rrezikut të koncentrimin që rrjedh nga përdorimi i teknikave të ZRRK dhe ndërlidhja e saj me profilin e përgjithshëm të rrezikut kreditor të bankës.
8. Kur bankat gjatë llogaritjes së shumave të ekspozimeve të peshuara me rrezik sipas Qasjes së Standardizuar përdorin më shumë se një formë të zbutjes së rrezikut kreditor që mbulon një ekspozim të vetëm duhet të veprojnë njëkohësisht si në vijim:

- 8.1 nën kategorizojnë ekspozimin në pjesë të mbuluara nga secili lloj i instrumentit të zbutjes së rrezikut kreditor;
- 8.2 llogarisin shumën e ekspozimit të peshuar me rrezik për secilën pjesë të marrë në nënparagrafin 8.1 të paragrafit 8 të këtij neni ndaras në pajtueshmëri me peshat e rrezikut të përcaktuara në kapitullin III të kësaj rregullore.
9. Kur shuma e mbuluar me kolateral apo e garantuar (apo ndaj të cilës mbahet mbrojtja kreditore) është më e vogël sesa shuma e ekspozimit, dhe pjesët e siguruara dhe të pasiguruara janë të prioritetit të barabartë, d.m.th., banka dhe garantuesi ndajnë humbjet në bazë të barabarta, lehtësirat në kapital do të lejohen në baza proporcionale, d.m.th., pjesa e mbuluar e ekspozimit do të marrë trajtimin e aplikueshëm për kolateralin apo kundërpalën, ndërsa pjesa tjetër do të trajtohet si e pasiguar.
10. Një transaksion i kolateralizuar është ai në të cilin:
- 10.1 Bankat kanë ekspozim kreditor apo ekspozim të mundshëm kreditor; dhe
- 10.2 ekspozimi kreditor apo ekspozimi i mundshëm kreditor është i mbrojtur plotësisht apo pjesërisht nga kolaterali i ofruar nga kundërpala apo nga pala e tretë në emër të kundërpalës.
11. Sipas qasjes së standardizuar për rrezikun kreditor, do të aplikohet vetëm ZRRK sipas qasjes së thjeshtë në kuadër të qasjes së standardizuar, e cila zëvendëson peshimin me rrezik të kolateralit për peshimin me rrezik të kundërpalës për pjesën e mbuluar me kolateral të ekspozimit (kryesisht subjekt i një minimumi prej 20%). Minimumi prej 20% i peshimit me rrezik në transaksionet e mbuluara me kolateral nuk aplikohet dhe peshimi me rrezik prej 0% mund të aplikohet kur ekspozimi dhe kolaterali janë të denominuara në valutë të njëjtë, si dhe:
- 11.1 kolaterali është në formë të parasë së gatshme, ose
- 11.2 kolaterali është në formë të letrave me vlerë shtetërore të pranueshme për peshim me rrezik prej 0% si dhe vlera e tregut të tyre është skontuar/zbritur për 20%.
12. Kolateralizimi i pjesërishtëm është i njohur nga BQK. Mospërputhjet në maturitet apo mospërputhjet në valutën e ekspozimit dhe të kolateralit nuk do të lejohen.

Neni 60

Parimet të cilat rregullojnë pranueshmërinë e teknikave për zbutjen e rrezikut kreditor

1. Teknika e cila përdoret për të siguruar mbrojtjen kreditore së bashku me veprimet dhe hapat e ndërmarrë, si dhe procedurat dhe politikat e implementuara nga banka duhet të jenë të tilla sa të rezultojnë në marrëveshje të mbrojtjes kreditore të cilat janë ligjërisht efektive dhe të detyrueshme në të gjitha juridiksionet relevante.

2. Në mënyrë që bankat të përfitojnë lehtësira në kapital, i gjithë dokumentacioni i përdorur në transaksionet e mbuluara me kolateral dhe për garancitë e dokumentuara duhet të jetë i detyrueshëm për të gjitha palët dhe ligjërish i zbatueshëm në të gjitha jurisdiksonet. Bankat duhet të kenë kryer mjaftueshëm rishikimet ligjore për të verifikuar këtë dhe duhet të kenë bazë ligjore të mirë themeluar për të arritur këtë përfundim dhe të kryejnë rishikime tjera të nevojshme për të siguruar zbatimin e vazhdueshëm.
3. Bankat duhet të ndërmarrin të gjithë hapat për të siguruar efektivitetin e marrëveshjeve të mbrojtjes kreditore dhe për të adresuar rreziqet që lidhen me të.
4. Për të ndryshuar shumat e ekspozimeve të peshuara me rrezik për rrezikun kreditor nga efektet e teknikave të zbutjes së rrezikut kreditor, bankat mund të përdorin instrumentet e mbrojtjes kreditore si në vijim:
 - 4.1 Instrumentet e mbrojtjes kreditore të financuara, të cilat përfshijnë kolateralin financiar;
 - 4.2 Instrumentet e mbrojtjes kreditore të pafinancuara, të cilat përfshijnë garancitë dhe kundërgarancitë.
5. Bankat mund të njohin mbrojtjen kreditore të financuar për llogaritjen e efektit të zbutjes së rrezikut kreditor vetëm atëherë kur mjetet që janë të përcaktuara për mbrojtje plotësojnë kushtet në vijim:
 - 5.1 ato janë të përfshira në listën e mjeteve të pranueshme të përcaktuara në nenin 61 të kësaj rregulloreje, siç aplikohet;
 - 5.2 ato janë mjaftueshëm likuide dhe vlera e tyre gjatë kohës është mjaftë stabile për të dhënë sigurinë e duhur sa i përket mbrojtjes kreditore të arritur duke konsideruar qasjen e përdorur për të kalkuluar shumat e ekspozimeve të peshuara me rrezik dhe shkallën e lejuar të njohjes.
6. Bankat mund të njohin mbrojtjen kreditore të financuar për llogaritjen e efektit të zbutjes së rrezikut kreditor vetëm atëherë kur kanë të drejtë për të likuiduar apo të mbajnë, me kohë mjetet nga të cilat rrjedh mbrojtja në rast të dështimit, insolvencës apo bankrotimit apo ndonjë ngjarje tjetër kreditore e përcaktuar në dokumentacionin e transaksionit të huamarrësit dhe ku është e aplikueshme të kujdestarit i cili e mban kolateralin. Shkalla e korrelacionit ndërmjet vlerës së mjeteve në të cilat bazohet mbrojtja dhe kualitetit kreditor të huamarrësit nuk duhet të jetë tepër e lartë.
7. Në rastet e mbrojtjes kreditore të pafinancuar, ofruesi i mbrojtjes duhet të kualifikohet si ofrues i mbrojtjes i pranueshëm vetëm atëherë kur është i përfshirë në listën e ofruesve të pranueshëm të mbrojtjes të përcaktuar në nenin 62 të kësaj rregulloreje.

8. Në rastet e mbrojtjes kreditore të pafinancuar, marrëveshja për mbrojtje duhet të kualifikohet si marrëveshje mbrojtëse e pranuar vetëm atëherë kur i plotëson kushtet në vijim:
 - 8.1 është e përfshirë në listën e marrëveshjeve të pranueshme për mbrojtje e përcaktuar në nenin 62 të kësaj rregulloreje.
 - 8.2 është ligjërisht efektive dhe e zbatueshme në jurisdiksonet relevante për të dhënë sigurinë e duhur sa i përket mbrojtjes kreditore të arritur duke pasur parasysh qasjen e përdorur për të llogaritur shumat e ekspozimeve të peshuara me rrezik dhe shkallën e lejuar të njohjes.
 - 8.3 ofruesi i mbrojtjes plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 64 të kësaj rregulloreje.
9. Mbrojtja kreditore duhet të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në nenin 63 dhe nenin 64 të kësaj rregulloreje, siç aplikohet.
10. Bankat duhet të jenë në gjendje për të demonstruar tek BQK se ato kanë procese adekuate të menaxhimit të rrezikut për të kontrolluar ato rreziqe ndaj të cilave mund të ekspozohen si rezultat i implementimit të zbutjes së rrezikut kreditor.
11. Pa marrë parasysh faktin se zbutja e rrezikut kreditor është marrë parasysh për qëllim të llogaritjes së shumave të ekspozimeve të peshuara me rrezik dhe ku është e aplikueshme, shumat e humbjeve të pritura, bankat duhet të vazhdojnë të kryejnë plotësisht vlerësimet kreditore të ekspozimeve dhe të jenë në pozitë për të demonstruar përmbushjen e kësaj kërkesë ndaj BQK-së.

Neni 61

Mbrojtja kreditore e financuar Kolaterali financiar

1. Kolaterali financiar i pranueshëm që mund të përdoret nga bankat është:
 - 1.1 Paraja e gatshme (duke përfshirë certifikatat e depozitit apo instrumentet e ngjashme të lëshuara nga banka kredituese) në formë të depozitave me bankën;
 - 1.2 Letrat me vlerë të borxhit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës;
 - 1.3 Letrat me vlerë të borxhit të emetuara nga qeveritë qendrore apo bankat qendrore, të cilat kanë vlerësim kreditor nga një IVJK e pranuar apo një AKE e njohur për qëllimet e përcaktimit të peshimit me rrezik në pajtim me kapitullin III të kësaj rregullore e cila është përcaktuar nga BQK me shkallë të cilësisë kreditore 2 apo më mirë sipas rregullave për peshim me rrezik të ekspozimeve ndaj qeverive qendrore apo bankave qendrore sipas nenit 44 të kësaj rregulloreje.

Neni 62
Mbrojtja kreditore e pafinancuar
Garancitë dhe kundërgarancitë

1. Bankat mund të përdorin palët në vijim si ofrues të pranuar të mbrojtjes kreditore të pafinancuar:
 - 1.1 Qeveritë Qendrore dhe Bankat Qendrore të cilat kanë vlerësim kreditor nga një IVJK e pranuar apo një AKE e njohur për qëllimet e përcaktimit të peshimit me rrezik në pajtueshmëri me kapitullin III të kësaj rregulloreje e cila është përcaktuar nga BQK me shkallë të cilësisë kreditore 2 apo më mirë sipas rregullave për peshim me rrezik të ekspozimeve ndaj qeverive qendrore apo bankave qendrore sipas nenit 44;
 - 1.2 Qeveria e Republikës së Kosovës;
 - 1.3 Bankat shumëpalëshe të zhvillimit të trajtuara me peshim me rrezik prej 0% ;
 - 1.4 Organizatat ndërkombëtare të trajtuara me peshim me rrezik prej 0% sipas nenit 48 të kapitullit III të kësaj rregulloreje.

Neni 63
Kërkesat për kolateralin financiar

1. Kolaterali financiar mund konsiderohet si kolateral i pranueshëm në rastet kur të gjitha kërkesat e përcaktuara në paragrafet 2 deri 4 të këtij neni, janë përmbushur.
2. Cilësia kreditore e huamarrësit dhe vlera e kolateralit nuk duhet të kenë korrelacion pozitiv material. Aty ku vlera e kolateralit është zvogëluar dukshëm, në veçanti nuk duhet të nënkuptohet si përkeqësim i dukshëm i kualitetit kreditor të huamarrësit. Ndërsa kur kualiteti kreditor i huamarrësit bëhet kritik, kjo nuk do të nënkuptojë në veçanti uljen e dukshme të vlerës së kolateralit. Letrat me vlerë të lëshuara nga huamarrësi, apo çdo grupi të ndërlidhur, nuk do të konsiderohen si kolateral i pranueshëm.
3. Bankat duhet të plotësojnë çdo kërkesë kontraktuale dhe të kërkuar me ligj dhe të marrin çdo hap të nevojshëm për të siguruar zbatueshmërinë e plotë të marrëveshjes së kolateralit sipas ligjit të zbatueshëm për interesin e tyre në këtë kolateral. Bankat duhet të kenë kryer vlerësim të mjaftueshëm ligjor që konfirmon zbatueshmërinë e marrëveshjes për kolateralin në të gjitha jurisdiksonet. Ato duhet të kryejnë përsëri vlerësimet e tilla sa herë që është e nevojshme të sigurohet vazhdimësia e zbatueshmërisë.
4. Bankat duhet të përmbushin të gjitha kërkesat operationale të listuara më poshtë:
 - 4.1 Bankat duhet të dokumentojnë mirë kolateralin si dhe të kenë procedura të qarta të likuidimit me kohë të kolateralit;

- 4.2 Bankat duhet të posedojnë procedura dhe procese adekuate për të kontrolluar rreziqet që rrjedhin nga përdorimi i kolateralit, përfshirë edhe rreziqet nga dështimi apo zvogëlimi i mbrojtjes kreditore, rreziku nga vlerësimi, rreziku që rrjedh nga ndërprerja e mbrojtjes kreditore, rreziku i koncentrimit që rrjedh nga përdorimi i kolateralit dhe ndërlidhja me profilin e përgjithshëm të rrezikut të bankës;
- 4.3 Bankat duhet të kenë të dokumentuara dhe të aprovuara politikat dhe procedurat rreth llojit dhe shumës së kolateralit të pranueshëm;
- 4.4 Bankat duhet të kalkulojnë vlerën e kolateralit sipas çmimit të tregut, dhe të ri-vlerësojnë atë në përputhje me rrethanat, së paku një herë në gjashtë muaj apo në çdo kohë kur ato kanë arsye të besojnë që vlera e tregut e kolateralit është zvogëluar dukshëm.
- 4.5 Në rastet kur kolaterali mbahet nga pala e tretë, bankat duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të siguruar që pala e tretë e ndanë këtë kolateral nga pasuritë e saj;
- 4.6 Bankat duhet të kenë të aprovuara politikat për menaxhimin e kolateralit përmes të cilave kontrollojnë, monitorojnë dhe raportojnë:
 - 4.6.1 koncentrimin e rrezikut për llojet e veçanta të kolateralit;
 - 4.6.2 ripërdorimin e kolateralit duke përfshirë këtu edhe mungesën e mundshme të likuiditetit që rezulton nga ripërdorimi i kolateralit të pranuar nga kundërpalët;
 - 4.6.3 dhënien e të drejtës për kolateralin e lënë tek kundërpalët.
5. Përveç përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në paragrafet 2 deri 4 të këtij neni, kolaterali financiar për t'u kualifikuar si kolateral i pranueshëm sipas metodës së thjeshtë të kolateralit financiar, maturiteti rezidual i mbrojtjes nuk duhet të jetë më i shkurtë se maturiteti rezidual i ekspozimit.

Neni 64

Kërkesat e zakonshme për garancitë

1. Mbrojtja kreditore e cila rrjedh nga një garanci duhet të kualifikohet si mbrojtje kreditore e pafinancuar nëse përmbushen kushtet e cekura më poshtë :
 - 1.1 mbrojtja kreditore është direkte;
 - 1.2 masa e mbrojtjes kreditore është e definuar qartë dhe e pakontestueshme;
 - 1.3 marrëveshja e mbrojtjes kreditore nuk përmban ndonjë klauzolë ku përmbushja e së cilës është jashtë kontrollit nga kreditori, që:
 - 1.3.1 do të lejojë që ofruesi i mbrojtjes kreditore të anulojë mbrojtjen në mënyrë të njëanshme;

- 1.3.2 do të rrisë koston efektive të mbrojtjes kreditore si rezultat i përkeqësimit të kualitetit kreditor të ekspozimit të mbrojtur;
 - 1.3.3 mund të ndalojë ofruesin e mbrojtjes kreditore të paguaj me kohë në rastet kur huamarrësi kryesor dështon të kryejë pagesat;
 - 1.3.4 mund të lejojë maturitetin e mbrojtjes kreditore të zvogëlohet nga ofruesi i mbrojtjes;
- 1.4 Marrëveshja e mbrojtjes kreditore është ligjërisht efektive dhe e zbatueshme në të gjitha juridiksionet relevante në kohën e arritjes së marrëveshjes kreditore.
2. Banka duhet të sigurojë BQK-në se posedon sisteme adekuate për të menaxhuar koncentrimin e mundshëm të rrezikut që rrjedh nga përdorimi i garancive. Banka duhet të demonstroj, deri në masën që BQK të jetë e kënaqur, se si strategjia e saj për përdorimin e garancive ndërlihet me menaxhimin e profilit të përgjithshëm të rrezikut të saj.
 3. Banka duhet të përmbushë çdo kërkesë kontraktuale dhe statutore në lidhje me, dhe të marrë hapat e nevojshëm për të siguruar, zbatueshmërinë e saj të mbrojtjes kreditore të pafinancuar.
 4. Banka duhet të kryej vlerësimin ligjor që konfirmon zbatueshmërinë e mbrojtjes kreditore të pafinancuar në të gjitha juridiksionet relevante. Banka duhet të përsëritë vlerësimin e tillë për të siguruar vazhdimësinë e zbatueshmërisë.

Neni 65

Kundërgarancitë shtetërore

1. Bankat mund të trajtojnë ekspozimet e referuara në paragrafin 2, të këtij neni, si të mbrojtura nga garancia e dhënë nga entitetet e listuara në këtë paragraf nëse përmbushen kriteret në vijim:
 - 1.1 kundërgarancia i mbulon të gjitha elementet e rrezikut kreditor të ekspozimit;
 - 1.2 kur garancia kryesore së bashku me kundërgarancinë përmbushin kërkesat për garancitë të përcaktuara në nenin 64 dhe nenin 66 paragrafi 1 të kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur kundërgarancia nuk duhet të jetë direkte;
 - 1.3 mbrojtja është e qëndrueshme dhe në evidencat historike nuk sugjerohet asgjë që mbulueshmëria e kundërgarancisë është më pak efektive dhe barabartë me atë të garancisë direkte nga entiteti në fjalë.
2. Trajtimi i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni duhet të aplikohet për ekspozimet e mbrojtura nga një garanci e cila gjithashtu është e mbrojtur me një kundërgaranci nga entitetet në vijim:

- 2.1 qeveria qendrore apo banka qendrore të cilat kanë vlerësim kreditor nga një IVJK e pranuar apo një AKE e njohur për qëllimet e përcaktimit të peshimit me rrezik në pajtueshmëri me kapitullin III të kësaj rregulloreje e cila është përcaktuar nga BQK me shkallë të cilësisë kreditore 2 apo më mirë sipas rregullave për peshim me rrezik të ekspozimeve ndaj qeverive qendrore apo bankave qendrore sipas nenit 44;
 - 2.2 Qeveria e Republikës së Kosovës;
 - 2.3 Bankat shumëpalëshe të zhvillimit të trajtuara me peshim me rrezik prej 0% ;
 - 2.4 Organizatat ndërkombëtare të trajtuara me peshim me rrezik prej 0% sipas nenit 48 të kapitullit III të kësaj rregulloreje.
3. Bankat duhet të aplikojnë trajtimin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni për ekspozimin i cili nuk është kundërgarantuar nga asnjë entitet i listuar në paragrafin 2 të këtij neni, ku kundërgarancia e atij ekspozimi në anën tjetër është direkt e garantuar nga njëra nga ato entitete si dhe kushtet e listuara në paragrafin 1 të këtij neni janë përmbushur.

Neni 66

Kërkesat shtesë për garancitë

- 1. Garancitë duhet të kualifikohen si mbrojtje kreditore e pafinancuar të pranueshme nëse të gjitha kushtet në nenin 64 të kësaj rregulloreje dhe të gjitha kushtet në vijim përmbushen:
 - 1.1 në rast të dështimit të kualifikuar apo mos kryerjes së pagesës nga kundërpala, banka ka të drejtë të ndjekë, me kohë, garantuesin për të gjitha mjetet e papaguara sipas kërkesës në kuadër të së cilës mbrojtja është ofruar dhe pagesa nga garantuesi nuk duhet të jetë subjekt i bankës që së pari duhet të ndjekë borxhliun;
 - 1.2 garancia është obligim i dokumentuar në mënyrë eksplicite i marrë nga garantuesi;
 - 1.3 njëri nga kushtet në vijim është përmbushur:
 - 1.3.1 garancia mbulon të gjitha llojet e pagesave që borxhliu pritët t'i bëjë sa i përket kërkesës;
 - 1.3.2 aty ku disa lloje të pagesës janë të përjashtuara nga garancia, banka ka korrigjuar vlerën e garancisë për të pasqyruar mbulueshmërinë e kufizuar.
- 2. Në rastet e garancive të ofruara në kontekst të skemave të përbashkëta të garancive apo të ofruara ose të kundër-garantuara nga entitetet e listuara në nenin 65 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje, kërkesat në nenparagrafin 1.3.1 të paragrafit 1 të këtij neni duhet të konsiderohen të jenë të përmbushura kur njëri nga kushtet në vijim është përmbushur:
 - 2.1 Banka ka të drejtë të marrë me kohë një pagesë afatshkurtër nga garantuesi që përmbushë dy kushtet në vijim:

2.1.1 ajo përfaqëson një përllogaritje adekuatë të shumës së humbjes, duke përfshirë humbjet që rrjedhin nga mospagesa e interesit dhe lloje tjera të pagesës që huamarrësi duhet të paguajë, që bankës është e mundshme t'i ndodhë;

2.1.2 është proporcionale me mbulesën e garancisë;

2.2 Banka mund t'i dëshmojë BQK-së se efektet e garancisë të cilat gjithashtu duhet të mbulojnë humbjet që rrjedhin nga mospagesa e interesit dhe llojeve tjera të pagesës që huamarrësi obligohet t'i paguajë, arsyetojnë trajtimin e tillë.

KAPITULLI V

MBI LLOGARITJEN E KËRKESAVE PËR KAPITAL PËR RREZIKUN E TREGUT

Neni 67

Libri tregtar²

1. Për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital për rreziqet, bankat duhet të ndajnë pozicionet e tyre në “librin e bankës” dhe në “librin tregtar”.
2. Për t'u përfshirë në librin tregtar, pozicionet në instrumentet financiare dhe mallra (ang. *Commodities*) duhet të lirohen nga çdo dispozitë kufizuese që kufizon disponueshmërinë e tyre për tregtim ose për të mbrojtur vlerën e tyre (ang. *Hedging*).

Neni 68

Pozicionet e mbajtura me qëllim tregtimi

1. Pozicionet e mbajtura me qëllim tregtimi janë ato pozicione në instrumente financiare dhe mallra (*commodities*) që mbahen qëllimisht për tregtimin/rishitjen e tyre brenda një kohe të shkurtë dhe me qëllim të përfitimit nga diferenca e çmimit të blerjes dhe shitjes (prej çmimit aktual apo çmimit të pritshëm) ose me qëllim të përfitimit nga luhatshmëritë tjera në çmim ose në norma të interesit. Termi “pozicionet” duhet të përfshijë ato pozicione që tregtohen për qëllime të vetë bankës (ang. *proprietary positions*), pozicionet në emër të klientëve të bankës ose duke vepruar si bërës tregu (ang. *Market maker*). Pozicionet/portofoliot e mbajtura me qëllim tregtimi duhet të jenë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

² Mbajtja e instrumenteve financiare në librin e bankës me qëllim të investimit në kapitalin e bankës nuk merret parasysh.

- 1.1 Menaxhmenti i lartë i bankave duhet të hartojë, miratojë dhe dokumentojë politika dhe procedura të brendshme për strategjinë tregtuese të pozicioneve dhe portfoliove, e cila duhet të përfshijë edhe periudhën e pritshme të mbajtjes së tyre;
- 1.2 Banka duhet të ketë procedura të qarta rreth adimstrimit aktiv të pozicioneve që tregtohen, të cilat operacionalizohen përmes një njësie të veçantë të tregtimit (ang. *trading desk*), të cilat përfshijnë:
 - 1.2.1 pozicionet që menaxhohen nga njësia e tregtimit (ang. *trading desk*);
 - 1.2.2 përcaktimin e kufijve dhe monitorimin e përshtatshmërisë së tyre;
 - 1.2.3 autonominë/pavarësinë e punonjësve (ang. *dealers*) në krijimin dhe administrimin e pozicioneve brenda kufijve të miratuara të tyre dhe në përputhje me strategjinë e miratuar;
 - 1.2.4 raportimin e pozicioneve tek drejtuesit e lartë të bankës, si pjesë integrale e procesit të administrimit të rrezikut të bankës;
 - 1.2.5 monitorimin aktiv të pozicioneve në bazë të informacioneve të siguruara nga tregu dhe vlerësimin mbi tregtueshmërinë ose aftësinë mbrojtëse të pozicionit dhe të komponentëve të rrezikut, si dhe vlerësimin mbi cilësinë dhe disponueshmërinë e të dhënave të tregut, në procesin e përcaktimit të vlerës së instrumentit, nivelin e qarkullimit në treg, madhësinë e pozicionit të tregtuar në treg; dhe
 - 1.2.6 banka duhet të ketë politika dhe procedura të definuara qartë për monitorimin e pozicioneve kundrejt strategjisë tregtuese, përfshirë këtu edhe monitorimin e pozicioneve qarkulluese dhe pozicioneve statike që nuk reflektojnë të dhëna të përditësuara nga tregu (ang. *Stale positions*) në librin e tregtar.
2. BQK mund të kërkojë përjashtimin nga libri i tregtar të atyre zërave, të cilët aktualisht ose prej kohësh, nuk kanë tregtueshmëri të dukshme (p.sh. mungesa e likuiditetit dhe e tregtueshmërisë), veçanërisht nëse periudha e mbajtjes së këtyre instrumenteve është më e gjatë se ajo që i korrespondon qëllimit afatshkurtë për tregtim.
3. BQK mund të ndalojë përfshirjen në librin e tregtar të atyre zërave, për të cilat bankat nuk kanë burimet, përvojën e nevojshme apo sistemet e duhura të teknologjisë informative për t'i administruar në mënyrë aktive.

Neni 69

Sistemi i kontrollit për menaxhimin dhe vlerësimin e librit tregtar

1. Bankat duhet të themelojnë dhe mirëmbajnë sisteme dhe kontrollera të mjaftueshme për të siguruar vlerësime prudenciale dhe të besueshme përmes procedurave të tyre të brendshme të shkruara.

2. Sistemet e kontrollit duhet të përfshijnë të paktën këto elemente:

- 2.1 politika dhe procedura të dokumentuara për procesin e vlerësimit, përfshirë edhe definimin e qartë të përgjegjësiave për përcaktimin e vlerësimit, burimi i informacionit të tregut dhe rishikimi përshtatshmërisë së këtij informacioni, udhëzues për supozime rreth përdorimit të indikatorëve të paobzervueshëm për vendosjen e çmimit ndaj pozicionit të caktuar, frekuencën e vlerësimit të pavarur, procedura për përshtatjen/rregullimin e vlerësimit (ang. *Valuation adjustment*) në fund të muajit dhe apo gjatë verifikimit ad-hoc.
- 2.2 linjat e raportimit për njësinë që është përgjegjëse në këtë proces, të cilat duhet të jenë të qarta dhe të pavarura nga njësia operuese (*front-office*).
- 2.3 linjat e raportimit duhet të shtrihen deri te Bordi Ekzekutiv.
- 2.4 banka duhet të caktojë një organ ose një person, varësisht nga madhësia dhe kompleksiteti i veprimtarisë së bankës, si përgjegjës direkt për menaxhimin e rreziqeve të tregut.

Neni 70

Përshtatjet e vlerësimit (angl. *Valuation Adjustment*) në librin tregtar

1. Bankat sigurohen që vlera e aplikuar mbi secilin nga pozicionet që përfshihet në librin tregtar pasqyron vlerën e saktë të tregut, sa herë që është e mundur. Bankat duhet të bëjnë në baza ditore vlerësimin *marking-to-market* të pozicioneve në bazë të çmimit të mbylljes (ang. *Close out prices*), të publikuara nga një burim i pavarur informacioni. Si shembuj të çmimeve të mbylljes mund të përdoren çmimet e listuara (shkruara) në tregjet e këmbimit valuator, çmimet e listuara në ekrane apo kuotat e listuara nga disa brokerë/ndërmjetës të pavarur.
2. Gjatë përdorimit të metodës së vlerësimit *marking-to-market*, banka duhet të përdorë kuotimin më prudent apo konzervativ mes çmimit të kërkesës/çmimit të ofertës (bid/ask), me përjashtim të rasteve kur banka është bërës tregu (angl. *Market maker*) në një lloj të caktuar të instrumentit financiar apo malli (*commodities*) kur banka mund të përdorë mesataren e çmimit të ofruar dhe atij të kërkuar (angl. *Close out at mid market*).
3. Në rastet kur nuk është i mundur vlerësimi me çmim tregu, bankat vlerësojnë pozicionet/portofoliot e tyre bazuar në modele (*mark-to-model*), para aplikimit të kërkesave për llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e tregut. “Vlerësim i bazuar në model” nënkupton çdo lloj vlerësimi, që ka për referencë (ang. *benchmark*) tregun, ekstrapolohet apo llogaritet nga të dhënat e tregut.

4. Në rastet kur përdoret vlerësimi i bazuar në model (*mark-to-model*), bankat duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
 - 4.1 menaxhmenti i lartë i bankës duhet të jetë i informuar mbi instrumentet e librit tregtar që vlerësohen në bazë të një modeli si dhe mbi materialitetin e pasaktësive (aftësinë shpjeguese të modelit) që krijohen në raportimin e rrezikut/performancës së bankës;
 - 4.2 të dhënat e tregut (*market input*), kur është e mundur, të jenë në linjë me çmimet e tregut dhe përshtatshmëria e të dhënave të tregut për vlerësimin e një pozicioni të veçantë dhe parametrat e modelit, të vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme;
 - 4.3 në rastet kur është e mundur, për instrumente të caktuara financiare ose mallra (*commodities*), të përdoren metodologji vlerësimi, të cilat janë të pranuar gjerësisht nga tregu;
 - 4.4 në rastet kur modeli është ndërtuar nga vetë banka, modeli duhet të jetë i bazuar mbi supozime të përshtatshme, të vlerësuara dhe të verifikuara nga palë të kualifikuara që nuk kanë marrë pjesë në ndërtimin e tij;
 - 4.5 Bankat duhet ekzaminojnë në mënyrë periodike vlefshmërinë e modelit të brendshëm dhe nëse ka nevojë, edhe të përmirësojnë atë për vlerësimin e pozicioneve në librin tregtar;
 - 4.6 të ekzistojnë procedura formale kontrolli për ndryshimet që i bëhen modelit si dhe banka të ketë një kopje të ruajtur (të siguruar) të modelit dhe të përdoret periodikisht për kontrollin e vlerësimeve;
 - 4.7 strukturat e administrimit të rrezikut duhet të jenë të informuara mbi dobësitë e modelit, të cilat dobësi duhet t'i konsiderojnë në vlerësimin e rezultateve të tij;
 - 4.8 modeli duhet të rishikohet periodikisht për të vlerësuar saktësinë e rezultateve (p.sh. duke rivlerësuar përshtatshmërinë e supozimeve, analizat e humbjes dhe fitimit kundrejt faktorëve të rrezikut, krahasimin e çmimit efektiv të mbylljes me atë që prodhon modeli).
5. Përveç vlerësimit ditor me vlerë tregu (*mark-to-market*) ose vlerësimit të bazuar në modele (*mark-to-model*), bankat duhet të realizojnë edhe një verifikim të pavarur të çmimeve, proces ky me anë të të cilit verifikohen periodikisht për saktësi dhe pavarësi çmimet e tregut ose input-et e modelit. Bankat sigurojnë që verifikimi i çmimeve të tregut dhe i input-eve të modelit të kryhet nga një njësi e pavarur nga dealing room, të paktën me frekuencë mujore, ose më shpesh, varësisht nga natyra e aktivitetit tregtar. Bankat, në rastet kur nuk mund të sigurojnë verifikime të pavarura të çmimeve dhe burimeve të tregut, konsiderojnë mundësinë e përshtatjeve në vlerësim.
6. Bankat duhet të themelojnë dhe mirëmbajnë procedura për përshtatjet e vlerësimeve.

7. Bankat duhet që formalisht të kryejnë përshtatjen e vlerësimeve si rezultat i faktorëve të mëposhtëm:
 - 7.1 marzheve të porealizuara të kredive;
 - 7.2 kostove të mbylljes së pozicioneve;
 - 7.3 rreziqeve operacionale;
 - 7.4 mbylljes së pozicioneve para kohe;
 - 7.5 kostove të financimit dhe investimit;
 - 7.6 kostove të ardhshme administrative;
 - 7.7 rrezikut të modelit, nëse konsiderohet i rëndësishëm.

8. Bankat duhet të krijojnë përshtatje të vlerësimit për pozicionet më pak likuide, të cilat mund të vijnë si rezultat i ngjarjeve në treg dhe/ose i situatave të lidhura me vetë bankën (për shembull pozicionet e koncentruara dhe/ose pozicionet e pandryshuara/statike). Përshtatjet e tilla, përveç që duhet të bëhen për nevoja të raportimit financiar, ato gjithashtu duhet të kenë parasyshë dhe të reflektojnë mungesën e likuiditetit të pozicionit përkatës. Për të bërë përshtatjen e vlerësimit për pozicionet që kanë mungesë likuiditeti, bankat duhet të marrin parasyshë faktorët e mëposhtëm:
 - 8.1 kohën e nevojshme për të mbrojtur pozicionin ose rreziqet brenda pozicionit;
 - 8.2 luhatshmërinë dhe mesataren e marzheve të ofruara/të kërkuara;
 - 8.3 gatishmërinë e kuotimeve në treg (numrin dhe identitetin e *market maker*);
 - 8.4 luhatshmërinë dhe mesataren e vëllimeve të tregtuara edhe në periudha krize (stresuese);
 - 8.5 përqendrimet në treg;
 - 8.6 vjetërsinë e pozicionit;
 - 8.7 deri në cilin nivel vlerësimet mbështeten në vlerësimet sipas modelit (*marking to model*);
 - 8.8 efektin e rreziqeve të tjera të modelit.

9. Në rastet kur bankat përdorin vlerësimin e palëve të treta ose vlerësimin e bazuar në modele, marrin në konsideratë nëse duhet të kryejnë përshtatje të vlerësimit ose të krijojnë rezerva për pozicionet më pak likuide, si dhe duhet të rishikojnë përshtatshmërinë në baza të vazhdueshme.

Neni 71

Mbrojtja e brendshme (angl. Internal hedging)

1. Bankat përkufizojnë “mbrojtjen e brendshme” si pozicionin që, tërësisht ose në pjesën më të madhe, kompenson rrezikun e një pozicioni ose të një grupi pozicionesh në librat e bankës.

Bankat përfshijnë pozicionet e krijuara nga mbrojtjet e brendshme në librin tregtar, nëse këto pozicione mbahen për qëllime tregtimi dhe nëse plotësohen kriteret e përgjithshme sipas qëllimit të tregtimit dhe vlerësimit prudencial në nenet 68, 69 dhe 70 të kësaj rregulloreje. Bankat, në veçanti duhet të:

- 1.1 sigurojnë që mbrojtjet e brendshme të mos kenë qëllim kryesor zvogëlimin e kërkesës për kapital rregullator;
 - 1.2 sigurojnë se mbrojtjet e brendshme janë të dokumentuara në mënyrën e duhur dhe janë subjekt i miratimeve dhe procedurave të kontrollit të brendshëm;
 - 1.3 trajtojnë transaksionet e brendshme në përputhje me kushtet e tregut;
 - 1.4 administrojnë në mënyrë dinamike rrezikun e tregut që buron nga mbrojtja e brendshme në librin tregtar, brenda kufijve të lejuar për rrezikun e tregut;
 - 1.5 monitorojnë transaksionet e brendshme në mënyrë të kujdesshme, duke përdorur procedura të duhura dhe të përshtatshme.
2. Trajtimi sipas paragrafit 1 të këtij neni aplikohet pavarësisht kërkesave për kapital rregullator të aplikueshme ndaj kahut të mbrojtjes së brendshme (ang. *Non-trading book leg*), që kalon në librat e bankës (ang. *banking book leg of the internal hedge*).
 3. Bankat, në rastet kur përdorin një derivativ kredie që përfshihet në librin tregtar për mbulimin e rrezikut të një ekspozimi në librat e bankës dhe një mbulim i tillë sigurohet nëpërmjet mbrojtjes së brendshme, mund të konsiderojnë ekspozimin që përfshihet në librat e bankës si të mbrojtur për qëllime të përcaktimit të kërkesës për kapital të rrezikut të kredisë, me kushtin që banka të blejë nga një palë e tretë, një derivativ kredie që plotëson kriteret e vendosura.

Neni 72

Kërkesat e kapitalit për rrezikun e tregut

1. Kërkesat e kapitalit për rrezikun e tregut është shuma e kërkesave për kapital për:
 - 1.1 rrezikun e pozicionit në instrumentet e borxhit dhe të kapitalit;
 - 1.2 rrezikun e kursit të këmbimit;
 - 1.3 rrezikun e shlyerjes dhe dërgesave të lira;
 - 1.4 pozicionet e mbrojtura nga derivativët kreditor;
 - 1.5 pozicionet në mallra; dhe
 - 1.6 opsionet

NËNKAPITULLI I LLOGARITJA E KËRKESAVE TË KAPITALIT PËR RREZIKUN E POZICIONIT

Neni 73

Kërkesat e kapitalit për rrezikun e pozicionit

Kërkesa e kapitalit të bankës për rrezikun e pozicionit është shuma e kërkesave për kapital për rrezikun e përgjithshëm dhe rrezikun specifik të pozicioneve në instrumentet e borxhit dhe të kapitalit.

Neni 74

Netimi (kompensimi)

1. Vlera absolute e tepricës së pozicioneve të gjata (të shkurta) të bankës mbi pozicionet e shkurta (të gjata) në instrumentet e njëjta të kapitalit, të borxhit dhe të emetimeve të konvertueshme dhe kontratave financiare identike të së ardhmes “futures”, opsioneve “options”, garancive “warrants” dhe garancive të mbuluara “covered warrants” është pozicioni neto në secilin nga këto pozicione të ndryshme. Për llogaritjen e pozicionit neto, pozicionet në instrumentet derivative mund të trajtohen si pozicione në letrën apo letrat me vlerë bazë (apo në shumë nocionale), në pajtueshmëri me nenet 75 deri në 77 të kësajrregulloreje. Instrumentet e borxhit të cilat janë detyrime të bankës nuk duhet të merren parasysh gjatë llogaritjes së rrezikut specifik.
2. Netimi nuk lejohet ndërmjet një pozicioni të konvertueshëm dhe një pozicioni kompensues në instrumentin bazë.
3. Të gjitha pozicionet neto, pavarësisht shenjës së tyre, përpara agregimit të tyre, duhet të konvertohen në baza ditore në valutën e raportimit të bankës sipas kursit zyrtar aktual “spot” të këmbimit të periudhës raportuese.

Neni 75

Kontratat e së ardhmes “futures” të normës së interesit dhe kontratat me pajtim paraprak “forwards”

1. Kontratat e së ardhmes “futures” të normës së interesit, kontratat me pajtim paraprak “forward” të normës së interesit dhe zotimet me pajtim paraprak “forward” për të blerë apo për të shitur instrumente borxhi duhet të trajtohen si kombinime të pozicioneve të gjata dhe të shkurta.

2. Një pozicion i gjatë në normën e interesit të së ardhmes “futures” duhet të trajtohet si kombinim i një huazimi që matoron në datën e dorëzimit të kontratës të së ardhmes dhe mbajtjes së një asetit me datë maturimi të njëjtë me atë të instrumentit apo pozicionit nocional nga e cila derivon kontrata e së ardhmes “futures”.
3. Një kontratë me pajtim paraprak “forward” e shitur duhet të trajtohet si pozicion i gjatë që ka datë të njëjtë të maturimit me datën e shlyerjes plus periudhën e kontratës, dhe si pozicion i shkurtë me maturitet të njëjtë me datën e shlyerjes.
4. Huazimi dhe mbajtja e asetit duhet të përfshihen në kategorinë e parë të përcaktuar në Tabelën 1 në nenin 83 (shiko tabelën 1 – Instrumentet e tregtueshme të borxhit) në mënyrë që të llogaritet kërkesa për kapital për rrezikun specifik për kontratat e së ardhmes “futures” të normës së interesit dhe kontratat me pajtim paraprak “forward”.
5. Zotimi me pajtim paraprak “forward” për të blerë një instrument borxhi duhet të trajtohet si kombinim i huazimit që matoron në datën e dorëzimit dhe si pozicion i gjatë aktual “spot” në vetë instrumentin e borxhit. Huazimi duhet të përfshihet në kategorinë e parë të përcaktuar në Tabelën 1 në nenin 83 të kësaj rregulloreje për qëllim të rrezikut specifik, dhe instrumenti i borxhit në cilëndo kolonë e cila është e përshtatshme, në tabelën e njëjtë.
6. Për qëllim të këtij neni, “pozicion i gjatë” nënkupton një pozicion në të cilin banka e ka fiksuar normën e interesit që do të pranojë në një periudhë kohore në të ardhmen, dhe një “pozicion i shkurtë” nënkupton një pozicion në të cilin banka e ka fiksuar normën e interesit që do të paguajë në një periudhë kohore në të ardhmen.

Neni 76

Kontratat e opsioneve “options” dhe të garancive “warrants”

1. Kontratat e opsioneve dhe garancive në normat e interesit, në instrumentet e borxhit, në instrumentet e kapitalit, në indekset e kapitalit, në kontratat financiare të së ardhmes “futures”, kontratat “swap” dhe valutat e huaja duhet të trajtohen sikurse pozicione të njëjta në vlerë me shumën e instrumentit bazë të cilit i referohet kontrata opion të shumëzuar me koeficientin delta, për qëllim të këtij kapitulli. Pozicionet finale, mund të netohen kundrejt ndonjë pozicioni kompensues në instrumentet bazë identike apo derivativët. Koeficienti delta i përdorur duhet të jetë nga bursa e caktuar ku tregtohet instrumenti.
2. Për kontratat opion të tregtuara në tregjet jashtë bursave “Over the Counter”, apo në rastet kur koeficienti delta nuk është në dispozicion nga bursa e caktuar ku tregtohet instrumenti, koeficienti delta mund të llogaritet nga banka duke përdorur një model adekuat me aprovim të BQK-së.

3. BQK do të aprovojë llogaritjen e koeficientit delta nga banka nëse modeli i përdorur, në mënyrë adekuate përlllogaritë normën e ndryshimit të vlerës së kontratës option apo vlerës së garancisë sa i përket ndryshimeve të vogla në çmimin e tregut të instrumentit bazë.
4. Bankat duhet të pasqyrojnë rreziqet tjera në mënyrë adekuate, përveç rrezikut të koeficientit delta, që lidhet me kontratat option sa i përket kërkesave të kapitalit.

Neni 77

Kontratat e kundërkëmbimit “Swaps”

Kontratat e kundërkëmbimit “swaps” për qëllim të rrezikut të normës së interesit duhet të trajtohen sikurse instrumentet bilancore. Prandaj, një kontratë kundërkëmbimi “swap” e normës së interesit sipas së cilës banka pranon normë variabile të interesit dhe paguan normë fikse të interesit duhet të trajtohet si ekuivalent i një pozicioni të gjatë në instrumentin e normës variabile me maturitet të njëjtë me periudhën deri në fiksimin e ardhshëm të normës së interesit dhe një pozicion të shkurtë në një instrument me normë fikse të interesit me maturitet të njëjtë sikurse të kontratës së kundërkëmbimit “swap”.

Neni 78

Rreziku i normës së interesit në instrumentet derivative

1. Bankat trajtojnë çdo pozicion në instrumentet derivative të përfshira në nenet 75 deri 77 të kësaj rregulloreje si plotësisht të kompenzueshme të cilët plotësojnë së paku kriteret në vijim:
 - 1.1 pozicionet janë të vlerës së njëjtë dhe të shprehura në valutë të njëjtë;
 - 1.2 norma referencë (për pozicionet me normë variabile) apo kuponi (për pozicionet me normë fikse) përputhet përafërsisht;
 - 1.3 data e ardhshme e fiksimit të normës së interesit, apo për pozicionet me kupon fiks, maturiteti i mbetur korrespondon me limitet në vijim:
 - 1.3.1 më pak se një muaj: po atë ditë;
 - 1.3.2 ndërmjet një muaji dhe një viti: brenda shtatë ditëve;
 - 1.3.3 mbi një vit: brenda 30 ditëve.

Neni 79

Derivatvët kreditor

1. Gjatë llogaritjes së kërkesave të kapitalit për rrezikun e përgjithshëm dhe rrezikun specifik të palës e cila merr rrezikun kreditor (shitësi i mbrojtjes kreditore), duhet të përdoret shuma nacionale e kontratës së derivativit kreditor, përveç nëse specifikohet ndryshe. Pavarësisht nga

fjalja e parë, banka mund të zgjedhë për të zëvendësuar vlerën nocionale me vlerën nocionale plus ndryshimin e vlerës neto të tregut të derivativit kreditor nga fillimi i tregtimit, një ndryshim neto në rënie nga perspektiva e shitësit të mbrojtjes që mban shenjë negative. Për qëllim të llogaritjes së kërkesave për rrezikun specifik, me përjashtim të kontratave të kundërkëmbimit për shlyerje gjithsej “total return swap”, duhet të aplikohet maturiteti i kontratës së derivativit kreditor, në vend të maturitetit të detyrimit. Pozicionet janë të përcaktuara si në vijim:

- 1.1 një kontratë kundërkëmbimi për shlyerje gjithsej “total return swap” krijon pozicion të gjatë në rrezikun e përgjithshëm të detyrimit referues dhe pozicion të shkurtë në rrezikun e përgjithshëm të një obligacioni të qeverisë me maturitet të barabartë sa periudha deri në fiksimin e ardhshëm të normës së interesit dhe të cilit i është caktuar pesha e rrezikut prej 0% sipas Qasjes së Standardizuar për Rrezikun Kreditor. Gjithashtu, kjo kontratë krijon pozicion të gjatë në rrezikun specifik të detyrimit referues;
- 1.2 një kontratë kreditore kundërkëmbimi e dështuar/pashlyer “credit default swap” nuk krijon pozicion për rrezikun e përgjithshëm. Për qëllim të rrezikut specifik, banka duhet të krijojë një pozicion të gjatë sintetik në një detyrim të entitetit referues, përveç nëse derivativi ka vlerësim të jashtëm dhe i plotëson kriteret e një zëri të borxhit të kualifikuar, në të cilin rast një pozicion i gjatë në kontratën derivative është regjistruar. Nëse premia apo pagesat e interesit janë në vonesë në këtë produkt, këto rrjedha të parasë duhet të paraqiten si pozicione nocionale në obligacionet e qeverisë;
- 1.3 një kontratë vlerënotë e lidhur kreditore me një emër të vetëm “single name credit linked note” krijon pozicion të gjatë në rrezikun e përgjithshëm të vetë vlerënotës, si një produkt i normës së interesit. Për qëllim të rrezikut specifik, një pozicion i gjatë sintetik krijohet në një detyrim të entitetit referues. Një pozicion i gjatë shtesë krijohet në emetuesin e vlerënotës. Në rastet kur kontrata vlerënotë e lidhur kreditore “credit linked note” ka një vlerësim të jashtëm dhe plotëson kriteret si zë i borxhit të kualifikuar, duhet të regjistrohet vetëm një pozicion i gjatë me rrezik specifik të vlerënotës.
- 1.4 përveç një pozicioni të gjatë në rrezikun specifik të emetuesit të vlerënotës, një kontratë vlerënotë e lidhur kreditore me emra të shumëfishtë “multiple name credit linked note” që siguron mbrojtje proporcionale krijon një pozicion në secilin entitet referues, me gjithsej shumë nocionale të kontratës të caktuar ndërmjet pozicioneve sipas proporcionalitetit të gjithsej shumë nocionale që secili ekspozim përfaqëson në entitetin referues. Atëherë kur më tepër se një detyrim i entitetit referues mund të përzgjedhet, detyrimi me peshimin më të lartë të rrezikut përcakton rrezikun specifik;
2. Për palën e cila transferon rrezikun kreditor (blerësi i mbrojtjes kreditore), pozicionet përcaktohen sikurse principi pasqyrë i shitësit të mbrojtjes me përjashtim të kontratës vlerënotë e lidhur kreditore “credit linked note” (që nuk ka pozicion të shkurtë në emetuesin). Gjatë llogaritjes së kërkesave për kapital për “blerësin e mbrojtjes kreditore”, duhet të përdoret shuma nocionale e kontratës së derivativit kreditor. Pavarësisht nga fjalja e parë, banka mund

të përzgjedhë të zëvendësojë vlerën nocionale me vlerën nocionale plus ndryshimin në neto vlerën e tregut të kontratës derivative që nga fillimi i tregtimit, një neto ndryshim në rënie nga perspektiva e shitësit të mbrojtjes që bartë shenjë negative. Nëse në një moment të caktuar ekziston një kontratë opSION thirrje “call option” në kombinim me një rritje “step-up”, një rast i tillë trajtohet sikurse maturiteti i mbrojtjes.

Neni 80

Letrat me vlerë të shitura sipas një marrëveshje të riblerjes apo të huazimit

Transferuesi i letrave me vlerë ose i të drejtave të garantuara që kanë të bëjnë me titullin e letrave me vlerë në një marrëveshje riblerjeje dhe huadhënësi i letrave me vlerë në një huadhënie të letrave me vlerë duhet të përfshijë këto letra me vlerë në llogaritjen e kërkesave për kapital sipas këtij kapitulli në rastet kur këto letra me vlerë janë pozicione të librit tregtar.

Neni 81

Rreziqet specifike dhe rreziqet e përgjithshme

1. Rreziku i pozicionit në instrumentin e tregtueshëm të borxhit apo kapitalit (ose derivativi të borxhit apo kapitalit) duhet të ndahet në dy komponentë në mënyrë që të llogaritet kapitali i kërkuar për rrezikun specifik dhe rrezikun e përgjithshëm.
2. Rreziku specifik është rreziku i ndryshimit të çmimit në instrumentin e caktuar për shkak të faktorëve që lidhen me emetuesin e atij instrumenti ose, në rastet e instrumentit financiar derivativ, emetuesi i instrumentit bazë.
3. Rreziku i përgjithshëm është rreziku i ndryshimit të çmimit në instrument (në rastet e instrumenteve të tregtueshme të borxhit apo instrumenteve derivative të borxhit) për shkak të ndryshimit në nivelin e normave të interesit apo (në rastet e instrumenteve të kapitalit apo instrumenteve derivative të kapitalit) për shkak të lëvizjeve të mëdha të tregjeve të kapitalit që nuk lidhet me ndonjë tipar specifik të letrave me vlerë individuale.

NËN KAPITULLI II INSTRUMENTET E TREGTUESHME TË BORXHIT

Neni 82

Llogaritja e kërkesës për kapital për rrezikun e pozicionit të instrumenteve të borxhit

1. Bankat duhet të klasifikojnë pozicionet e tyre neto në instrumentet e borxhit sipas valutës në të cilën janë të shprehura. Kërkesa e kapitalit për rrezikun e përgjithshëm dhe rrezikun specifik duhet të llogaritet për pozicionin neto në secilën valutë ndaras.
2. Kërkesa e kapitalit për rrezikun e pozicionit në instrumentet e borxhit duhet të llogaritet si shumë e kërkesës së kapitalit për rrezikun specifik dhe rrezikun e përgjithshëm në instrumentet e borxhit.
3. Kërkesa e kapitalit për rrezikun specifik në instrumentet e borxhit duhet të llogaritet në pajtueshmëri me nenet 83 deri 84 të kësaj rregulloreje.
4. Kërkesa e kapitalit për rrezikun e përgjithshëm në instrumentet e borxhit duhet të llogaritet në pajtueshmëri me nenin 85 të kësaj rregulloreje.

Neni 83

Rreziku specifik

1. Bankat duhet të klasifikojnë të gjitha pozicionet neto në instrumentet e borxhit në kategorinë e duhur të instrumentit të borxhit nga Tabela 1 paragrafi 1 i këtij neni, në bazë të emetuesit/obliguesit të tyre dhe maturitetit të mbetur të tyre. Pozicionet neto të klasifikuara në instrumentet e borxhit, pastaj, duhet të shumëzohen me peshat e përshtuara në pajtueshmëri me Tabelën 1 të këtij paragrafi për kategorinë individuale të instrumentit të borxhit të cilës i takojnë. Kërkesa e kapitalit për rrezikun specifik për instrumentet e borxhit duhet të llogaritet si shumë e pozicioneve të peshuara (pavarësisht nëse janë pozicione të gjata apo të shkurta).

Tabela 1: Kategoritë e instrumenteve të borxhit dhe peshat e përcaktuara për llogaritjen e kërkesave të kapitalit për rrezikun specifik (ngarkesat në kapital) për instrumentet e borxhit

	Kategoritë e instrumenteve të borxhit	Peshimet për ngarkesat e kapitalit për rrezikun specifik
1	Letrat me vlerë të borxhit të emetuara apo të garantuara nga qeveritë qendrore, të emetuara nga bankat qendrore, organizatat ndërkombëtare, bankat zhvillimore multilaterale apo qeveritë rajonale apo autoritetet lokale të vendeve anëtare të BE-së, dhe të cilat mund të kualifikohen për shkallën e cilësisë kreditore 1 në pajtim	0%

	me Qasjen e Standardizuar për rrezikun kreditor, apo të cilat marrin peshën e rrezikut 0%.	
2	<p>Letrat me vlerë të borxhit të emetuara apo të garantuara nga qeveritë qendrore, të emetuara nga bankat qendrore, organizatat ndërkombëtare, bankat zhvillimore multilaterale apo qeveritë rajonale apo autoritetet lokale të vendeve anëtare të BE-së dhe të cilat mund të kualifikohen për shkallën e cilësisë kreditore 2 ose 3 në pajtim me Qasjen e Standardizuar për rrezikun kreditor.</p> <p>Letrat me vlerë të borxhit të emetuara apo të garantuara nga institucionet dhe të cilat kualifikohen për shkallën e cilësisë kreditore 1 ose 2 në pajtim me Qasjen e Standardizuar për rrezikun kreditor.</p> <p>Letrat me vlerë të borxhit të emetuara apo të garantuara nga institucionet dhe të cilat kualifikohen për shkallën e cilësisë kreditore 3 në pajtim me nenin 18 të Qasjes së Standardizuar për rrezikun kreditor të kesaj rregulloreje.</p> <p>Letrat me vlerë të borxhit të emetuara apo të garantuara nga korporatat dhe të cilat kualifikohen për shkallën e cilësisë kreditore 1 ose 2 në pajtim me Qasjen e Standardizuar për rrezikun kreditor.</p> <p>Zëra të tjerë të kualifikuar siç definojnë në Nenin 84 të kesaj rregulloreje..</p>	<p>0.25%, nëse periudha kohore e mbetur deri në maturim është 6 muaj apo më pak.</p> <p>1.00%, nëse periudha e mbetur kohore deri në maturim është më e madhe se 6 dhe deri në duke e përfshirë periudhën 24 mujore.</p> <p>1.60%, nëse periudha e mbetur kohore deri në maturim tejkalon 24 muaj.</p>
3	Letrat me vlerë të borxhit të emetuara apo të garantuara nga qeveritë qendrore, të emetuara nga bankat qendrore, organizatat ndërkombëtare, bankat zhvillimore multilaterale apo qeveritë rajonale apo autoritetet lokale të vendeve anëtare të BE-së dhe të cilat mund të	8.00%

	<p>kualifikohen për shkallën e cilësisë kreditore 4 ose 5 në pajtim me Qasjen e Standardizuar për rrezikun kreditor.</p> <p>Letrat me vlerë të borxhit të emetuara apo të garantuara nga korporatat dhe të cilat kualifikohen për shkallën e cilësisë kreditore 3 ose 4 në pajtim me Qasjen e Standardizuar për rrezikun kreditor.</p> <p>Ekspozimet për të cilat vlerësimi kreditor nga një IVJK e emëruar nuk ekziston.</p>	
4	<p>Letrat me vlerë të borxhit të emetuara apo të garantuara nga qeveritë qendrore, të emetuara nga bankat qendrore, organizatave ndërkombëtare, bankat zhvillimore multilaterale apo qeveritë rajonale apo autoritetet lokale të vendeve anëtare të BE-së dhe të cilat mund të kualifikohen për shkallën e cilësisë kreditore 6 në pajtim me Qasjen e Standardizuar për rrezikun kreditor.</p> <p>Letrat me vlerë të borxhit të emetuara apo të garantuara nga korporatat dhe të cilat kualifikohen për shkallën e cilësisë kreditore 5 ose 6 në pajtim me Qasjen e Standardizuar për rrezikun kreditor.</p>	12.00%

2. Bankat duhet të përdorin peshimin më të lartë të paraqitur në Tabelën 1 të paragrafit të parë të këtij neni i cili është 12%, për instrumentet e borxhit për të cilat ekziston rrezik i shtuar për shkak të solvencës së pamjaftueshme të emetuesit apo likuiditetit të instrumentit.

Neni 84

Zërat tjerë të kualifikuar

1. Zërat tjerë të kualifikuar janë:

- 1.1 pozicionet e gjata dhe të shkurta në asetet për të cilat vlerësimi kreditor nga një IVJK e emëruar nuk ekziston dhe të cilat i plotësojnë të gjitha kriteret në vijim:

- 1.1.1 konsiderohen nga banka të jenë likuide mjaftueshëm;

- 1.1.2 kualiteti i investimit është sipas diskrecionit të vetë bankës së paku sikurse ai i

aseteve të përcaktuara në rreshtin e dytë të Tabelës 1 nga neni 83 i kësaj rregulloreje paragrafi 1;

1.1.3 janë të listuara së paku në një treg të rregulluar.

1.2 pozicionet e gjata dhe të shkurta në asetet e emetuara nga institucionet subjekt i kërkesave për kapital siç përcaktohet me këtë Kapitull të cilat konsiderohen nga banka të jenë likuide mjaftueshëm dhe kualiteti i investimit është sipas diskrecionit të vetë bankës së paku sikurse ai i aseteve të përcaktuara në rreshtin e dytë të Tabelës 1 nga neni 83 paragrafi 1;

1.3 letrat me vlerë të emetuara nga institucionet që konsiderohen të jenë të kualitetit të njëjtë apo më të lartë sesa të ekspozimeve për institucionet me shkallë të cilësisë kreditore 2 sipas Qasjes së Standardizuar për rrezikun kreditor.

2. Bankat të cilat aplikojnë nënparagrafët 1.1 dhe ose 1.2 të këtij neni duhet të kenë metodologji të dokumentuar për të vlerësuar nëse asetet i plotësojnë kriteret në ata paragrafë dhe duhet të informojnë BQK-në lidhur me këtë metodologji.

Neni 85

Rreziku i përgjithshëm

Bankat mund të përdorin një qasje, për të llogaritur kërkesat e kapitalit për rrezikun e përgjithshëm, bazuar në maturitet (në pajtueshmëri me nenin 86 të kësaj rregulloreje), apo bazuar në kohëzgjatje (në pajtueshmëri me nenin 87 të kësaj rregulloreje). Bankat duhet të aplikojnë qasjen e zgjedhur në mënyrë të vazhdueshme.

Neni 86

Qasja e bazuar në maturitet

1. Procedura për llogaritjen e kërkesave të kapitalit kundrejt rrezikut të përgjithshëm përfshinë dy hapa themelor. Së pari, të gjitha pozicionet duhet të peshohen sipas maturitetit (siç definohet në paragrafin 2 të këtij neni), në mënyrë që të llogaritet shuma e kapitalit kundrejt tyre. Së dyti, lejimi duhet të bëhet për këtë kërkesë për tu zvogëluar, kur një pozicion i peshuar mbahet kundrejt një pozicioni të kundërt të peshuar brenda një intervali të njëjtë të maturitetit. Një zvogëlim në kërkesë gjithashtu duhet të lejohet kur pozicionet e kundërta të peshuara bien në intervale të ndryshme të maturitetit, me madhësinë e këtij zvogëlimi të varura së bashku nëse të dy pozicionet bien në të njëjtën zonë ose jo, dhe nëse bien në zona të caktuara. Ekzistojnë tri zona (grupe të intervaleve të maturitetit) së bashku.
2. Bankat duhet të caktojnë pozicionet e tyre neto në intervalet përkatëse të maturitetit sipas nevojës në kolonën 2 ose 3, në tabelën 2 në paragrafin 4 të këtij neni. Kjo duhet të bëhet në bazë të maturitetit të mbetur në rast të instrumenteve me normë fikse dhe në bazë të periudhës deri kur rregullohet norma e ardhshme e interesit në rast të instrumenteve kur norma e interesit

është variabile para maturitetit final. Bankat, gjithashtu duhet të dallojnë instrumentet e borxhit me kupon prej 3% apo më të lartë dhe ato me kupon më të ulët se 3%, dhe në këtë mënyrë t'i alokojnë në kolonën 2 ose në kolonën 3 të Tabelës 2 të këtij neni. Bankat, pastaj duhet të shumëzojnë secilin instrument të borxhit me peshën e intervalit të caktuar kohor në kolonën 4 të Tabelës 2 të këtij neni.

3. Bankat duhet të llogarisin shumën e pozicioneve të gjata të peshuara dhe shumën e pozicioneve të shkurta të peshuara në secilin interval kohor. Shuma e pozicioneve të gjata e cila përputhet me shumën e pozicioneve të shkurta në një interval të caktuar kohor paraqet pozicionin e përputhur në atë interval kohor, ndërsa pozicioni i mbetur i gjatë apo i shkurtë paraqet pozicionin e papërputhur për të njëjtin interval kohor. Pastaj duhet të llogaritet totali i pozicioneve të peshuara të përputhura në të gjitha intervalet kohore.
4. Bankat duhet të llogarisin totalet e pozicioneve të gjata të peshuara të papërputhura për intervalet kohore të përfshira në secilën nga zonat në Tabelën 2 të këtij paragrafi në mënyrë që të përfitojnë pozicionin e gjatë të peshuar të papërputhur për secilën zonë. Në mënyrë të ngjashme, shuma e pozicioneve të shkurta të peshuara të papërputhura për secilin interval kohor në një zonë të caktuar duhet të mbledhet për të llogaritur pozicionin e shkurtë të peshuar të papërputhur për atë zonë. Pjesa e pozicioneve të gjata të peshuara e papërputhur për një zonë të caktuar që është e përputhur nga pozicioni i shkurtë i peshuar i papërputhur për zonën e njëjtë është pozicioni i peshuar i përputhur për atë zonë. Pjesa e pozicionit të gjatë apo të shkurtë e peshuar e papërputhur për një zonë e cila nuk mund të përputhet është pozicioni i peshuar i papërputhur për atë zonë.

Tabela 2.

Zona	Intervali kohor		Peshimi (në %)	Ndryshimi i supozuar i normës së interesit (në %)
	Kuponi prej 3% apo më i lartë	Kuponi më i ulët se 3%		
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)
Një	$0 \leq 1$ muaj	$0 \leq 1$ muaj	0,00	-
	$> 1 \leq 3$ muaj	$> 1 \leq 3$ muaj	0,20	1,00
	$> 3 \leq 6$ muaj	$> 3 \leq 6$ muaj	0,40	1,00
	$> 6 \leq 12$ muaj	$> 6 \leq 12$ muaj	0,70	1,00
Dy	$> 1 \leq 2$ vite	$> 1,0 \leq 1,9$ muaj	1,25	0,90
	$> 2 \leq 3$ vite	$> 1,9 \leq 2,8$ muaj	1,75	0,80
	$> 3 \leq 4$ vite	$> 2,8 \leq 3,6$ muaj	2,25	0,75
Tre	$> 4 \leq 5$ vite	$> 3,6 \leq 4,3$ muaj	2,75	0,75

> 5 ≤ 7 vite	> 4,3 ≤ 5,7 muaj	3,25	0,70
> 7 ≤ 10 vite	> 5,7 ≤ 7,3 muaj	3,75	0,65
> 10 ≤ 15 vite	> 7,3 ≤ 9,3 muaj	4,50	0,60
> 15 ≤ 20 vite	> 9,3 ≤ 10,6 muaj	5,25	0,60
> 20 vite	> 10,6 ≤ 12,0 muaj	6,00	0,60
	> 12,0 ≤ 20,0 muaj	8,00	0,60
	> 20 muaj	12,50	0,60

5. Shuma e pozicionit të gjatë (të shkurtë) e peshuar e papërputhur në zonën një e cila përputhet nga pozicioni i shkurtë (i gjatë) i peshuar i papërputhur në zonën dy duhet pastaj të llogaritet. Kjo duhet të referohet në paragrafin 9 të këtij neni si pozicioni i peshuar i përputhur ndërmjet zonës një dhe dy. Llogaritja e njëjtë duhet të ndërmerret pastaj sa i përket asaj pjese të pozicionit të peshuar të papërputhur në zonën dy e cila ka mbetur dhe pozicioni i peshuar i papërputhur në zonën tre në mënyrë që të llogaritet pozicioni i peshuar i përputhur ndërmjet zonës dy dhe tre.
6. Banka mund të ndryshojë radhitjen në paragrafin 5 të këtij neni sa i përket llogaritjes së pozicionit të peshuar të përputhur ndërmjet zonës dy dhe tre para llogaritjes së atij pozicioni ndërmjet zonës një dhe dy.
7. Pjesa e mbetur e pozicionit të peshuar të papërputhur në zonën 1, duhet pastaj të përputhet me atë që mbetet për zonën tre pasi që zona tre të përputhet me zonën dy në mënyrë që të fitohet pozicioni i peshuar i përputhur ndërmjet zonës një dhe tre.
8. Pozicionet e mbetura, duke ndjekur të tri llogaritjet e përputhura të ndara në paragrafët 5, 6 dhe 7, të këtij neni duhet të mblidhen.
9. Kërkesa e kapitalit të bankës duhet të llogaritet si shumë e:
 - 9.1 10 % e shumës së pozicioneve të peshuara të përputhura në të gjitha intervalet kohore;
 - 9.2 40 % e pozicionit të përputhur të peshuar në zonën një;
 - 9.3 30 % e pozicionit të përputhur të peshuar në zonën dy;
 - 9.4 30 % e pozicionit të përputhur të peshuar në zonën tre;
 - 9.5 40 % e pozicionit të përputhur të peshuar ndërmjet zonës një dhe dy dhe ndërmjet zonës dy dhe tre (shih paragrafin 5);
 - 9.6 150 % e pozicionit të përputhur të peshuar ndërmjet zonës një dhe tre; dhe

9.7 100 % e pozicioneve të peshuara të papërputhura të mbetura.

Neni 87

Qasja e bazuar në kohëzgjatje

1. Sipas qasjes së bazuar në kohëzgjatje, bankat duhet të marrin vlerën e tregut të secilit instrument të borxhit me normë fikse dhe të llogarisin rendimentin e tyre në maturim, i cili është norma diskonte e nënkuptuar për atë instrument. Në rastet e instrumenteve me normë variabile, banka duhet të marrë vlerën e tregut të secilit instrument dhe të llogarisë rendimentin e tyre për një periudhë të barabartë me periudhën kohore kur norma e interesit mund të ndryshohet.
2. Banka pastaj duhet të llogarisë kohëzgjatjen e modifikuar të secilit instrument të borxhit në bazë të formulës në vijim:

$$MD = \frac{D}{(1+r)}$$

Ku:

MD = kohëzgjatja e modifikuar

D = kohëzgjatja

r = rendimenti në maturim

C_t = pagesa e mjeteve në periudhën t

m = gjithsej maturiteti

t = koha

$$D = \frac{\sum_{t=1}^m \frac{tC_t}{(1+r)^t}}{\sum_{t=1}^m \frac{C_t}{(1+r)^t}}$$

3. Bankat pastaj duhet të klasifikojnë secilin instrument të borxhit në zonën e duhur në tabelën 3 të këtij paragrafi. Klasifikimi duhet të bëhet në bazë të kohëzgjatjes së modifikuar.

Tabela 3: Klasifikimi i instrumenteve të borxhit sipas kohëzgjatjes së modifikuar

Zona	Kohëzgjatja e modifikuar	Ndryshimi i supozuar i normës së interesit (në %)
(1)	(2)	(3)
Një	$> 0.0 \leq 1.0$	1,00

Dy	$> 1.0 \leq 3.6$	0,85
Tre	> 3.6	0,70

4. Bankat pastaj duhet të llogarisin pozicionin e peshuar të kohëzgjatjes për secilin instrument duke shumëzuar çmimin e tregut të këtij instrumenti me kohëzgjatjen e modifikuar dhe me ndryshimin e supozuar të normës së interesit për një instrument me kohëzgjatjen e caktuar të modifikuar (shih kolonën 3 në tabelën 3) të paragrafit 3 të këtij neni.
5. Banka duhet të llogarisë pozicionet e gjata të kohëzgjatjes së peshuar dhe pozicionet e shkurta të kohëzgjatjes së peshuar në kuadër të secilës zonë. Shuma e pozicioneve të gjata e cila përputhet me shumën e pozicioneve të shkurta në kuadër të secilës zonë është pozicioni i peshuar i kohëzgjatjes së përputhur për atë zonë. Banka pastaj duhet të llogarisë pozicionet e kohëzgjatjes së peshuar të papërputhur për secilën zonë. Pastaj, duhet të ndjekë procedurat e përcaktuara për pozicionet e peshuara të papërputhura në paragrafet 5 deri 8 të definuara në nenin 86.
6. Kërkesa e kapitalit të bankës pastaj duhet të llogaritet si shumë e:
 - 6.1 2 % e pozicionit të peshuar të kohëzgjatjes së përputhur për secilën zonë;
 - 6.2 40 % e pozicionit të peshuar të kohëzgjatjes së përputhur ndërmjet zonës një dhe dy dhe ndërmjet zonës dy dhe tre;
 - 6.3 150 % e pozicionit të peshuar të kohëzgjatjes së përputhur ndërmjet zonës një dhe tre; dhe
 - 6.4 100 % e pozicioneve të mbetura të kohëzgjatjes së peshuar të papërputhur.

NËN KAPITULLI III INSTRUMENTET E KAPITALIT

Neni 88

Pozicionet neto në instrumentet e kapitalit

1. Banka duhet të mbledhë ndaras të gjitha pozicionet e gjata neto dhe të gjitha pozicionet e shkurta neto në pajtueshmëri me nenin 74 të kësaj rregulloreje. Shuma e vlerave absolute të këtyre pozicioneve paraqet pozicionin e përgjithshëm bruto.

2. Banka duhet të llogarisë, ndaras për secilin treg, diferencën në mes të pozicioneve të gjata neto dhe pozicioneve të shkurta neto. Shuma e vlerave absolute të atyre diferencave paraqet pozicionin e përgjithshëm neto.

Neni 89

Rreziku specifik për instrumentet e kapitalit

Banka duhet të shumëzojë pozicionin e përgjithshëm bruto me 12% në mënyrë që të llogarisë kërkesën e saj për kapital për rrezikun specifik.

Neni 90

Rreziku i përgjithshëm për instrumentet e kapitalit

Kërkesa për kapital për rrezikun e përgjithshëm llogaritet duke shumëzuar pozicionin e përgjithshëm neto të bankës me 12%.

Neni 91

Indekset e aksioneve

1. Kontratat e së ardhmes mbi indekset e aksioneve “stock-index futures”, ekuivalentët e peshuar delta të opsioneve në kontratat e së ardhmes mbi indekset e aksioneve dhe indekset e aksioneve “stock indices” së bashku, këtu e tutje të referuara si “kontratat e së ardhmes mbi indekset e aksioneve” “stock-index futures”, mund të ndahen në pozicione në secilin nga aksionet përbërëse. Këto pozicione mund të trajtohen si pozicione bazë të instrumenteve të caktuara të kapitalit, dhe mund të netohen (kompensohen) me vetë pozicionet e kundërta në instrumentet bazë. Bankat, pastaj duhet të njoftojnë BQK-në për përdorimin e këtij trajtimi.
2. Në rastet kur një kontratë e së ardhmes mbi indekset e aksioneve nuk ndahet në pozicionet e saj bazë, atëherë kjo duhet të trajtohet si të ishte një instrument kapitali i vetëm. Megjithatë, kërkesa për kapital për rrezikun specifik për këtë instrument kapitali të vetëm mund të përjashtohet në rastet kur kontrata e së ardhmes mbi indeksin e aksionit në fjalë tregtohet në bursë dhe përfaqëson një indeks të përshtatshëm dhe të diversifikuar siç duhet.

NËN KAPITULLI IV
NËNSHKRIMI I LETRAVE ME VLERË “UNDERWRITING”

Neni 92

Zvogëlimi i pozicioneve neto

1. Në rastet e nënshkrimeve “underwriting” të instrumenteve të borxhit dhe instrumenteve të kapitalit, banka mund të përdorë procedurën në vijim gjatë llogaritjes së kërkesave për kapital. Së pari, banka duhet të llogarisë pozicionet neto duke zbritur pozicionet e nënshkuara “underwriting” të cilat janë nënshkuar apo nën-nënshkuar nga palët e treta bazuar në marrëveshjet formale. Banka më vonë duhet të zvogëlojë pozicionet neto me faktorët zvogëlues të paraqitur në tabelën 4 të këtij paragrafi dhe pastaj të llogarisë kërkesën e saj për kapital duke përdorur pozicionet e zvogëluara nga nënshkrimi.

Tabela 4.

Dita e punës 0	100%
Dita e punës 1	90%
Ditët e punës 2 deri 3	75%
Dita e punës 4	50%
Dita e punës 5	25%
Pas ditës 5 të punës	0%

“Dita e punës 0” nënkupton ditën e punës kur banka pa kushte zotohet të pranojë një sasi të caktuar të letrave me vlerë me një çmim të përcaktuar me marrëveshje.

2. Banka duhet të njoftojë paraprakisht BQK-në për aplikimin e paragrafit 1 të këtij neni.

NËN KAPITULLI V
KËRKESA PËR KAPITAL PËR RREZIKUN SPECIFIK PËR POZICIONET E
MBROJTURA NGA DERIVATIVËT KREDITORË

Neni 93

Lejimet për mbrojtjen me derivativët kreditorë

1. Lejimi do të jepet për përdorimin mbrojtës me derivativët kreditorë, në pajtueshmëri me principet e përcaktuara në paragrafët 2 deri 6 të këtij neni.
2. Bankat duhet të trajtojnë pozicionin në derivativin kreditor si një “anë” si dhe pozicionin e mbrojtur që ka të njëjtën vlerë nominale, apo nëse është e aplikueshme, të njëjtën vlerë nocionale si “anë” tjetër.
3. Lejimi i plotë do të jepet atëherë kur vlerat e dy “anëve” gjithmonë lëvizin në drejtimet e kundërta dhe kanë afërsisht të njëjtën madhësi. Ky rast do aplikohet vetëm për situatat e përshkruara më poshtë:
 - 3.1 të dy “anët” përbëhen nga instrumentet identike;
 - 3.2 pozicioni i gjatë në para është i mbrojtur nga një kontratë kundërkëmbimi për shlyerje gjithsej nga normat e interesit “total rate of return swap” (apo e kundërta) dhe ekziston një përputhje e plotë në mes të detyrimit referencë dhe ekspozimit bazë (d.m.th, pozicioni në para). Maturiteti i kontratës së kundërkëmbimit “swap” mund të jetë i ndryshëm nga ai i ekspozimit bazë. Në këto situata, kërkesa për kapital për rrezikun specifik nuk duhet të aplikohet në asnjërën anë të pozicionit.
4. Një kompensim prej 80% do të aplikohet në rastet kur vlerat e dy “anëve” gjithmonë lëvizin në drejtimet e kundërta dhe kur ekziston një përputhje identike sa i përket detyrimit referencë, maturitetit të detyrimit referencë dhe derivativit kreditor dhe të valutës së ekspozimit bazë. Përveç kësaj, karakteristikat kryesore të kontratës së derivativit kreditor nuk duhet të shkaktojnë lëvizjen e çmimit të derivativit kreditor në mënyrë që materialisht të devijojë nga lëvizjet e çmimit të pozicionit në para. Për nivelin që transaksioni e transferon rrezikun, një kompensim prej 80% e rrezikut specifik duhet të aplikohet në anën e transaksionit me kërkesën më të lartë për kapital, ndërsa kërkesat e rrezikut specifik në anën tjetër duhet të jenë zero.
5. Lejimi i pjesërishëm do të jepet, duke përjashtuar rastet nga paragrafi 3 dhe 4 të këtij neni, për rastet si në vijim:
 - 5.1 pozicioni i plotëson kushtet sipas paragrafit 3, nënparagrafit 3.2 por ekziston një mospërputhje asetesh në mes të detyrimit referencë dhe ekspozimit bazë. Megjithatë, këto pozicione i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

5.1.1 detyrimi referencë radhitet në të njëjtin nivel (pari passu) ose në një nivel më të ulët (junior) përparësie, krahasuar me detyrimin bazë;

5.1.2 detyrimi bazë dhe detyrimi referent kanë të njëjtin obligues dhe kanë klauzola detyruese mospërmbushje kryq “cross-default” apo klauzola përshpejtimi kryq “cross-acceleration”;

5.2 pozicioni i plotëson kushtet sipas paragrafit 3, nënparagrafi 3.1 apo paragrafit 4 mirëpo ekziston një mospërputhje në valutë apo në maturitet në mes të mbrojtjes kreditore dhe asetit bazë (underlying asset). Mospërputhja e tillë në valutë duhet të përfshihet në llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun nga këmbimi valutor;

5.3 pozicioni i plotëson kushtet sipas paragrafit 4 të këtij neni mirëpo ekziston një mospërputhje në aset ndërmjet pozicionit në para dhe derivativit kreditor. Megjithatë, asetit bazë përfshihet në obligime (të dorëzueshme) në dokumentacionin e derivativit kreditor.

Në mënyrë që të jepet lejimi i pjesëshëm, për të mos llogaritur kërkesën për kapital për rrezikun specifik për secilën anë të transaksionit, duhet të aplikohet vetëm kërkesa më e lartë nga dy kërkesat për kapital.

6. Në të gjitha rastet tjera, të cilat nuk përfshihen në paragrafët 3 deri 5 të këtij neni, kërkesa e kapitalit për rrezikun specifik duhet të llogaritet për të dy anët e pozicioneve ndaras.

Neni 94

Lejimet për mbrojtjen me derivativët kreditorë së pari - për të dështuar “first to default” dhe nth - për të dështuar “nth-to default”

1. Për rastet e derivativëve kreditorë së pari - për të dështuar “first-to-default” dhe nth - për të dështuar, aplikohet trajtimi në vijim sa i përket lejimeve që duhet dhënë në pajtueshmëri me nenin 93 të kësaj rregullore:

1.1 në rastet kur një bankë merr mbrojtje kreditore për një numër të entiteteve referuese prej nga rrjedh derivativi kreditor sipas kushteve që dështimi i parë nga asetet mund të nxisë pagesë dhe rasti i dështimit të tillë do të ndërpresë kontratën, banka mund të kompensojë rrezikun specifik të entitetit referues ndaj të cilës aplikohet ngarkesa në përqindje më e ulët e rrezikut specifik në mes të entiteteve referente bazë sipas Tabelës 1 të nenit 83 të kësaj rregulloreje (Instrumentet e tregtueshme të borxhit).

1.2 në rastet kur dështimi i n-th në kuadër të ekspozimeve nxitë kryerjen e pagesës sipas mbrojtjes kreditore, blerësi i mbrojtjes kreditore vetëm mund të kompensojë rrezikun specifik nëse mbrojtja gjithashtu është marrë për dështimet 1 deri në n-1 apo kur dështimet n-1 kanë ndodhur. Në rastet e tilla metodologjia e përcaktuar në nënparagrafin 1.1, të këtij neni, për derivativët kreditor së pari-për të dështuar duhet të ndryshohet në mënyrë të përshtatshme për produktet n-th-për të dështuar.

NËN KAPITULLI VI
KËRKESAT E KAPITALIT PËR RREZIKUN NGA POZICIONET NË MALLRA
“COMMODITIES”

Neni 95

Zgjedhja e qasjes për rrezikun nga pozicionet në mallra

Subjekt i neneve 96 deri 101 të kësaj rregulloreje, bankat duhet të llogarisin kërkesat e kapitalit për rrezikun e mallrave me njëjën nga qasjet e përcaktuara në nenet 99, 100 apo 101 të kësaj rregulloreje.

Neni 96

Bizneset plotësuese të mallrave

1. Bankat me biznese plotësuese të mallrave bujqësore mund të përcaktojnë kërkesat e kapitalit për stokun e tyre fizik të mallrave në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, kur plotësohen të gjitha kushtet në vijim:
 - 1.1 në çdo kohë të vitit mban kapitalin për këtë rrezik që nuk është më i ulët se mesatarja e kërkesave të kapitalit për atë rrezik të parashikuar në bazë konservative për vitin e ardhshëm;
 - 1.2 parashikon në bazë konservative paqëndrueshmërinë e pritshme për rezultatin e llogaritur nënparagrafin 1.1 të këtij paragrafi;
 - 1.3 kërkesa mesatare për kapital për këtë rrezik nuk e tejkalon 5% të kapitalit rregullator apo 1 milion euro dhe, duke marrë parasysh paqëndrueshmërinë e vlerësuar në pajtueshmëri me nënparagrafin 1.2 të këtij paragrafi, pika më e lartë e pritshme e kërkesave për kapital nuk e tejkalon 6.5% të kapitalit rregullator;
 - 1.4 banka kontrollon në bazë të vazhdueshme nëse parashikimet e kryera nënparagrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij paragrafi ende reflektojnë realitetin.
2. Bankat duhet të njoftojnë paraprakisht BQK-në për përdorimin e opsioneve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 97

Pozicionet në mallra

1. Çdo pozicion në mallra ose në derivativët e mallrave duhet të shprehet në formë të njësisë standarde të matjes. Çmimi aktual “spot” në secilin mall duhet të shprehet në valutën raportuese.

2. Pozicionet në ari apo derivativë të arit konsiderohen si subjekt i rrezikut të këmbimit valutor, sipas rastit, për qëllim të llogaritjes së rrezikut të mallrave.
3. Për qëllim të nenit 100, paragrafit 1, teprica e pozicioneve të gjata të bankës ndaj pozicioneve të shkurta, apo anasjelltas, në të njëjtin mall dhe kontrata identike e së ardhmes në mallra “commodity futures”, opsione dhe garanci duhet të konsiderohet pozicioni neto për secilin mall. Instrumentet derivative duhet të trajtohen, siç përcaktohet në nenin 98 të këtij kapitulli, si pozicione në mallin bazë “underlying commodity”.
4. Për qëllim të llogaritjes së një pozicioni në një mall, pozicionet në vijim duhet të trajtohen si pozicione në të njëjtin mall:
 - 4.1 pozicionet në nën-kategori të ndryshme të mallrave në rastet kur nën-kategoritë janë të këmbyeshme kundrejt njëra tjetrës;
 - 4.2 pozicionet në mallrat e ngjashëm, në rast se janë zëvendësues të afërt të njëri tjetrit dhe në rast se koeficienti i korrelacionit prej 0.9 ndërmjet lëvizjeve të çmimeve mund të përcaktohet qartë gjatë një periudhe njëvjeçare.

Neni 98

Instrumentet e veçanta

1. Kontratat e së ardhmes në mallra (ang:“commodity futures”) dhe zotimet me pajtim paraprak (ang:“forward commitments”) për të blerë apo për të shitur mallrat individuale duhet të përfshihen në sistemin e matjes si shuma nocionale sa i përket njësisë standarde të matjes dhe duhet t’iu caktohet një maturitet me referencë sipas datës së maturimit.
2. Kontratat e kundërkëmbimit në mallra “commodity swaps” ku njëra anë e transaksionit është çmim fiks dhe ana tjetër është çmim aktual i tregut duhet të trajtohet si seri e pozicioneve të barabarta me shumën nocionale të kontratës, me një pozicion që korrespondon me secilën pagesë në kontratën e kundërkëmbimit “swap”, aty ku është e aplikueshme, dhe e klasifikuar në intervale kohore sipas nenit 99 paragrafi 1. Pozicionet duhet të jenë pozicione të gjata nëse banka paguan çmim fiks dhe pranon çmim variabil dhe pozicione të shkurta nëse banka pranon çmim fiks dhe paguan çmim variabil. Kontratat e kundërkëmbimit në mallra “commodity swaps” ku anët e transaksionit janë në mallra të ndryshme duhet të raportohen në shkallën përkatëse të raportimit sipas qasjes së shkallës së maturitetit.
3. Opsionet “options” dhe garancitë “warrants” në mallra apo në derivativët e mallrave duhet të trajtohen sikur të ishin pozicione të barabarta në vlerë me shumën e mallit bazë të cilit i referohet opsioni, të shumëzuar me koeficientin delta për qëllim të këtij kapitulli. Pozicionet e fundit mund të netohen kundrejt pozicioneve të kompensueshme në mallin bazë identik apo derivativin e mallit. Koeficienti delta i përdorur duhet të jetë i bursës së caktuar ku tregtohen instrumentet. Për opsionet e tregtuara jashtë bursës “OTC options”, ose kur koeficienti delta nuk është në dispozicion nga bursa e caktuar, banka mund të llogarisë vetë këtë koeficient

duke përdorur një model adekuat, me aprovimin paraprak të BQK-së. Aprovimi do të jepet nëse modeli vlerëson në mënyrë të përshtatshme shkallën e ndryshimit të vlerës së opsioneve apo vlerës së garancive në lidhje me ndryshimet e vogla të çmimit të tregut të mallit bazë. Bankat duhet të reflektojnë në mënyrë adekuate edhe rreziqet e tjera të lidhuara me opsionet, përveç rrezikut të koeficientit delta, sa i përket kërkesave të kapitalit.

4. Kur një bankë është një nga të mëposhtmet, duhet të përfshijë mallrat e caktuar në llogaritjen e kërkesave të kapitalit për rrezikun e mallrave:
 - 4.1 transferues i mallrave apo të drejtave të garantuara që lidhen me titullin e mallrave në një marrëveshje të riblerjes;
 - 4.2 huadhënës i mallrave në një marrëveshje huazimi për mallrat.

Neni 99

Qasja sipas shkallës së maturitetit

1. Banka duhet të përdorë një shkallë të veçantë të maturitetit në përputhje me Tabelën 1 të këtij paragrafi dhe neni, për çdo mall. Të gjitha pozicionet në atë mall duhet të caktohen në intervalet përkatëse të maturitetit. Stoqet fizike duhet të caktohen në intervalin e maturimit në mes të 0 muaj deri / dhe duke përfshirë 1 muaj.

Tabela 1.

Intervalet e maturitetit (1)	Norma e shpërndarjes(në %) (2)
$0 \leq 1$ muaj	1,50
$> 1 \leq 3$ muaj	1,50
$> 3 \leq 6$ muaj	1,50
$> 6 \leq 12$ muaj	1,50
$> 1 \leq 2$ vjet	1,50
$> 2 \leq 3$ vjet	1,50
> 3 vjet	1,50

2. Pozicionet në të njëjtin mall mund të kompenzohen në mes tyre dhe të caktohen në intervalet përkatëse të maturitetit në baza neto për pozicionet në vijim:
 - 2.1 pozicionet në kontrata që maturojnë në të njëjtën datë;
 - 2.2 pozicionet në kontrata që maturojnë brenda 10 ditëve në mes tyre, nëse kontratat tregtohen në tregje që kanë data ditore të dorëzimit.

3. Banka duhet të llogarisë shumën e pozicioneve të gjata dhe shumën e pozicioneve të shkurta në secilin interval të maturimit. Shuma e pozicioneve të gjata që kompenzohet nga suma e pozicioneve të shkurta në një interval të caktuar të maturitetit paraqet pozicionin e përrputhur në atë interval, ndërsa pozicioni i mbetur i gjatë apo i shkurtë paraqet pozicionin e papërrputhur për të njëjtin interval.
4. Pjesa e pozicionit të gjatë të papërrputhur për një interval të caktuar të maturitetit që përrputhet nga pjesa e papërrputhur e pozicionit të shkurtë, apo anasjelltas, për një interval të maturitetit, më tutje paraqet pozicionin e përrputhur ndërmjet dy intervaleve të maturitetit. Ajo pjesë e pozicionit të gjatë apo të shkurtë e pa papërrputhur që nuk mund të përrputhet paraqet pozicionin e papërrputhur.
5. Kërkesa për kapital e bankës për çdo mall, duhet të llogaritet në bazë të shkallëve relevante të maturitetit si shumë e pozicioneve në vijim :
 - 5.1 shuma e pozicioneve të përrputhura të gjata dhe të shkurta, të shumëzuar me normën adekuate të shpërndarjes “spread rate” siç është përcaktuar në kolonën e dytë të Tabelës 1 për secilin interval të maturitetit dhe të shumëzuar me çmimin aktual “spot” të mallit;
 - 5.2 pozicionit të përrputhur në mes të dy intervaleve të maturitetit, për secilin interval të maturitetit në të cilin një pozicion i papërrputhur është bartur, i shumëzuar me 0.6%, që është norma e bartjes “carry rate” dhe me çmimin spot të mallit;
 - 5.3 pozicionet e mbetura të papërrputhura, të shumëzuara me 15% që është norma e drejtpërdrejtë “outright rate” dhe me çmimin aktual “spot” të mallit.
6. Gjithsej kërkesat për kapital të bankës për rrezikun e mallrave duhet të llogariten si shumë e kërkesave për kapital të llogaritur për çdo mall në pajtueshmëri me paragrafin 5 të këtij neni.

Neni 100

Qasja e thjeshtë

1. Kërkesa për kapital e bankës për çdo mall duhet të llogaritet si shumë e elementeve të mëposhtme:
 - 1.1 15 % e pozicionit neto, të gjatë apo të shkurtë, shumëzuar me çmimin aktual “spot” të mallit;
 - 1.2 3 % e pozicionit bruto, të gjatë plus të shkurtë të shumëzuar me çmimin aktual “spot” të mallit;
2. Gjithsej kërkesat për kapital të bankës për rrezikun e mallrave duhet të llogariten si shumë e kërkesave për kapital të llogaritur për çdo mall në pajtueshmëri me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 101

Qasja e zgjeruar sipas shkallës së maturitetit

1. Bankat mund të përdorin normën e shpërndarjes “spread”, të bartjes “carry” dhe të drejtpërdrejtë “outright” të përcaktuar në tabelën 2 të këtij paragrafi në vend të atyre të përcaktuara në nenin 99 të kësaj rregulloreje me kusht që bankat :

1.1 realizojnë biznes të konsiderueshëm me mallra;

1.2 kanë një portofol në mallra të diversifikuar në mënyrë adekuate;

1.3 nuk janë ende në gjendje të përdorin modelet e brendshme për qëllim të llogaritjes së kërkesave për kapital për rrezikun e mallrave.

Tabela 2.

	Metale të çmuara (përveç arit)	Metalet bazë	Produkte agrokulturore (të butat)	Të tjera, duke përfshirë produktet e energjisë
Norma e shpërndarjes (%)	1,0	1,2	1,5	1,5
Norma e bartjes (%)	0,3	0,5	0,6	0,6
Norma e drejtpërdrejtë (%)	8	10	12	15

2. Bankat, duhet të njoftojnë paraprakisht BQK-në për aplikimin e këtij neni së bashku me dëshmitë për përpjekjen e tyre për të implementuar një model të brendshëm me qëllim të llogaritjes së kërkesave për kapital për rrezikun e mallrave.

NËN KAPITULLI VII TRAJTIMI I OPSIONEVE

Neni 102

Kërkesa për kapital për opsionet

1. Bankat të cilat vetëm blejnë opsione mund të përdorin qasjen e thjeshtë për të llogaritur kërkesat për kapital.
2. Bankat të cilat përdorin qasjen e thjeshtë, duhet të llogarisin kërkesat për kapital për rrezikun e përgjithshëm të tregut dhe rrezikun specifik.
3. Kërkesat për kapital të llogaritura sipas paragrafit 2 të këtij neni, duhet të shtohen në kategorinë përkatëse, d.m.th., në instrumentet e tregtueshme të borxhit, instrumentet e kapitalit, këmbimin valutor dhe mallrat.
4. Bankat, për pozicionet e blera në thirrje “call” dhe në shitje “put”, duhet të llogarisin kërkesat për kapital si vlerën më të vogël ndërmjet:
 - 4.1 vlerës së tregut të instrumentit bazë të opsionit shumëzuar me shumën e kërkesës për kapital për rrezikun specifik dhe rrezikun e përgjithshëm; dhe
 - 4.2 vlerës së tregut të opsionit.
5. Bankat, për pozicionet e gjata në instrumentin bazë “long cash” të shoqëruar me një opsion në shitje të blerë “long put”, ose për pozicionet në shitje në instrumentin bazë “short cash” të shoqëruar me një opsion në thirrje të blerë “long call”, duhet të llogarisin kërkesat për kapital duke shumëzuar vlerën e tregut të instrumentit bazë me shumën e kërkesës për kapital të rrezikut specifik dhe rrezikut të përgjithshëm të tregut të tij duke zbritur shumën e opsionit që mund të gjeneroj mjete (nëse ekziston pozicioni i tillë) të kufizuar në zero.
6. Bankat duhet të llogarisin opsionet që mund të gjerorjnë mjete si në vijim:
 - 6.1 për opsionet në thirrje, si diferencë ndërmjet vlerës së tregut të instrumentit bazë dhe çmimit ekzekutues; dhe
 - 6.2 për opsionet në shitje, si diferencë ndërmjet çmimit ekzekutues dhe vlerës së tregut të instrumentit bazë.

NËN KAPITULLI VIII
RREZIKU I SHLYERJES DHE DËRGESAT E LIRA

Neni 103

Kërkesa për kapital për rrezikun e shlyerjes (angl. Settlement risk)

1. Bankat që kryejnë transaksione në instrumente të borxhit, instrumente kapitali, valuta të huaja, derivativë dhe mallra (*commodities*), mund të ekspozohen ndaj rrezikut të humbjeve që buron nga mos shlyerja e transaksionit në datën e shlyerjes.
2. Në rast se këto transaksione nuk janë shlyer në datën e shlyerjes (datën e maturimit), banka duhet të llogaritë ndryshimin e çmimit ndaj të cilit ekspozohet. Ky ndryshim llogaritet si diferencë në mes të çmimit të shlyerjes të përcaktuar në kontratë për instrumentin e borxhit, të kapitalit, valutave të huaja apo mallrave (*commodities*) dhe vlerës së aktuale të tregut atëherë kur kjo diferencë është pozitive, pra kur banka humbë nga kjo diferencë.
3. Në rast se nga diferenca në çmim (sipas paragrafit 2 të këtij neni) banka do të ketë humbje, atëherë kjo diferencë duhet të shumëzohet me një nga faktorët e peshimit, të paraqitur në kolonen B të tabelës 1 të këtij neni, për të llogaritur kërkesën për kapital.

Tabela 1. Kalkulimi i kapitalit rregullator për rrezikun e shlyerjes

A. Numri i ditëve të punës pas datës së shlyerjes	B. Faktorët e peshimit, në përqindje të gjithsej kapitalit
5 – 15 ditë	8
16 – 30 ditë	50
31 – 45 ditë	75
46 ditë ose më shumë	100

4. Në rastet e mosfunksionimit të sistemit bankar (ngjarje sistemike) apo të mosfunksionimit të sistemit të pagesave, BQK mund të pezullojë aplikimin e kërkesave për kapital për rrezikun e operacioneve të pashlyera, pjesërisht ose plotësisht, deri në kthim në normalitet të funksionit të këtij sistemi. Në raste të tilla, mosshlyerja e një transaksioni nga ana e një subjekti nuk konsiderohet si ekspozim i dështuar (angl. *default*), në kontekst të rrezikut të kredisë.

Neni 104

Kërkesa për kapital për dërgesat e lira (angl. Free deliveries)

1. Rreziku që lidhet me ‘dërgesat e lira’ ndryshon nga ‘rreziku i shlyerjes’ në kuptimin që në rastin e këtij të fundit, banka akoma nuk ka realizuar ndonjë pagesë apo dërgesë. Ndërsa, te dërgesat e lira, banka tashmë ka realizuar aktivitet tregtar, mirëpo pagesa apo dërgesa nga pala tjetër akoma nuk është arkëtuar (shlyer).
2. Bankat duhet të ndajnë kapital për rrezikun që vjen nga dërgesat e lira, si në rastet e mëposhtme të këtij paragrafi dhe sipas tabelës 2 të këtij paragrafi dhe neni:
 - 2.1 kur ka paguar për letra me vlerë, valuta të huaja apo mallra (commodities) para se t’i marrë ato (instrumentet), apo në rastet kur ka dorëzuar letrat me vlerë, valutat e huaja apo mallrat para se të pranojë pagesën për to;
 - 2.2 në rast të transaksioneve ndërkombëtare, një apo më shumë ditë kanë kaluar nga dita e pagesës ose dorëzimit (të instrumenteve).

Tabela 2. Kërkesa për kapital për dërgesat e lira

	A	B	C
Lloji i transaksionit	Deri në pagesën e parë ose shlyerjes së kontratës	Nga pagesa e parë kontraktuale ose dërgesa e parë deri në katër ditë pas pagesës kontraktuale ose dërgesës	Prej 5 ditë pune e tutje pas pagesës së dytë kontraktuale ose vonesës në dërgesë
Dërgesat e lira	Nuk aplikohet kërkesë për kapital	Të trajtohet si ekspozim, sipas Rregullores për Ekspozimet e Peshuara me Rrezik	Zbritet shuma e transferuar dhe shtohet vlera aktuale pozitive

3. Në rastin e ekspozimit ndaj rrezikut të dërgesave të lira sipas kolonës C në tabelën 2, bankat mund të peshojnë ekspozimet me 100% në të gjitha ekspozimet e tilla.
4. Nëse ekspozimi me vlerë positive që rezulton nga transaksionet me dërgesa të lira nuk është material, bankat mund të peshojnë këto ekspozime me 100 %.
5. Bankat që kanë kryer pagesën ose dorëzimin dhe nuk kanë marrë vlerën korresponduese brenda ditës së katërt të punës, pas datës së parashikuar për shlyerjen e detyrimit nga ana e kundërpalës, zbresin nga kapitali rregullator shumën më të madhe, ndërmjet parasë së gatshme të transferuar dhe vlerës aktuale të instrumenteve korresponduese të pritshëm ose

ndërmjet parasë së gatshme që pritet të marrë dhe vlerës aktuale të instrumenteve përkatëse të transferuar kundërpalës.

NËN KAPITULLI IX RREZIKU I KËMBIMIT VALUTOR

Neni 105

Llogaritja e kërkesave për kapital për rrezikun e këmbimit valutor

1. Nëse gjithsej pozicioni neto i hapur valutor dhe gjithsej pozicioni i hapur neto i arit të bankës, i tejkalon 2% të gjithsej kapitalit rregullator, banka duhet të shumëzojë shumën e pozicionit neto të hapur në valutë të huaj dhe pozitën e saj neto në ari me 12%, në mënyrë që të llogaritet kërkesa e kapitalit kundrejt rrezikut të këmbimit valutor.
2. Llogaritja e kërkesës për kapital për rrezikun e këmbimit valutor do të realizohet në dy faza:
 - 2.1 Së pari, llogaritet veçmas neto pozicioni i hapur në çdo valutë (duke përfshirë edhe valutën raportuese) dhe në ari. Ky pozicion neto i hapur do të përbëhet nga shuma e elementeve të mëposhtme (pozitive ose negative):
 - 2.1.1 për pozicionet sipas çmimit aktual (angl. *Spot*): të gjitha pozicionet e aseteve minus të gjitha pozicionet e detyrimeve, përfshi edhe interesin e përlllogaritur (angl. *Accrued*) në valutën përkatëse ose në ari, sipas çmimit aktual të tregut (*Spot*);
 - 2.1.2 për pozicionet sipas kontratave me pajtim paraprak (angl. *Forward*): totali i vlerës që do të pranohet minus totali i vlerës që do të paguhet sipas këmbimit forward, përfshi valutat dhe arin sipas kontratave të së ardhmes (angl. *Futures*) dhe principalin në valutat me kontratë kundërkëmbimi (angl. *Swap*) të papërfshira në pozicionet me çmim aktual (*Spot*);
 - 2.1.3 garancionet e pakthyeshme (angl. *Irrevocable guarantees*) që mund të thirren dhe mund të jenë të pakthyeshme;
 - 2.1.4 të hyrat/shpenzimet neto të ardhshme që nuk janë akumuluar akoma (angl. *Accrued*) mirëpo janë plotësisht të mbrojtura (*hedged*) (Në diskrecionin e bankës raportuese dhe me pëlqimin paraprak të BQK-së, mund të përfshihen të ardhurat/shpenzimet neto të ardhshme që nuk janë regjistruar ende në pasqyrat financiare mirëpo që janë plotësisht të mbrojtura me transkaksionet e këmbimeve valutore të jashtme) Diskrecione të tilla duhet të aplikohen në baza të vazhdueshme.

- 2.2 Së dyti, pozicionet neto të shkurtra dhe të gjata në çdo valutë të ndryshme nga valuta raportuese dhe pozicioni neto i gjatë ose i shkurtër në ar, duhet të konvertohet në valutën raportuese sipas çmimit aktual (spot).
- 2.2.1 Pastaj, mbildhet veçmas totali i neto pozicionit të shkurtë dhe veçmas totali neto pozicionit të gjatë.
- 2.2.2 Vlera më e madhe mes këtyre dy totaleve paraqet neto pozicionin e përgjithshëm të këmbimit valuator.
3. Pozicionet neto në valuta të përbëra (angl. *composite currencies*) mund të listohen si të ndara sipas kuotave aktuale.

Neni 106

Përrjashtimet në rastin e rrezikut të këmbimit valutor

1. Çdo pozicion që një bankë ka marrë me qëllim për të mbrojtur efektin e kundërt të kursit të këmbimit në treguesin e kapitalit mund të përjashtohet nga llogaritja e pozicioneve valutore të hapura neto. Pozicionet e tilla duhet të jenë të një natyre jo tregtare dhe për përjashtimin e tyre, si dhe çdo ndryshim i kushteve të përjashtimit të tyre, duhet të kërkohet pëlqimi paraprak nga BQK. Pozicionet e tilla janë:
- 1.1 Pozicionet me natyrë strukturore (pozicione jo të tregtueshme);
- 1.2 Pozicionet e përjashtuara mbrojnë vetëm adekuatshmërinë e kapitalit të bankës;
- 1.3 Përjashtimi i këtyre pozicioneve bëhet në mënyrë të rregullt (përsëritur)

KAPITULLI VI

KËRKESAT E KAPITALIT PËR RREZIKUN OPERACIONAL

Neni 107

Rreziku operacional

1. Bankat duhet të llogarisin kërkesat e kapitalit për rrezikun operacional sipas Qasjes së Treguesit Bazik (QTB).
- 1.1 Sipas QTB-së, një ngarkesë e kapitalit prej pesëmbëdhjetë përqind (15%) të të hyrave bruto duhet t'iu shtohet mjeteve të rrezikuara të bankës për kalkulim të raportit të rrezikut

të mjeteve. Të hyrat bruto definoohen si të hyrat neto nga interesi plus të hyrat neto jo nga interesi. Kjo masë duhet:

- 1.1.1 të jetë bruto nga çfarëdo ngarkese (p.sh për interesin e papaguar);
 - 1.1.2 të jetë bruto nga shpenzimet operative, përfshirë ngarkesat e paguara ofruesve të shërbimeve të jashtëm;
 - 1.1.3 të mos përfshijë fitimet/humbjet nga shitja e letrave me vlerë të cilat mbahen ne librat e bankës për qëllime jo tregtimi;
 - 1.1.4 të mos përfshijë pozicione jo të rregullta apo të jashtëzakonshme si dhe të hyra që rrjedhin nga sigurimi.
- 1.2 Për bankat e sapo themeluara, me të dhëna më pak se tri vjet, duhet të përdorën të hyrat bruto deri në datën e caktuar me qëllim të arritjes deri te mesatarja e të hyrave bruto, derisa të hyrat bruto për kuartalet e mbetura të lihen zero.
2. Me aprovimin paraprak të BQK-së, bankat mund të aplikojnë qasjen e standardizuar për kalkulim të kapitalit për rrezik operacional. Sipas qasjes së standardizuar kërkesa për kapital për rrezikun operacional është mesatarja e tri vitevetë treguesve relevant të mjeteve të rrezikuara, të llogaritura çdo vit sipas linjave biznesore (në pajtim me Aneksin VI dhe Aneksin VII). Për secilin vit, kërkesa negative për kapital në një linjë biznesore, që rrjedh nga një tregues relevant negativ mund të ngarkohet në total. Sidoqoftë, kur ngarkesa totale për kapital për të gjitha linjat biznesore brenda një viti të caktuar është negative, atëherë e dhëna mesatare për atë vit duhet të jetë zero. Mesatarja tre vjeçare llogaritet në bazë të vrojttimeve të tre viteve të fundit, në fund të secilit vit financiar. Kur të dhënat e audituara nuk janë në dispozicion, vlerësimet nga banka mund të përdoren.

KAPITULLI VII DISPOZITAT FINALE

Neni 108

Raportimi në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Bankat duhet të dorëzojnë në BQK, format e raportimit të përcaktuara nga BQK, sipas udhëzimeve përkatëse të BQK-së, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo muaji, së bashku me raportet e rregullta mujore, në pajtim me Rregulloren për Raportimin e Bankave.

Neni 109

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Bankat.

Neni 110

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 22 dhjetor 2015, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 111

Anekset

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është: Aneksi I, II, III, IV, V, VI dhe VII.

Neni 112

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më datë 01.01.2020.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

ANEKSI I
KLASIFIKIMI I ZËRAVE JASHTËBILANCOR

1. Zërat me rrezik të lartë me faktor të konvertimit kreditor 100%:
 - 1.1. Garancitë të cilat karakter të zëvendësuesve kreditorë,
 - 1.2. Pranimet,
 - 1.3. Avalet – Garancitë për të paguar vlerën nominale të kambialit në maturim, qekut apo instrumenteve të ngjashme që nuk mbajnë emrin e një institucioni tjetër;
 - 1.4. Transaksionet me rekurs,
 - 1.5. Letrat kreditore të parevokueshme me karakteristikat e zëvendësimit kreditor,
 - 1.6. Mjetet e blera nëpërmjet marrëveshjeve “Forward” të blerjes,
 - 1.7. Depozitat “forward”, të cilat përfaqësojnë depozitim fizik të fondeve të parashikuar për një datë të përcaktuar në të ardhmen sipas kontratës/ave respektive;
 - 1.8. Pjesa e papaguar e letrave me vlerë dhe e aksioneve pjesërsht të paguara
 - 1.9. Marrëveshjet e shitjes dhe riblerjes së mjeteve, dhe
 - 1.10. Zëra të tjerë jashtëbilancor me rrezik të lartë, të klasifikuar nga vetë banka dhe të vlerësuar nga BQK.
2. Zërat me rrezik të mesëm me faktor të konvertimit kreditor 50%:
 - 2.1. Kreditë dokumentare të emtuara ose të konfirmuara të cilat nuk përfaqësojnë zërat me rrezik të mesëm / të ulët,
 - 2.2. Garancitë dhe angazhimet, të cilat përfshijnë kryesisht garancitë për tenderë, garancitë bankare, pagesat doganore, taksat e obligacioneve etj. dhe garancionet që nuk kanë karakteristikat e garancive me karakter të zëvendësimit kreditor,
 - 2.3. Letrat kreditore të parevokueshme që nuk kanë karakteristikat e zëvendësuesve kreditorë,
 - 2.4. Angazhime kreditore të pa tërhequra, të cilat përfaqësojnë marrëveshjet e huasë, blerjet e letrave me vlerë, ofrimin e garancive apo të lehtësirave të pranimit me një maturim fillestar më shumë se një vit;
 - 2.5. Lehtësira/shërbime për lëshimin e vlerënotave, si dhe angazhimet qarkulluese të nënshkruara, dhe
 - 2.6. Zëra të tjerë me rrezik të mesëm, të klasifikuar nga vetë banka dhe të vlerësuar nga BQK.
3. Zërat me rrezik të mesëm / të ulët me faktor të konvertimit kreditor 20%:

- 3.1. Kredi dokumentare, në të cilat dërgesa ose malli (commodity) shërben si kolateral, si dhe transaksione të tjera të vetë-likuidueshme;
 - 3.2. Angazhime kreditore të pa tërhequra, të cilat përfaqësojnë marrëveshjet e huasë, blerjet e letrave me vlerë, ofrimin e garancive apo të lehtësirave të pranimit, me një maturim fillestar deri në një vit, (përfshirë edhe ato me maturim një vjeçar), të cilat nuk mund të anulohen pa kushte, në çdo kohë dhe pa njoftuar, apo të cilat nuk parashikojnë efektivisht anulimin në mënyrë automatike për shkak të përkeqësimit të aftësisë paguese të kredimarrësit;
 - 3.3. Zëra të tjerë me rrezik të mesëm / të ulët, të klasifikuar nga vetë banka dhe të vlerësuar nga BQK.
4. Zërat me rrezik të ulët me faktor të konvertimit kreditor 0%:
 - 4.1. Angazhime kreditore të pa tërhequra, të cilat përfaqësojnë marrëveshjet e huasë, blerjet e letrave me vlerë, ofrimin e garancive apo të lehtësirave të pranimit, që mund të anulohen pa kushte, në çdo kohë dhe pa njoftuar, apo që parashikojnë efektivisht anulimin në mënyrë automatike, si pasojë e përkeqësimit të aftësisë paguese të kredimarrësit.
 - 4.2. Linjat e kreditore për individët dhe bizneset e vogla dhe të mesme (kartelat kreditore dhe mbitërheqjet) mund të konsiderohen si të anulueshme pa kushte, nëse dispozitat ligjore e lejojnë bankën të anulojnë ato plotësisht në çdo kohë.
 - 4.3. Zëra të tjerë me rrezik të ulët, të klasifikuar nga vetë banka dhe të vlerësuar nga BQK.

ANEKSI II

Vlerësimet kreditore afatgjata dhe afatshkurtëra në shkallët përkatëse të cilësisë
kreditore dhe primet minimale të sigurisë

1. Vlerësimi kreditor afatgjatë

Shkalla e klasifikimit kreditor	IVJK		
	Moody's	S&P	Fitch
1	Aaa Aa1 Aa2 Aa3	AAA AA+ AA AA-	AAA AA+ AA AA-
2	A1 A2 A3	A+ A A-	A+ A A-
3	Baa1 Baa2 Baa3	BBB+ BBB BBB-	BBB+ BBB BBB-
4	Ba1 Ba2 Ba3	BB+ BB BB-	BB+ BB BB-

5	B1 B2 B3	B+ B B-	B+ B B-
6	Caa1 Caa2 Caa3 Ca C	CCC+ CCC CCC- CC C D	CCC+ CCC CCC- CC C D

2.Vlerësimi kreditor afatshkurtër

Shkalla e klasifikimit kreditor	IVJK		
	Moody's	S&P	Fitch
1	P-1	A-1+, A-1	F-1+,F-1
2	P-2	A-2	F-2
3	P-3	A-3	F-3
4	N.P	B-1, B-2, B-3, C	Nën F3

5	N.P	B-1, B-2, B-3, C	Nën F3
6	N.P	B-1, B-2, B-3, C	Nën F3

3.Primet Minimale të sigurimit

Primet minimale të sigurimit	AKE
0	0%
1	0%
2	20%
3	50%
4	100%
5	100%
6	100%
7	150%

ANEKSI III
BURSAT DHE SHTËPITË PËR SHLYERJE TË NJOHURA

1. Bankat mund të kërkojnë që bursat apo shtëpitë për shlyerje të shtohen në këtë listë.

1.1 Bursat e njohura

Alberta Stock Exchange

American Stock Exchange

Amsterdam Pork and Potato Terminal Market (Termijnmarkt Amsterdam BV)

Amsterdam Stock Exchange (Amsterdamse Effectenbeurs)

Antwerp (Effectenbeursvennootschap van Antwerpen)

Athens Stock Exchange (ASE)

Australian Stock Exchange

Basle Stock Exchange (Basler Effektenborse)

Barcelona Stock Exchange (Bolsa de Valores de Barcelona)

Belgian Futures & Options Exchange (BELFOX)

Berlin Stock Exchange (Berliner Börse)

Bilbao Stock Exchange (Bolsa de Valores de Bilbao)

Bologna Stock Exchange (Borsa Valori de Bologna)

Bordeaux (Bourse de Bordeaux)

Bremen Stock Exchange (Bremer Wertpapierbörse)

Brussels Stock Exchange (Société de la Bourse des Valeurs Mobilières)/ (Effecten Beursvennootschap

van Brussel)

Chicago Board of Trade

Chicago Board Options Exchange

Chicago Mercantile Exchange

Coffee, Sugar and Cocoa Exchange Inc.

Copenhagen Stock Exchange (Kobenhavns Fondsbors)

DTB Deutsche Terminbörse

The Dublin Stock Exchange

Düsseldorf Stock Exchange (Rheinisch-Westfälische Börse zu Düsseldorf)
European Options Exchange
Financieele Termijnmarkt, Amsterdam
Finnish Options Exchange
Florence Stock Exchange (Borsa Valori di Firenze)
Frankfurt Stock Exchange (Frankfurter Wertpapierbörse)
Genoa Stock Exchange (Borsa Valori di Genova)
Geneva Stock Exchange (Bourse de Geneve)
Hamburg Stock Exchange (Hanseatische Wertpapier Börse Hamburg)
Hannover (Niedersächsische Börse zu Hannover)
Helsinki Stock Exchange (Helsingin Arvopaperipörssi Osuuskunta)
Hong Kong Futures Exchange
International Petroleum Exchange of London Ltd
Irish Futures & Options Exchange (IFOX)
Kansas City Board of Trade
Lille (Bourse de Lille)
Lisbon Stock Exchange (Bolsa de Valores de Lisboa)
Ljubljana Stock Exchange (Ljubljanska Borza d.d.)
London International Financial Futures & Options Exchange
London Metal Exchange Ltd
London Stock Exchange
Luxembourg Stock Exchange (Société de la Bourse de Luxembourg SA)
Lyon (Bourse de Lyon)
Madrid Stock Exchange (Bolsa de Valores de Madrid)
Marché à Terme International de France (MATIF)
Marché des Options Négociables de Paris (MONEP)
Marseille (Bourse de Marseille)
MEFF Renta Fija
MEFF Renta Variable
Mercato Italiano Derivati (IDEM)

Mercato Italiano Futures (MIF)
Mid American Commodity Exchange
Milan Stock Exchange (Borsa Valori de Milano)
Montreal Exchange
Munich Stock Exchange (Bayerische Börse in München)
Nagoya Stock Exchange
Nancy (Bourse de Nancy)
Nantes (Bourse de Nantes)
Naples Stock Exchange (Borsa Valori di Napoli)
National Association of Securities Dealers Incorporated
(NASDAQ)
New York Cotton Exchange
New York Futures Exchange
New York Mercantile Exchange
New York Stock Exchange
OM Stockholm AB
OMLX, The London Securities and Derivatives Exchange Ltd
Oporto Stock Exchange (Bolsa de Valores do Porto)
Osaka Securities Exchange
Oslo Stock Exchange (Oslo Bors)
Pacific Stock Exchange
Palermo Stock Exchange (Borsa Valori de Palermo)
Paris Stock Exchange
Philadelphia Board of Trade
Philadelphia Stock Exchange
Rome Stock Exchange (Borsa Valori di Roma)
Singapore International Monetary Exchange Limited (SIMEX)
Stockholm Stock Exchange (Stockholm Fondbörs)
Stock Exchange of Hong Kong Ltd
Stock Exchange of Singapore

Stuttgart Stock Exchange (Baden-Württembergische Wertpapierbörse zu Stuttgart)
Swiss Futures and Options Exchange (SOFFEX)
Sydney Futures Exchange
Tokyo Stock Exchange
Tokyo International Financial Futures Exchange
Toronto Stock Exchange
Trieste Stock Exchange (Borsa Valori di Trieste)
Turin Stock Exchange (Borsa Valori de Torino)
Valencia Stock Exchange (Bolsa de Valores de Valencia)
Vancouver Stock Exchange
Venice Stock Exchange (Borsa Valori de Venezia)
Vienna Stock Exchange
Zurich Stock Exchange (Zürcher Börse)

1.2 Shtëpitë për shlyerje të njohura

Austrian Kontroll Bank (OKB)
Board of Trade Clearing Corporation
Cassa di Compensazione e Garanzia S. p. A (CCG)
Central Securities Clearing Corporation (KDD Centralna Klirinško Depotna Družba d.d.)
Commodity Clearing Corporation
The Emerging Markets Clearing Corporation
European Options Clearing Corporation Holding BV (EOCC)
Guarantee Fund for Danish Options and Futures (Garantifonden for Danske Optioner OG Futures)
(FUTOP)
Kansas City Board of Trade Clearing Corporation
Hong Kong Futures Exchange Clearing Corporation Ltd
Hong Kong Securities Clearing Company Ltd
London Clearing House (LCH)
Norwegian Futures & Options Clearing House (Norsk Opsjonsentral A.S.)

N.V. Nederlandse Liquidatiekas (NLKKAS)
OM Stockholm AB (OM)
Options Clearing Corporation
OTOB Clearing Bank AG (OTOB)
Société de Compensation des Marchés Conditionnels (SCMC)
Sydney Futures Exchange Clearing House (SFECH Ltd)

ANEKSI IV

LLOJET E DERIVATIVËVE

1. Kontratat e normës së interesit:

- 1.1. kontrata kundërkëmbimi “swaps” të normës së interesit në një valutë të vetme;
- 1.2. kontrata kundërkëmbimi bazë;
- 1.3. marrëveshje me pajtim paraprak të normës së interesit;
- 1.4. kontratat e së ardhmes të normës së interesit;
- 1.5. opsionet e blera të normës së interesit;
- 1.6. kontrata tjera të natyrës së ngjashme.

2. Kontratat e këmbimit valutor dhe kontratat që kanë të bëjnë me arin:

- 2.1. kontrata kundërkëmbimi të normës së interesit në valuta të ndryshme;
- 2.2. kontratat me pajtim paraprak të këmbimit valutor;
- 2.3. kontratat e së ardhmes të valutës;
- 2.4. opsionet e blera të valutës;
- 2.5. kontratat tjera të natyrës së ngjashme;
- 2.6. kontratat e natyrës së ngjashme prej 2.1 deri në 2.5 që kanë të bëjnë me arin.

3. Kontratat e natyrës së ngjashme me ato në pikat 1.1 deri në 1.5 dhe 2.1 deri në 2.4 të këtij aneksi që kanë të bëjnë me zërat tjerë referentë apo indekset. Kjo përfshinë si minimum të gjitha instrumentet të përcaktuar në pikat 4 deri 7, 9 dhe 10 të Aneksit V që nuk janë përfshirë ndryshe në pikat 1 ose 2 të këtij aneksi.

ANEKSI V
INSTRUMENTET FINANCIARE

- 1) Letrat me vlerë të transferueshme;
- 2) Instrumentet e tregut të parasë;
- 3) Njësitë në sipërmarrjet e investimeve kolektive;
- 4) Kontratat opsjon, kontratat e së ardhmes “futures”, kontratat e kundërkëmbimit “swaps”, kontratat me pajtim paraprak “forward” të normës së interesit dhe çdo kontratë tjetër derivative që lidhet me letrat me vlerë, valutat, normat e interesit apo rendimentet/kthimet, apo instrumentet tjera derivative, indekset financiare apo masat financiare që mund të shlyhen në formë fizike apo në para të gatshme;
- 5) Kontratat opsjon, kontratat e së ardhmes “futures”, kontratat e kundërkëmbimit “swaps”, kontratat me pajtim paraprak “forward” të normës së interesit dhe çdo kontratë tjetër derivative që lidhet me mallrat që duhet të shlyhen në para të gatshme, apo mund të shlyhen në para të gatshme sipas zgjedhjes së njëres palë (ndryshe nga një arsye e dështimit apo ngjarje tjetër e ndërprerjes së kontratës);
- 6) Kontratat opsjon, kontratat e së ardhmes “futures”, kontratat e kundërkëmbimit “swaps” dhe çdo kontratë tjetër derivative që lidhet me mallrat që mund të shlyhet në formë fizike duke u siguruar që ato tregtohen në një treg të rregulluar dhe/ ose në një Sistem lehtësimi për tregtim të shumëfishtë “MTF”;
- 7) Kontratat opsjon, kontratat e së ardhmes “futures”, kontratat e kundërkëmbimit “swaps”, kontratat me pajtim paraprak “forwards” dhe çdo kontratë tjetër derivative që ka të bëjë me mallrat që mund të shlyhet në formë fizike, që nuk është përcaktuar ndryshe në pikën 6) të këtij aneksi dhe që nuk është për qëllime komerciale, që ka karakteristikat e instrumenteve financiare derivative tjera, duke pasur parasysh nëse, ndër të tjera, ato kontrata shlyhen dhe realizohen nëpërmjet shtëpive të njohura të pastrimit ose janë subjekt i thirrjeve të rregullta marginale;
- 8) Instrumentet derivative për transferimin e rrezikut kreditor;
- 9) Kontratat financiare për diferenca;
- 10) Kontratat opsjon, kontratat e së ardhmes “futures”, kontratat e kundërkëmbimit “swaps”, kontratat me pajtim paraprak “forward” të normës së interesit dhe çdo kontratë tjetër derivative që lidhet me variablat klimatike, normat e mallrave, lejimet e emetimit apo normat e inflacionit ose statistikat tjera ekonomike zyrtare që duhet të shlyhen në para të gatshme ose mund të shlyhen në para të gatshme sipas zgjedhjes së njëres palë (ndryshe nga një arsye e dështimit apo ngjarje tjetër e ndërprerjes së kontratës), si dhe çdo kontratë

tjetër derivative që lidhet me asetet, të drejtat, obligimet, indekset dhe matjet të cilat nuk janë përcaktuar ndryshe, që kanë karakteristikat e instrumenteve tjera financiare derivative, duke pasur parasysh nëse, ndër të tjera, ato kontrata janë të tregtuara në tregje të rregulluara apo ndonjë Sistemi lehtësimi për tregtim të shumëfishtë “MTF”, shlyhen dhe realizohen nëpërmjet të shtëpive të njohura të pastrimit ose janë subjekt i thirrjeve të rregullta marginale;

ANEKSI VI

QASJA E TREGUESIT BAZIK

Formula për kalkulimin e ngarkesës së kapitalit për rrezik operacional, sipas Qasjes së Treguesit Bazik (QTB) është:

$$KBIA = \{\sum(GI1 \dots n \times \alpha)\} / n$$

Ku:

KBIA = Ngarkesa për kapital sipas QTB-së

GI = të hyrat bruto vjetore të bankës, kur janë pozitive, gjatë tri viteve të mëparshme

n = numri i tri viteve të mëparshme kur të hyrat bruto vjetore janë pozitive

$\alpha = 15\%$

Formula për kalkulimin e ngarkesës së kapitalit për rrezik operacional, sipas Qasjes së Standardizuar (QS) është:

$$KSA = \{\sum_{\text{vitet 1-3}} \max[\sum(GI1-8 \times \beta1-8), 0]\} / 3$$

Ku: KSA = ngarkesa e kapitalit sipas QS

GI1-8 = të hyrat bruto vjetore, për vitin e caktuar, për secilën nga tetë linjat biznesore

B1-8 = faktori fiks beta (i definuar në aneksin VII)

ANEKSI VII

QASJA E STANDARDIZUAR

Linjat biznesore	Lista e aktiviteteve	Përqindja
------------------	----------------------	-----------

Financa korporative	<p>Sigurimi i instrumenteve financiare dhe/ose plasimi i instrumenteve financiare në një bazë detyrimore të kompanisë</p> <p>Shërbimet e lidhura me përkrahjen</p> <p>Këshilla Investuese</p> <p>Këshillat ndërmarrjeve mbi strukturën e kapitalit, strategjisë industriale dhe çështjeve të lidhura dhe këshillave dhe shërbimeve të lidhura me bashkimin dhe blerjet e ndërmarrjeve</p> <p>Kërkime investuese, analiza financiare dhe forma tjera të rekomandimeve të përgjithshme lidhur me tansaksionet në instrumente financiare</p>	18%
Tregti dhe shitje	<p>Tregtimi në llogari personale</p> <p>Ndërmjetësim parash</p> <p>Pranim dhe ridërgim të urdhëresave në lidhje me një apo më tepër instrumente financiare</p> <p>Zbatimi i urdhëresave në emër të klientëve</p> <p>Plasimi i instrumenteve financiare pa bazë detyrimi nga kompania</p> <p>Operimi i pajisjeve tregtare multilaterale</p>	18%
Ndërmjetësim me pakicë (Aktivitetet me persona fizik individual apo me entitete të vogla dhe të mesme)	<p>Pranim dhe ridërgim të urdhëresave në lidhje me një apo më tepër instrumente financiare</p> <p>Zbatimi i urdhëresave në emër të klientëve</p> <p>Plasimi i instrumenteve financiare pa bazë detyrimi nga kompania</p>	12%
		15%

Veprime bankare komerciale	Pranimi i depozitave dhe fondeve tjera të ri pagueshme Kredi-dhënie Qira-dhënie (Leasing) financiare Garancione dhe detyrime financiare	
Veprime bankare me pakicë / (eng. Retail) Ndërmjetësim me pakicë (Aktivitetet me persona fizik individual apo me entitete të vogla dhe të mesme)	Pranimi i depozitave dhe fondeve tjera të ri pagueshme Kredi-dhënie Qira-dhënie (Leasing) financiare Garancione dhe detyrime financiare	12%
Pagesa dhe barazime	Shërbime ridërgimi të parave Emetim dhe administrimi i llojeve të pagesës	18%
Shërbimet e ndërmjetësimit (eng. Agency services)	Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në llogari të klientëve, duke përfshirë kujdestarinë dhe shërbimet e ngjashme si menaxhimi i parasë së gatshme/kolateralit.	15%
Menaxhim i mjeteve	Menaxhim portofoli Veprimet për investimet e përbashkëta në letrat me vlerë të transferueshme (ang. Undertakings for Collective Investment in Transferable Securities) Forma tjera të menaxhimit të mjeteve	12%

